



sondazh i opinionit publik

2020  
**BESIMI NË QEVERISJE**



**Institute for Democracy and Mediation**  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Financuar nga

**Austrian  
Development  
Cooperation**





Sondazh i opinionit publik

# BESIMI në QEVERISJE 2020

*Raporti i sondazhit*



Institute for Democracy and Mediation  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Financuar nga



Austrian  
Development  
Cooperation



## **Sondazh i opinionit publik 2020: Besimi në qeverisje**

*Raporti i sondazhit*

### **Autorët:**

Leonie Vrugtman

Marsela Dauti

### **Koordinatorët e punës në terren:**

Diori Angjeli, Sheila Hafizi

### **Përkthimi nga anglishtja:**

Durim Tabaku

© 2021 nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

*Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)*

*Adresa: Rr. Shenasi Dishnica, Nd. 35, H. 1 1017*

*Tirana, Albania*

*E-mail: [info@idmalbania.org](mailto:info@idmalbania.org)*

*Website: [www.idmalbania.org](http://www.idmalbania.org)*

*Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Konsolidimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin në Shqipëri” (CSDA), një fond i përbashkët donatorësh, i cili zbatohet nga qeveria shqiptare në partneritet me Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe me Bashkëpunimin Austriak për Zhvillim (ADC) si kontribues kryesor, bashkë me UNDP-në. Brenda e raportit është përgjegjësi e autorëve dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht politikën ose qëndrimin zyrtar të qeverisë shqiptare, UNDP-së, apo ADC-së.*

# Besimi në qeverisje 2020 përmbledhje

*Në vitin e tij të tetë, “Sondazhi i opinionit publik: Besimi në qeverisje” u realizua nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në periudhën nëntor-dhjetor 2020 në të 61 bashkitë e vendit, duke përdorur një kampion përfaqësues kombëtar prej 2,500 personash të zgjedhur në mënyrë rastësore. Ky vit u karakterizua nga pasojat e tërmetit shkatërrimtar të nëntorit 2019 në Shqipëri dhe nga pandemia COVID-19, që shkaktuan kufizime të konsiderueshme në të gjitha aspektet e jetës në vend, përfshirë qeverisjen, angazhimin qytetar dhe ofrimin e shërbimeve publike. Këto ndikuan tek gjetjet e kapitujve që përsëriten çdo vit si dhe sollën si rezultat përfshirjen e një kapitulli të ri: “Fatkeqësitë natyrore”. Gjetjet grupohen në nëntë kapituj kryesorë dhe përmbledhen si më poshtë:*




# Besimi në institucione

- Organizatat ndërkombëtare, si NATO, OKB dhe BE, renditen si institucionet më të besuara.
- Institucionet fetare (69.8%) janë institucionet më të besuara në vend për shqiptarët, pasuar nga institucionet arsimore (54.1%), forcat e armatosura (54%) dhe organizatat e shoqërisë civile (52.6%).
- Partitë politike (20.4%), gjykatat (23.8%), presidenti (23.9%), parlamenti (24.1%) dhe prokuroria (24.3%) janë ndër institucionet me renditjen më të ulët për nivelin e besimit.
- Krahasuar me vitin 2019, ka rënë besimi te policia, institucionet e kujdesit shëndetësor, media, qeveria qendrore dhe forcat e armatosura, ndërkohë që është rritur besimi tek institucionet fetare.
- 28.7% e popullsisë në Shqipëri e anketuar në këtë sondazh beson se reforma në drejtësi po zbatohet me korrektësi dhe 52.8% e të anketuarve besojnë se reforma do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e vendit.
- Edhe pse mediat sociale (36%) dhe portalet (15%) po bëhen përherë e më shumë burimi kryesor i informimit, madje edhe tek njerëzit e moshës mbi 65 vjeç, për shqiptarët, televizioni (58%) mbetet burimi mediatik më popullor për marrjen e të reja më të fundit për aktualitetin.
- Një në tre shqiptarë beson se informacioni i dhënë nga media në Shqipëri është i saktë/i vërtetë.



# Transparenca dhe llogaridhënia

- Shumica e shqiptarëve të anketuar i perceptojnë qeverinë qendrore (64.3%) dhe bashkitë (62.2%) si jo transparente, edhe pse krahasuar me vitin 2019, perceptimi për transparencën në nivelin qendror dhe vendor të qeverisjes është rritur me 1 p.p. dhe 2 p.p. përkatësisht.
- Shumica e shqiptarëve të anketuar (64.1%) janë të informuar se e drejta për informim është e garantuar me ligj. Shqiptarët e moshës mbi 65 vjeç ose me të ardhura 50 001 - 70 000 lekë janë më të predispozuar për të qenë të informuar për këtë ligj.
- Krahasuar me vitin 2019, përqindja e shqiptarëve që mendojnë se qeveria vendore është e përgjegjshme është rritur me 6 p.p. në 37% dhe për qeverinë qendrore me 4 p.p. në 35% në vitin 2020.
- Shqiptarët e anketuar priren të besojnë se mekanizmi më efikas i llogaridhënies në vend është Kontrolli i Lartë i Shtetit (60.7%), i ndjekur nga media (52.8%), Parlamenti (48.1%), shoqëria civile (44.8) dhe Avokati i Popullit (44.3%).
- Në përgjithësi, shqiptarët besojnë se organizatat ndërkombëtare i kërkojnë llogari qeverisë shumë më tepër se institucionet vendase të renditura më sipër.



# Korrupsioni në institucionet publike


- 86.7% e shqiptarëve raportojnë se korrupsioni i nivelit të ulët është i përhapur, ndërkohë që 84.1% thanë se korrupsioni i nivelit të lartë është i përhapur.
- Institucionet gjyqësore renditen si më të korruptuara në 2020, ndjekur nga institucionet e kujdesit shëndetësor, organet e zbatimit të ligjit, dhe Parlamenti.
- Krahasuar me vitin e kaluar, përqindja e shqiptarëve që nuk kanë besim në ndjekjen penale të korrupsionit të nivelit të ulët është rritur: nga 61.1% në 2019 në 64.5% në 2020.
- 7 në 10 shqiptarë nuk kanë besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë.
- Përqindja e shqiptarëve që raportojnë se kanë paguar ryshfet për të marrë një shërbim nga qeveria qendrore është rritur nga 19% në 2019 në 32% vitin 2020. Është rritur përqindja e shqiptarëve që morën një shërbim nga qeveria qendrore në vitin 2020 nga 32% në 2019 në 41% në 2020.





# Ndikimi politik

- Institucionet fetare perceptohen si institucionet më pak të ndikuara politikisht (12%), ndërkohë që prokuroria (58%) dhe gjykatat (56%) konsiderohen si institucionet më shumë të ndikuara politikisht.
- Krahasuar me vitin 2019, një përqindje më e vogël e të anketuarve i konsiderojnë gjykatat, median, dhe organizatat e shoqërisë civile si të ndikuara nga interesat politike.



# Pjesëmarrja qytetare

- Në 2020, kemi një përqindje më të vogël (49%) të qytetarëve shqiptarë që janë të interesuar të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes së institucioneve publike, në krahasim me në vitin në 2019 (57%).
- Të anketuarit me diplomë universitare (apo pasuniversitare), studentët, punonjësit e sektorit publik, dhe anëtarët e partive politike janë më të predispozuar për të raportuar se janë të interesuar të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes.
- Shumica e shqiptarëve mendojnë se nuk kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen e institucioneve publike.
- Afro 1 në 8 shqiptarë raportojnë se kanë përdorur portalin online “[www.konsultimipublik.gov.al](http://www.konsultimipublik.gov.al)” në 2020 për të marrë informacione apo për të dhënë mendimin për nisma ligjore apo projekt strategji/plane veprimi.
- Shumica e shqiptarëve besojnë se qytetarët kanë njohuri të mjaftueshme për të kuptuar vendimet e qeverisë (71%).
- Edhe pse 38% e të anketuarve besojnë se sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile merren në konsideratë, 65% mendojnë se dëgjesat publike vendore janë ngjarje formale. Ndërkohë, 35% janë dakord me pohimin se këshilltarët e bashkisë përfaqësojnë komunitetin dhe mbrojnë interesat e qytetarëve.
- 22% e të anketuarve kanë marrë pjesë në një demonstratë/tubim apo kanë nënshkruar një peticion në 2020.
- 67% janë të gatshëm të angazhohen në punë vullnetare, veçanërisht të anketuarit më të rinj se 45 vjeç, që po ndjekin studimet universitare, që punojnë në sektorin privat, dhe që banojnë në zonat rurale.
- Përqindja e shqiptarëve që duan të largohen drejt një vendi tjetër mbetet e lartë: 44% e të anketuarve raportojnë se duan të emigrojnë.



# Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike

- Mesatarisht 38% e shqiptarëve, janë të kënaqur me ofrimin e shërbimeve publike bazë. Shërbimet e arsimit publik (49%) dhe shërbimi i pastrimit (49%) perceptohen si më të kënaqshmet.
- 45% e të anketuarve të këtij sondazhi që kanë përdorur një shërbim administrativ në vitin 2020 janë të kënaqur me atë shërbim. Në mënyrë të veçantë, gjendja civile (68%), transporti rrugor (56%), dhe sigurimet shoqërore (54%) morën vlerësimet më të mira.
- Krahasuar me vitin 2019, një përqindje më e vogël të anketuarish kanë bërë ankesë tek institucioni publik që ofron shërbimin (12% në 2020 krahasuar me 17% në 2019).
- 12.4% e qytetarëve të anketuar kanë bërë ankesë te platforma online shqiperiaqeduam.al. Shqiptarët me të ardhura mujore mbi 70,001 lekë ishin më të predispozuar për të bërë ankesë në këtë platformë.
- Ashtu si në vitin 2019, rreth 1 in 4 shqiptarë besojnë se institucionet ‘i dëgjojnë’ dhe i trajtojnë siç duhet ankesat e qytetarëve.
- 57.2% e të anketuarve thonë se cilësia e shërbimeve sociale të ofruara nga bashkia nuk ka ndryshuar, ndërsa 23.6% thonë se cilësia e shërbimeve sociale është përmirësuar dhe 19.2% deklarojnë se kjo cilësi është për keqësuar.
- Krahasuar me vitin 2019, një përqindje më e madhe e pjesëmarrësve në këtë sondazh raportuan se kishin vizituar një sportel shërbimi të Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) – (29% krahasuar me 24%). Mes tyre që kishin vizituar ADISA-n, 73.4% thanë se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me shërbimin që morën, një rritje prej më shumë se 4 p.p. krahasuar me vitin e kaluar.
- 70% e shqiptarëve të anketuar nuk ndihen të sigurt në jetën e përditshme. Arsyet kryesore për ndjenjën e pasigurisë janë kriminaliteti, shëndetësia pa cilësi e standard, pasiguria e vendit të punës, dhe padrejtësia.




# Fatkeqësitë natyrore

- 40.3% e të anketuarve raportojnë se janë të kënaqur me nivelin e transparencës së vendimmarrjes së qeverisë vendore në lidhje me pandeminë COVID-19; 43.7% janë të kënaqur me shërbimet online si alternativë për marrjen e shërbimeve, dhe 34.5% janë të kënaqur me respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut gjatë pandemisë COVID-19.
- Më pak se gjysma e shqiptarëve të anketuar janë të kënaqur me përgjigjen pas tërmetit nga qeveria qendrore (38%) dhe qeveria vendore (38%).
- Në përgjithësi, pakënaqësia është më e theksuar mes grupmohave të reja, të papunëve, studentëve, të punësuarve në sektorin privat, dhe personave me aftësi të kufizuara.



# Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)

- 63% e shqiptarëve janë në dijeni se bashkia e tyre ka një faqe interneti, një rritje prej 20 p.p. krahasuar me 2015.
- Arsyeja kryesore për përdorimin e faqes së bashkisë është për të marrë informacione për llojet e shërbimeve që ofrohen dhe se si mund të aksesohen ato.
- Krahasuar me vitin 2019, një përqindje më e madhe e shqiptarëve thonë se janë në dijeni se administrata shtetërore ofronte shërbime elektronike nëpërmjet portalit e-Albania (93% në 2020 krahasuar me 71% në 2019).
- 74.3% e qytetarëve që janë në dijeni për ekzistencën e portalit e-Albania thonë se kanë marrë shërbime elektronike nëpërmjet portalit e-Albania në 2020.
- Krahasuar me vitin 2019, një përqindje më e vogël e shqiptarëve i vlerësojnë shërbimet elektronike si funksionale, të lehta për t'u përdorur, dhe që u ofrojnë mundësi qytetarëve të shprehin mendimet/sugjerimet e tyre.



# Përfshirja gjinore dhe sociale

- 50% e burrave dhe 39% e grave janë dakord se në shoqërinë shqiptare ka barazi mes burrave dhe grave, ashtu si një përqindje më e vogël në vitin 2019 (45% në 2019 krahasuar me 54% në 2020).
- 74.5% e burrave dhe 68.2% e grave besojnë se burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike, që përfaqëson një rritje të lehtë nga viti 2019, kur 71.1% e burrave dhe 66.4% e grave ishin dakord me këtë pohim.
- Shumica e qytetarëve të anketuar (67.8%) besojnë se nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave.
- 1 në 8 shqiptarë raportojnë se janë trajtuar ndryshe nga një institucion apo nëpunës publik për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, orientimit seksual, statusit me aftësi të kufizuar, apo për arsye të tjera. Nga ata që kanë vuajtur diskriminimin në 2020, shumica janë trajtuar ndryshe për shkak të moshës apo gjinisë së tyre.
- 80% e shqiptarëve të anketuar janë të mendimit se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik. Gratë, të rinjtë dhe ata me arsim universitar (ose pasuniversitar) janë më të predispozuar të deklarojnë se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik.
- Ashtu si në vitin 2019, 6 në 10 shqiptarë mendojnë se rritja e numrit të grave në këshillat bashkiakë do të ketë ndikim pozitiv në qeverisjen vendore.

## Lista e tabelave

Tabela 1: Popullsia rezidente në 1 janar 2019 dhe madhësia e kampionit për secilin qark	20
Tabela 2. Grupmoshat	23
Tabela 3. Statusi i punësimit	24
Tabela 4. A i përkisni ndonjë pakice kombëtare?	26
Tabela 5: Besimi tek institucionet 2015–2020*	32
Tabela 6: Ndarja demografike e besimit (‘Kam shumë besim’ dhe ‘Kam besim’)	39
Tabela 7: Ndarja demografike për reformën në drejtësi	40
Tabela 8: Ndarja demografike për mediat	41
Tabela 9: Perceptimi i efektivitetit të mekanizmave të llogaridhënies 2016–2020	52
Tabela 10: Ndarja demografike për transparencën dhe llogaridhënien	53
Tabela 11: Ndarja social-demografike e llogaridhënies horizontale dhe vertikale	54
Tabela 12: Perceptimi i përhapjes së korrupsionit 2017–2020	58
Tabela 13: Institucioni më i korruptuar në 2020	59
Tabela 14: Arsytet e pagimit të rryshfetit 2020	66
Tabela 15: Institucionet që perceptohen si “shumë të ndikuara” ose “jashtëzakonisht shumë të ndikuara” nga politika 2016–2020	71
Tabela 16: Ndarja demografike e institucioneve të ndikuara shumë ose jashtëzakonisht shumë 2020	72
Tabela 17: Arsytet për mospjesëmarrje në takimet e konsultimit në vitin 2020	79
Tabela 18: Ndarja demografike – interesi dhe mundësitë e mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje 2020	86
Tabela 19: Ndarja demografike e procesit të konsultimit në vitin 2020	87
Tabela 20: Ndarja demografike e pohimeve për pjesëmarrjen/angazhimin qytetar në 2020	89
Tabela 21: Përdorimi dhe kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike administrative 2020	94
Tabela 22: Niveli i kënaqshmërisë me ofrimin e shërbimeve publike 2016–2020	96
Tabela 23: Faktorët për ndjenjën e pasigurisë 2016–2020	105
Tabela 24: Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike sipas ndarjeve demografike 2020	106
Tabela 25: Ndarja demografike e kënaqshmërisë me përgjigjen fillestare të qeverisë gjatë fatkeqësive natyrore 2020	112
Tabela 26: Arsytet e përdorimit të faqes së internetit të bashkisë 2020	117
Tabela 27: Diskriminim nga institucioni 2020	128

## Lista e figurave

Figura 1. Përfaqësimi gjinor	22
Figura 2. Përfaqësimi gjeografik	23
Figura 3. Niveli i arsimit të përfunduar	24
Figura 4. Të ardhurat e rregullta individuale mujore (Neto)	25
Figura 5: Besimi tek institucionet 2020	29
Figura 6: Ndikimi i perceptuar dhe zbatimi i reformës në drejtësi 2020	33
Figura 7: ‘Ndikimi pozitiv’ përkundër ‘zbatimit me korrektësi’ të reformës në drejtësi në zhvillimin e vendit, përqindja e atyre që thanë ‘po’ në 2016–2020	34
Figura 8: Mediat më të përdorura për marrjen e informacionit për aktualitetin	35
Figura 9: Perceptimi për saktësinë e informacionit të dhënë nga burimi më i përdorur mediatik 2020	36
Figura 10: Saktësia e mediave 2016–2020	37
Figura 11: Kënaqësia me donatorët e huaj në Shqipëri	38
Figura 12: Perceptimi për transparencën e qeverisë qendrore dhe vendore 2020	43
Figura 13: Ndryshimi në transparencën e perceptuar të institucioneve 2016-2020	44
Figura 14: Ndërgjegjësimi publik për ligjin për të drejtën e informimit në 2020	45
Figura 15: Perceptimi i llogaridhënies së qeverisë qendrore dhe vendore në 2020	47
Figura 16: Ndryshimi për perceptimin e llogaridhënies 2016–2020	48
Figura 17: Perceptimi për efektivitetin e mekanizmave të llogaridhënies horizontale 2020	49
Figura 18: Perceptimi për efektivitetin e mekanizmave të llogaridhënies vertikale 2020	51
Figura 19: Perceptimi i përhapjes së korrupsionit 2020	57
Figura 20: Perceptimi i ndjekjes penale të rasteve të korrupsionit 2020	60
Figura 21: Besimi në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit 2017-2020	61
Figura 22: Përvoja personale me korrupsionin 2020	62
Figura 23: Përvoja personale me korrupsionin në nivel qendror e vendor 2015-2020	63
Figura 24: Shërbimet e marra në nivel qendror 2020	64
Figura 25: Ryshfet i paguar në nivel qendror 2020	64
Figura 26: Shërbimet e marra në nivel vendor 2020	65
Figura 27: Ryshfet i paguar në nivel vendor 2020	65
Figura 28: Përhapja e ryshfetit 2016-2020	66



Figura 29: Perceptimi për ndikimin e interesave politike në axhendën e institucioneve 2020	69
Figura 30: Interesi për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse së institucioneve publike 2020	75
Figura 31: Mundësitë për të marrë pjesë në vendimmarrjen e institucioneve publike 2020	76
Figura 32: Mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje 2016–2020	77
Figura 33: Ftesat për të marrë pjesë në proceset e konsultimit 2016–2020	78
Figura 34: Pjesëmarrja në takime konsultimi 2020	78
Figura 35: Përdorimi i portalit “Konsultimipublik.gov.al” 2020	79
Figura 36: Pohimet për përfaqësimin vendor dhe angazhimin qytetar 2020	81
Figura 37: Pjesëmarrja në një demonstratë/tubim apo nënshkrim i një peticioni në 2020	82
Figura 38: Gatishmëria për t’u angazhuar në punë vullnetare 2020	83
Figura 39: Largimi nga vendbanimi aktual 2020	84
Figura 40: Kënaqshmëria me shërbimet publike 2020	92
Figura 41: Të anketuarit që kishin paraqitur ankesë tek institucionet 2016–2020	97
Figura 42: A keni bërë ndonjë ankesë tek Platforma e Bashkëqeverisjes ‘www.shqiperiaqeduam.al’? 2020	99
Figura 43: Institucionet “i dëgjojnë” dhe i trajtojnë siç duhet ankesat që vijnë nga qytetarët? 2016-2020	100
Figura 44: Ndryshimet në cilësinë e shërbimeve sociale të bashkive 2020	101
Figura 45: Të anketuarit që kanë vizituar një sportel shërbimi ADISA në 2020	102
Figura 46: Kënaqshmëria me sportelet e shërbimit me një ndalesë në zyrat e ADISA në 2020	103
Figura 47: Perceptimi për sigurinë në jetën e përditshme 2016 –2020	104
Figura 48: Kënaqshmëria e qytetarëve me trajtimin e krizave dhe qeverisjen gjatë pandemisë COVID-19 2020	109
Figura 49: Kënaqshmëria e qytetarëve me përgjigjen fillestare të qeverisë pas tërmetit 2020	111
Figura 50: A e dini se bashkia juaj ka një faqe interneti? 2020	115
Figura 51: A e dini se bashkia juaj ka një faqe interneti? 2015–2020	115
Figura 52: Përqindja e të anketuarve që përdorin faqen e internetit të bashkisë 2020	116
Figura 53: Dijenia për portalin e-Albania 2020	118
Figura 54: A keni marrë ndonjë shërbim elektronik nëpërmjet portalit e-Albania? 2020	119

Figura 55 Cilësia e vlerësimit të shërbimeve elektronike nëpërmjet portalit e-Albania 2020	120
Figura 56: Barazia mes burrave dhe grave në shoqërinë shqiptare 2020	122
Figura 57: Barazia mes burrave dhe grave në shoqërinë shqiptare 2016–2020	123
Figura 58: Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike 2020	124
Figura 59: Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike 2016-2020	125
Figura 60: Nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave 2020	126
Figura 61: Nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave 2016-2020	127
Figura 62: Gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik 2016-2020	129
Figura 63: Dallimet gjinore në perceptimin se gratë janë po aq të afta sa edhe sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik 2020	130
Figura 64: Ndikimi pozitiv i rritjes së përfaqësimit të grave në këshillat bashkiakë 2016–2020	131

# Tabela e përmbajtjes

<b>BESIMI NË QEVERISJE 2020 – PËRMBLEDHJE</b>	<b>3</b>
<b>1. HYRJE</b>	<b>18</b>
<b>2. METODOLOGJIA</b>	<b>19</b>
2.1 Metodologjia statistikore dhe përshkrimi statistikor i kampionit	19
2.2 Instrumenti i sondazhit	20
2.3 Fokus grupet	21
2.4 Kufizimet	21
<b>3. DEMOGRAFIA E KAMPIONIT</b>	<b>22</b>
<b>4. REZULTATET E SONDAZHIT</b>	<b>27</b>
4.1 Besimi në institucione	27
4.2 Transparenca dhe llogaridhënia	42
4.3 Korrupsioni në institucionet publike	56
4.4 Ndikimi politik	68
4.5 Pjesëmarrja qytetare	74
4.6 Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike	91
4.7 Fatkeqësitë natyrore	108
4.8 Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit	114
4.9 Gjinia dhe përfshirja sociale	121
<b>Shtojca 1: Karakteristikat e kampionit 2013–2020</b>	<b>132</b>

# 1. HYRJE

Që nga rënia e komunizmit, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë kaluar një tranzicion të vështirë drejt një shoqërie të hapur dhe demokratike. Vitet e fundit, axhenda e reformave është nxitur edhe më shumë nga kushtet për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE), kushte që janë përcaktuar nga Komisioni Evropian. Në Shqipëri, funksionimi i institucioneve demokratike, reforma në administratën publike, shteti ligjor dhe zhvillimi ekonomik janë në zemër të këtyre reformave.<sup>1</sup> Zbatimi i duhur i këtyre reformave dhe hapja e bisedimeve të anëtarësimit në BE janë aktualisht tregues të rëndësishëm të perceptimit të publikut për qeverinë shqiptare. Së bashku me tregues të tjerë afatgjatë, si besimi në qeverisje, ofrimi i shërbimeve publike dhe llogaridhënia publike, këta janë faktorë të rëndësishëm që përcaktojnë mbështetjen për *status quo*-në në shoqërinë shqiptare.

Sondazhi i Opinioneve është një instrument që bën të mundur monitorimin e përvitshëm të besimit dhe perceptimit të publikut për qeverisjen dhe angazhimin e qytetarëve në Shqipëri. Qëllimi kryesor i tij është të shqyrtojë perceptimet dhe qëndrimet e publikut për çështje të tilla si besimi tek institucionet publike, transparencja dhe llogaridhënia institucionale, korrupsioni, niveli i angazhimit të qytetarëve në politikë-bërje dhe vendimmarrje, kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike dhe zbatimin e ligjeve dhe politikave jodiskriminuese. Për më tepër, Sondazhi i Opinioneve siguron të dhëna që ndihmojnë në përmirësimin e reformave madhore që lidhen me qeverisjen e mirë, antikorrupsionin, reformën në gjyqësor dhe çështjet që ndikojnë tek të gjithë sektorët, siç janë barazia gjinore dhe përfshirja sociale.

Në këtë raport prezantohen gjetjet nga Sondazhi i Opinioneve Publik “Besimi në Qeverisje”, realizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) gjatë periudhës 13 nëntor – 10 dhjetor 2020 në të 61 bashkitë e vendit. Ky është viti i tetë radhazi që realizohet ky sondazh (2013-2020) ku përdoret i njëjti instrument vëzhgimi. Gjatë gjithë vitit 2020, pandemia COVID-19 shkaktoi ndërprerje të mëdha për qeverisjen në përgjithësi, pakësoi mundësitë e qytetarëve për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes si dhe pengoi fizikisht ofrimin e shërbimeve publike. Kjo gjë ndikoi jo vetëm te gjetjet e çdo kapitulli të analizuar gjatë këtyre viteve, por diktoi edhe përfshirjen e një kapitulli të ri: fatkeqësitë natyrore.

Raporti fillon me një përshkrim të metodologjisë dhe karakteristikave social-demografike të të anketuarve dhe më pas ndiqet nga gjetjet e sondazhit të grupuara në nëntë seksione kryesore: besimi në institucione; transparencja dhe llogaridhënia; korrupsioni dhe institucionet publike; ndikimi i interesave politikë; pjesëmarrja qytetare; kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike; performanca e qeverisë përballë fatkeqësive natyrore; përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK); dhe përfshirja gjinore dhe sociale.



1 Institucionet demokratike, reforma në administratën publike, shteti ligjor, zhvillimi ekonomik dhe konkurrueshmëria konsiderohen si “bazat” e *acquis* nga Komisioni Evropian.

## 2. METODOLOGJIA

### 2.1 Metodologjia statistikore dhe përshkrimi statistikor i kampionit

Për Sondazhin e Opinionit Publik “Besimi në qeverisje” 2020 u përdor një kampion përfaqësues i popullatës shqiptare në të cilin të anketuarit u përzgjedhën nga të gjitha bashkitë e vendit dhe njësitë e tyre administrative. Përdorimi i një kampioni përfaqësues kombëtar të ponderuar na bën të mundur të përgjithësojmë dhe t’i aplikojmë gjetjet e sondazhit tek e gjithë popullata si një e tërë. Kështu, niveli i vlefshmërisë statistikore i kampionit përshkruhet si vijon: për popullsinë në moshë madhore prej 2,213,610 banorësh,<sup>2</sup> me madhësi kampioni prej 2,500 të anketuarish, për nivel besimi prej 95%, marzhi i gabimit është  $\pm 1.96$ ; për nivel besimi prej 99%, marzhi i gabimit është  $\pm 2.58$ .

Për të përcaktuar madhësinë e kampionit për secilin qark, u morën të dhëna për popullsinë nga regjistri civil, ndërsa numri i banorëve për secilën bashki u mor nga Instituti i Statistikave (INSTAT).<sup>3</sup> Për të llogaritur madhësinë e kampionit për secilën bashki dhe, për më shumë detaje, për secilën njësi administrative brenda bashkisë u përdorën të dhënat sasiore nga regjistri civil i datës 1 janar 2019. Kampioni prej 2,500 të anketuarish u shpërnda në të 61 bashkitë nga 12 qarqet e vendit.<sup>4</sup>

Më pas, shpërndarja sipas qarqeve u përshtat për të zgjedhur vetëm popullsinë në moshë madhore (të moshës 18 vjeç e lart) dhe për të përdorur kontrolle të kuotave sipas gjinisë. Meqenëse INSTAT nuk përcakton grupmoshat nën 18 vjeç dhe mbi 18 vjeç, u përdor një teknikë lineare interpolimi. Koeficienti i përfaqësimit të popullsisë për meshkujt shqiptarë të moshës mbi 18 vjeç që nga 1 janari 2019 u përcaktua në 0.768076985 dhe për femrat mbi 18 vjeç në 0.778576952. Koeficienti i përgjithshëm i përfaqësimit të popullsisë për shqiptarët mbi 18 vjeç ishte 0.773333171.<sup>5</sup> Për të ilustruar këtë, në Tabelën 1 jepen shpërndarja sipas qarkut të popullatës rezidente shqiptare të moshës mbi 18 vjeç dhe madhësia e kampionit për secilin qark.



- 2 Shih Tabelën 1 për më shumë hollësi.
- 3 INSTAT e përcakton popullsinë rezidente shqiptare si “të gjithë personat që banojnë apo synojnë të banojnë në vend për të paktën 12 muaj, pavarësisht shtetësisë së tyre.” Për qëllime të këtij studimi, u përjashtuan qytetarët jo-shqiptarë.
- 4 Kampioni i këtij viti është i njëjtë me atë të vitit 2019.
- 5 Kjo do të thotë se rreth 77% e popullsisë shqiptare janë të moshës mbi 18 vjeç në 1 janar 2020.

**Tabela 1: Popullsia rezidente në 1 janar 2019 dhe madhësia e kampionit për secilin qark**

Qarku	Popullsia	Popullsia mbi moshën 18 vjeç	Madhësia e kampionit për çdo qark		
			Burra	Gra	Gjithsej
Berat	125,157	96,788	54	55	109
Dibër	118,948	91,986	54	50	104
Durrës	290,126	224,364	127	126	253
Elbasan	274,982	212,653	119	121	240
Fier	294,747	227,938	130	127	257
Gjirokastrë	61,423	47,500	26	28	54
Korçë	207,889	160,767	90	92	182
Kukës	76,594	59,233	34	33	67
Lezhë	125,195	96,817	54	55	109
Shkodër	202,895	156,905	86	91	177
Tiranë	895,160	692,257	384	399	783
Vlorë	189,311	146,400	82	83	165
Gjithsej	2,862,427	2,213,610	1,240	1,260	2,500

Pyetësorët u administruan nga 43 intervistues të trajnuar për intervistat ballë-përballë duke përdorur teknikën PAPI (intervistë personale me laps dhe letër). Të dhënat u përpunuan dhe u analizuan për të paraqitur statistika përshkruese dhe relacionale, duke përdorur programin SPSS.

## 2.2 Instrumenti i sondazhit

Çdo vit, instrumenti i sondazhit ka të njëjtat pyetje bazë për besimin në qeverisje, korrupsionin, angazhimin qytetar, përdorimin e TIK siç evidentohet edhe në raportet e mëparshme që janë hartuar duke filluar që nga viti 2013. Megjithatë, përmbajtja e instrumentit shqyrtohet nga një ekip ekspertësh në fushat e qeverisjes së mirë dhe shkencave sociale për të ruajtur ritmin me zhvillimet dhe tendencat më të fundit në debatin publik. Këtë vit, u hoqën një sërë pyetjesh duke u bazuar te opinionet për përshtatshmërinë e tyre me fokusin e pyetësorit dhe për të bërë të mundur futjen e pyetjeve të reja por pa e bërë pyetësorin tepër të gjatë. Këtu përfshihen i gjithë seksioni për “performancën e institucioneve publike”, vlerësimin e cilësisë dhe përmbajtjes së faqeve të internetit të bashkive, dhe pyetjet pasuese për ushtrimin e të drejtës për informim dhe lloji i konsultimit publik që kanë ndjekur të anketuarit.

Për të reflektuar ngjarjet e vitit të kaluar, përfshirë pandeminë Covid-19 dhe pasojat e tërmetit të nëntorit 2019, në pyetësor u shtua një seksion i ri, ku analizohen opinionet e qytetarëve në lidhje me reagimin e qeverisë në periudhën e pas tërmetit dhe në atë të pandemisë. Nga ana tjetër, u shtua edhe një përgjigje tjetër alternative për fatkeqësitë natyrore në pyetjen nëse qytetarët ndihen të sigurt në jetën e tyre të përditshme. Së fundi, edhe pse Shqipëria nuk e njeh gjininë e tretë, në pyetësor është përfshirë edhe përgjigja alternative e gjinisë së tretë për të reflektuar konceptin jo-binar të gjinisë.

## 2.3 Fokus grupet

Për shkak të pandemisë dhe përkushtimit tonë për distancimin social me qëllim parandalimin e përhapjes së SARS-CoV-2, ky edicion i Sondazhit të Opinionit Publik “Besimi në qeverisje” nuk përfshin diskutime në fokus grupe.

## 2.4 Kufizimet


Ky është viti i dytë që në sondazhin e opinionit publik përdoret kampioni përfaqësues për të gjithë popullatën në Shqipëri dhe jo kampion me kuotë që u përdor në periudhën 2012-2018. Kjo do të thotë se rezultatet e Sondazhit të Opinionit Publik 2019 dhe 2020 mund të përgjithësohen për të gjithë popullsinë duke përdorur ponderimet e përfaqësimit të kampionit statistikor për të gjithë popullatën. Megjithatë, krahasimi i rezultateve statistikore të viteve 2019 dhe 2020 me vitet e mëparshme (2013-2018), në të cilat është përdorur kampionimi me kuotë, mund të sjellin një nivel pasigurie statistikore.

## 3. DEMOGRAFIA E KAMPIONIT

Për Sondazhin e Opinionit Publik “Besimi në qeverisje” 2020 në të gjithë vendin u anketuan në total 2,500 vetë në moshë madhore. Në këtë kapitull, karakteristikat demografike kryesore të kampionit përfundimtar të të anketuarve jepen më poshtë në lidhje me gjininë, përfaqësimin gjeografik, moshën, arsimin, statusin e punësimit, nivelin e të ardhurave individuale, përkatësisë në grupet e pakicave apo identifikimit si persona me aftësi të kufizuara.

Nga 2,500 të anketuar, 50.5% ishin femra dhe 49.4% meshkuj dhe një person zgjodhi alternativën “tjetër”<sup>6</sup>. Shpërndarja gjeografike ishte 72.8% banorë të zonave urbane dhe 27.2% të zonave rurale. Si për krahasim, të dhënat nga INSTAT tregojnë se në 2011, 58.2% e shqiptarëve jetonin në zonat urbane.<sup>7</sup> Gjithsesi, në dhjetë vitet e fundit ky numër është rritur.

Figura 1. Përfaqësimi gjinor




Baza: N = 2500



- 6 Meqenëse vetëm një person ka zgjedhur të identifikohet si “tjetër”, ose me gjini jo-binare, bazuar në kriteret e të dhënave statistikore përfaqësuese, përgjigjet e këtij personi nuk janë përfshirë veçmas në raport kur janë analizuar përgjigjet sipas gjinive.
- 7 INSTAT. (Maj 2014). Një klasifikim i ri urban-rural i popullsisë shqiptare. Marrë nga adresa: [http://www.instat.gov.al/media/2817/nj\\_klasifikim\\_i\\_ri\\_rural-urban\\_i\\_popullsis\\_shqiptare.pdf](http://www.instat.gov.al/media/2817/nj_klasifikim_i_ri_rural-urban_i_popullsis_shqiptare.pdf)



Figura 2. Përfaqësimi gjeografik



Baza: N = 2500

Për sa i përket shpërndarjes moshore, të anketuarit duhet të kishin mbushur të paktën moshën për të votuar, teksa në sondazh u përfshinë njerëz të moshës 18 vjeç e sipër. I anketuari më i moshuar ishte 87 vjeç. Pjesa më e madhe (63.8%) janë të moshës 18 deri në 45 vjeç: 17.4% ishin 18-25 vjeç, 26.7% 26-35 vjeç, dhe 19.7% të moshës 36-45 vjeç.<sup>8</sup> Një tjetër përqindje, 36.2%, e të anketuarve ishin të moshës 46-87 vjeç. Për të parë shpërndarjen e të anketuarve sipas secilës grupmoshë shihni Tabelën 2.

Tabela 2. Grupmoshat

Grupmoshat	Përqindja
18–25 vjeç	17,4%
26–35 vjeç	26,7%
36–45 vjeç	19,7%
46–55 vjeç	16,6%
56–65 vjeç	12,4%
Mbi 66	7,2%
<b>Total</b>	<b>100,0%</b>


Baza: N = 2500



8 Shpërndarja sipas moshës e kampionit është e njëjtë me atë të viteve të mëparshme. Ashtu si popullsia rezidente shqiptare (shih INSTAT), përqindja e të anketuarve të moshës 25-34 vjeç është më e madhe se ajo e grupmoshave të tjera.

Shumica e të anketuarve (77.7%) kishin mbaruar shkollën e mesme ose kishin diplomë universitare apo pasuniversitare. Plot 42.2% kishin përfunduar arsimin e mesëm; ndërkohë që 35.5% ose kishin përfunduar ose ishin duke ndjekur arsimin terciar (d.m.th., arsimin universitar apo pasuniversitar). Plot 22.4% e të anketuarve kishin përfunduar arsimin e detyrueshëm 8/9-vjeçar dhe vetëm 4% nuk kishin fare arsim ose kishin përfunduar vetëm atë fillor (4/5 vjet).

Figura 3. Niveli i arsimit të përfunduar



Baza: N = 2462

Në kohën që u realizua ky sondazh, 59.9% e të anketuarve ishin të punësuar, ndjekur nga të papunët që përbëjnë 24% të kampionit. 11.1% e të anketuarve ishin pensionistë dhe 6.5% ishin studentë. 0.4% e të anketuarve (11 vetë) raportuan një status të ndryshëm punësimi, për shembull, u deklaruan shtëpiakë, apo me aftësi të kufizuara.

Tabela 3. Statusi i punësimit


Statusi i punësimit	Nr.	Përqindja
<b>Të punësuar</b>	<b>1424</b>	<b>57.9%</b>
Sektori publik	381	27.7%
Sektori privat	969	70.4%
Tjetër	27	2.0%
Gjithsej	1377	100%
<b>I/e papunësuar</b>	<b>591</b>	<b>24.0%</b>
Student	161	6.5%
Pensionist	272	11.1%
Tjetër	11	0.4%
Gjithsej	2459	100.0%

Baza: N = 2459

Shpërndarja e të ardhurave mujore individuale të të anketuarve jepet në grafikun e mëposhtëm. 28.1% thanë se nuk kishin të ardhura të rregullta mujore në kohën kur u intervistuan, ndërsa 19% raportuan të ardhura neto deri në 24,000 lekë në muaj. Plot 31.6% merrnin 24,001-50,000 lekë në muaj, 12% fitonin 50,001-70,000 lekë në muaj dhe 2.5% e kampionit kishin të ardhura të rregullta individuale mujore mbi 70,001 lekë. 6.7% refuzuan të deklarorin të ardhurat e tyre mujore.

Ka dallime të konsiderueshme të të ardhurave mes të anketuarve femra dhe meshkuj. 33.1% e të anketuarve femra nuk kishin të ardhura të rregullta mujore përkundër 24% të të anketuarve meshkuj. Po ashtu, 50.3% e meshkujve të anketuar kishin të ardhura të rregullta mujore më shumë se 24,001 lekë, krahasuar me vetëm 42.1% të femrave të anketuara. 3.9% e të anketuarve meshkuj kishin të ardhura mesatare mujore më shumë se 70,001 lekë, ndërsa vetëm 1.1% e femrave të anketuara kishin këtë nivel të ardhurash mujore.

**Figura 4. Të ardhurat e rregullta individuale mujore (Neto)**



Baza: N = 2449

Të pyetur nëse e konsiderojnë veten me aftësi të kufizuara, vetëm 5.2% e të anketuarve vetë-raportuan se janë me aftësi të kufizuara (N = 124).

Në fund, të anketuarit u pyetën nëse i përkasin ndonjë pakice kombëtare. 4.4% e të anketuarve deklaruan se i përkasin një pakice. Nga kjo përqindje, 23.7% u identifikuan si grekë, 24.6% si romë, 13.2% si maqedonas, 8.8% si egjiptianë, dhe 4.4% si boshnjakë. 18.4% e të anketuarve që thanë se janë anëtarë të një pakice kombëtare nuk e deklaruan se cilit grup pakice i përkasin.

94.4% e të anketuarve nuk u identifikuan si anëtarë të pakicave kombëtare. Në Tabelën 4 jepen shifrat për të anketuarit që i përkasin grupeve të pakicave. Për shkak të përqindjes së

vogël të të anketuarve që raportojnë se i përkasin një pakice kombëtare, kjo karakteristikë demografike do të përfshihet vetëm në analizën e rezultateve të sondazhit, kur ka lidhje të drejtpërdrejta me pyetjen përkatëse (p.sh. diskriminimi ose pyetjet që lidhen me sigurinë).

*Tabela 4. A i përkisni ndonjë pakice kombëtare?*

A i përkisni ndonjë pakice kombëtare?	Nr.	Përqindja
<b>Po</b>	<b>110</b>	<b>4.4%</b>
Greke	27	1.1%
Maqedonase	15	0.6%
Arumune	1	<0.1%
Rome	28	1.1%
Egjiptiane	10	0.4%
Malazeze	3	0.1%
Boshnjake	5	0.2%
Serbe	1	<0.1%
Bullgare	3	0.1%
Refuzim/pakicë tjetër	21	0.8%
<b>Jo</b>	<b>2338</b>	<b>94.4%</b>
<b>Refuzim</b>	<b>28</b>	<b>1.1%</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>2476</b>	<b>100.0%</b>

Baza: N = 2476

## 4. REZULTATET E SONDAZHIT

### 4.1 Besimi në institucione

Besimi tek institucionet përfaqëson një nga shtyllat kryesore të Sondazhit të Opinioneve Publikë “Besimi në Qeverisje”. Besimi në institucione interpretohet si besimi tek organizmat shtetërorë. Këtu përfshihen parlamenti, qeveria, policia, gjykatat, institucionet publike të pavarura dhe tek organizatat jo-shtetërore si media, organizatat fetare dhe ato joqeveritare.<sup>9</sup> Huliumtimi i besimit tek institucionet ka rëndësi, sepse perceptohet si tregues kryesor i mirëqenies së individit dhe shoqërisë dhe një kusht themelor i veprimit dhe bashkëpunimit kolektiv.<sup>10</sup> Përveçse është thelbësor për kohezionin social, besimi tek institucionet dhe veçanërisht besimi tek qeveria vlerësohet si një nga themelet më të rëndësishme mbi të cilat ngrihen ligjshmëria dhe qëndrueshmëria e sistemeve politike. Mungesa e besimit komprometon vullnetin e qytetarëve dhe organizatave për t’iu përgjigjur politikave publike, duke penguar kështu zhvillimin e qëndrueshëm.<sup>11</sup>

Në pjesën e parë të kreut për besimin tek institucionet, të anketuarve iu kërkua të vlerësonin në një shkallë prej katër pikësh nga 1 (kam shumë besim) në 4 (nuk kam aspak besim) se sa i besojnë 17 aktorëve kryesorë shtetërorë dhe institucioneve publike. Supozimi bazë këtu është se shkalla e besimit në institucione të caktuara që tregohet nga të anketuarit në këtë sondazh të opinionit publik buron nga kombinimi i faktorëve në nivel makro dhe mikro. Implikimi këtu është se të anketuarit tregojnë shkallën e besimit të tyre si qytetarë bazuar në perceptimin e përgjithshëm dhe përvojat që kanë me institucionet e përmendura pa pasur nevojë të kenë njohuri dhe informacion për krijimin dhe/ose funksionimin e institucioneve përkatëse.



- 9 Eurofound (2018), Societal change and trust in institutions, Publications Office of the European Union, Luxembourg. Gjetet në adresën: <https://www.eurofound.europa.eu/publications/report/2018/societal-change-and-trust-in-institutions>
- 10 OECD (2013), ‘Trust in government, policy effectiveness and the governance agenda’. Gjetet në adresën: [https://www.oecd-ilibrary.org/governance/government-at-a-glance-2013/trust-in-government-policy-effectiveness-and-the-governance-agenda\\_gov\\_glance-2013-6-en](https://www.oecd-ilibrary.org/governance/government-at-a-glance-2013/trust-in-government-policy-effectiveness-and-the-governance-agenda_gov_glance-2013-6-en)
- 11 Po aty.

## Besimi në institucione, rezultatet e 2020


*Në vitin 2020, shqiptarët vazhduan t'i besonin më shumë institucioneve fetare (69.8%), pasuar nga institucionet arsimore (54.1%), organizatat e shoqërisë civile (52.6%) dhe forcat e armatosura (54%). Partitë politike (20.4%), gjykatat (23.8%), presidenti (23.9%), parlamenti (24.1%) dhe prokuroria (24.3%) ishin ndër institucionet me vlerësimin më të ulët për nivelin e besimit. Organizatat ndërkombëtare, si NATO, OKB dhe BE, renditen si institucionet më të besuara.*

Në 2020, nga institucionet në vend dhe aktorët kryesorë politikë, katër morën një vlerësim pozitiv besimi ('kam shumë besim' ose 'kam besim') nga më shumë se gjysma e të anketuarve. Këto institucione janë institucionet fetare (69.8%), organizatat e shoqërisë civile (52.6%), institucionet arsimore (54.1%), dhe forcat e armatosura (54.0%). Institucionet fetare u renditën si institucionet më të besuara në vend, me 22.3% e të anketuarve që thanë se kanë shumë besim dhe 47.6% që thanë se kanë besim te këto organizata. 27.9% e të anketuarve thanë se në përgjithësi nuk kanë besim tek institucionet fetare apo nuk kanë aspak besim te to. Institucionet e dyta më të besuara, organizatat e shoqërisë civile, kishin besimin më të madh të 12.0% të të anketuarve dhe besimin e 40.6% pjesëmarrësve në sondazh; ndërkohë 44.7% e të anketuarve thanë se në përgjithësi nuk i besojnë ose nuk i besojnë aspak organizatave të shoqërisë civile.

Institucionet kombëtare dhe aktorët kryesorë që morën vlerësimet më të ulëta për nivelin e besimit ishin partitë politike (20.4%), gjykatat (23.8%), presidenti (23.9%), parlamenti (24.1%) dhe prokuroria (24.3%). Për partitë politike, 42.9% e të anketuarve treguan se përgjithësisht nuk u besojnë këtyre institucioneve dhe 35.5% thanë se nuk u besojnë aspak partive politike. Po ashtu, 30.6% e të anketuarve thanë se nuk u besojnë aspak gjykatave, 29.7% e të anketuarve kishin të njëjtin nivel besimi te presidenti, dhe 29.1% për prokurorinë.

Qeveria qendrore dhe vendore gëzojnë nivel më të lartë besimi sesa pushteti legjislativ dhe gjyqësor. 41.6% e të anketuarve thanë se kanë besim te pushteti vendor, me 7.4% që thanë se kanë shumë besim dhe 34.2% që deklaruan se kanë besim te qeveria vendore. Për qeverinë qendrore, 36.4% e të intervistuarve deklaruan se kanë besim te ky institucion, ku 7% thanë se kanë shumë besim dhe 29.4% kanë besim te qeveria qendrore.

Figura 5: Besimi tek institucionet 2020



Baza: qeveria qendrore (N=2497); qeveria vendore (N=2497); presidenti (N=2499); parlamenti (N=2493); prokuroria (N=2495); gjykatat (N=2495); policia (N=2495); forcat e armatosura (N=2493); partitë politike (N=2491); institucionet e shëndetit publik (N=2493); institucionet arsimore (N=2490); media (N=2490); institucionet fetare (N=2494); OSHC (N=2488; BE (N=2494); OKB (N=2497); NATO (N=2494).

## Krahasimi social-demografik i besimit në institucione

*Shqiptarët e grupmoshës mbi 65 vjeç u shprehën më shpesh se kanë besim te presidenti, parlamenti, partitë politike, media, dhe institucionet fetare. Të anketuarit që banojnë në zonat rurale raportuan të njëjtin nivel apo disi më të lartë të besimit për 16 nga 17 institucionet e marra në vlerësim.*

Nuk u evidentuan dallime të mëdha sipas gjinisë, nivelit arsimor apo vendbanimit. Të anketuarat femra kishin më shumë gjasa të thonin se kishin besim te qeveria qendrore (38%) në krahasim me burrat (35%), ndërsa burrat ishin më të prirur të besonin te media (47%), OKB (77%) dhe NATO (77%) krahasuar me gratë (përkatësisht 44%, 75% dhe 75%). Të anketuarit e moshës 46-55 vjeç treguan nivele më të larta se mesatarja e besimit për parlamentin (30%), policinë (49%), ushtrinë (59%) dhe institucionet e kujdesit shëndetësor (50%). Po ashtu, të anketuarit e moshës mbi 66 vjeç raportuan nivel më të lartë besimi për partitë politike (27%), institucionet e kujdesit shëndetësor (52%) dhe institucionet fetare (75%). Për sa i përket statusit të punësimit, studentët nxorën në pah një nivel më të lartë besimi për ushtrinë (59%) sesa mesatarja, ndërsa të anketuarit në pension deklaruan një vlerësim më të lartë se mesatarja për policinë (48%) dhe median (51%). Në të njëjtën mënyrë, të anketuarit me të ardhura nga 50,001-70,000 lekë në muaj raportuan nivel më të lartë besimi te forcat e armatosura dhe të anketuarit me të ardhura mbi 70,001 lekë në muaj thanë se besonin më shumë tek institucionet e kujdesit shëndetësor.

Në përgjithësi, të anketuarit që jetojnë në zonat rurale deklaruan nivel të njëjtë apo më të lartë besimi se të anketuarit nga zonat urbane për të gjitha, me përjashtim të një institucioni. Më të rëndësishmet ishin qeveria qendrore (35% për të anketuarit urbanë përkundër 40% të atyre nga zonat rurale), presidenti (22% të anketuarit urbanë dhe 28% ruralë), partitë politike (19% me 24%), dhe organizatat e shoqërisë civile (51% me 56%). Shihni Tabelën 6 në fund të këtij kapitulli për të dhënat me ndarje social-demografike për besimin tek institucionet.

Të anketuarit që thanë se i përkisnin një grupi pakice<sup>12</sup> raportuan nivel më të ulët besimi te katër institucione: forcat e armatosura (46%), policia (38%), institucionet e kujdesit shëndetësor (39%), dhe institucionet arsimore (50%) në krahasim me të anketuarit që nuk i përkisnin grupeve të pakicave (54%, 43%, 45%, dhe 54% përkatësisht). Nga ana tjetër, të anketuarit që i përkasin grupeve të pakicës raportuan nivel më të lartë besimi te media (55%), partitë politike (25%) dhe institucionet fetare (75%), në krahasim me të intervistuarit që nuk i përkasin këtyre grupeve (45%, 20%, dhe 70% përkatësisht).



12 Për shkak të numrit të vogël të të anketuarve që thonë se i përkasin një grupi pakice, ka kufizime se sa përfaqësuese mund të jenë këto përgjigje për të gjithë qytetarët shqiptarë të pakicave. Prandaj, ky grup demografik përfshihet vetëm kur lidhet drejtpërdrejt me pyetjen ose kur vihet re mjaft qartë një trend.



Të anketuarit që thanë se kanë aftësi të kufizuar ishin më të prirur të thonin se besonin te qeveria qendrore (44%), qeveria vendore (47%), parlamenti (31%), dhe media (53%) në krahasim me të anketuarit që nuk kanë raportuar aftësi të kufizuar (36%, 41%, 24%, dhe 45% përkatësisht). Si për krahasim, të intervistuarit me aftësi të kufizuara ishin më pak të prirur për të raportuar se besonin te presidenti (15%) sesa të anketuarit që thanë se nuk kanë asnjë paaftësi (24%).

Kur bëjmë krahasime për nga madhësia e bashkive në lidhje me besimin në qeverisjen vendore, të anketuarit që jetojnë në bashki të vogla (<50,000 banorë) raportuan nivele më të larta besimi (46%) se ata që banojnë në bashki të mesme (50,000–100,000 banorë) (44.3%), apo në bashki të mëdha (>100,000 banorë) (39.3%). Së fundi, të dhënat nuk shfaqin ndonjë dallim madhor për nivelin e besimit të partitë politike të raportuar nga të anketuarit që janë anëtarë të një partie dhe të anketuarit që nuk janë anëtarë partie. Në fakt, edhe nga anëtarët e partive politike raportohet nivel i ulët besimi: në total 75.3% thanë se në përgjithësi nuk i besojnë partive politike (40.2%) apo nuk kanë aspak besim tek to (35.1%).

### **Besimi tek institucionet në vite**

*Krahasuar me vitin 2019, ka rënë besimi te policia (- 12 p.p.), institucionet e kujdesit shëndetësor (- 6 p.p.), media (- 6 p.p.), qeveria qendrore (- 5 p.p.) dhe forcat e armatosura (- 5 p.p.), ndërkohë që është rritur besimi tek institucionet fetare (+ 4 p.p.). Organizatat ndërkombëtare si BE, OKB, dhe NATO, të cilat patën një rritje të konsiderueshme besimi në 2017, u kthyen përsëri në nivelet e besimit të raportuara në vitet 2015/2016.*

Krahasuar me Sondazhin e vitit 2019, që u krye pikërisht me të njëjtën metodologji dhe kampion, nivelet e vlerësimit kanë rënë disi për pjesën më të madhe të institucioneve. Në mënyrë të veçantë, besimi te policia (- 12 p.p.), institucionet e kujdesit shëndetësor (- 6 p.p.), media (- 6 p.p.), qeveria qendrore (- 5 p.p.), dhe forcat e armatosura (- 5 p.p.) ka rënë, në krahasim me rezultatet e vitit 2019. Nga ana tjetër, niveli i besimit tek institucionet fetare është rritur, krahasuar me vitin e kaluar (+ 4 p.p.).

Për sa i përket ndryshimeve në nivelin e besimit ndër vite, përafërsisht që prej vitit 2017, ka pasur një rënie të dukshme të besimit të publikut tek institucionet. Për qeverinë qendrore, presidentin, parlamentin, policinë, forcat e armatosura, institucionet e kujdesit shëndetësor, sistemin arsimor dhe median, besimi ka rënë me rreth 10 p.p. Gjyqësori, që është i ndarë në gjykata dhe prokurori që nga viti 2017 e më tej, ka përjetuar një rënie të qëndrueshme të besimit gjatë tre viteve të fundit: ndërkohë që në vitin 2018 përqindja e të anketuarve që thonin se kishin besim tek gjykatat dhe prokuroria ishte 28%, kjo u ul në 27% në 2019 dhe 24% në 2020. Edhe institucionet dhe organizatat ndërkombëtare kanë parë të bjerë niveli i besimit tek to, veçanërisht kur krahasohen me 2017, por secila prej tyre ende gëzon besimin e më shumë se 75% të të anketuarve.

Tabela 5: Besimi tek institucionet 2015–2020\*

	2015	2016	2017	2018	2019	2020
<b>Qeveria qendrore</b>	34%	44%	47%	42%	41%	36%
<b>Qeveria vendore</b>	X	49%	49%	47%	42%	42%
<b>Presidenti</b>	29%	36%	33%	30%	28%	24%
<b>Parlamenti</b>	22%	27%	34%	30%	28%	24%
<b>Gjyqësori**</b>	17%	23%	X	X	X	X
<b>Prokuroria</b>	X	X	22%	28%	27%	24%
<b>Gjykatat</b>	X	X	21%	28%	27%	24%
<b>Policia</b>	46%	61%	53%	58%	55%	43%
<b>Forcat e armatosura</b>	46%	55%	63%	63%	59%	54%
<b>Partitë politike</b>	15%	23%	21%	22%	23%	20%
<b>Institucionet e shëndetit publik</b>	27%	50%	53%	54%	51%	45%
<b>Institucionet e arsimit publik</b>	33%	59%	63%	64%	57%	54%
<b>Media</b>	39%	58%	54%	56%	51%	45%
<b>Institucionet fetare</b>	52%	58%	76%	73%	66%	70%
<b>Shoqëria civile</b>	38%	46%	57%	57%	56%	53%
<b>Bashkimi Evropian</b>	72%	80%	85%	80%	73%	75%
<b>Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB)</b>	X	80%	85%	79%	75%	76%
<b>NATO</b>	74%	79%	84%	81%	78%	76%

Baza: N=2488-2499 në 2020; N=2499 në 2019; N=1647 në 2018, 2017, 2016.

\*Shënim: Që nga viti 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

\*\* Nga viti 2017 e më tej, 'Gjyqësori' është ndarë në 'Prokurori' dhe 'Gjykata'

## Reforma në Drejtësi

*28.7% e popullsisë në Shqipëri e anketuar në këtë sondazh beson se reforma në drejtësi po zbatohet me korrektësi dhe 52.8% e të anketuarve besojnë se reformat do të kenë ndikim pozitiv në zhvillimin e vendit. Gjatë periudhës 2016-2020, përqindja e të anketuarve që mendojnë se reforma në drejtësi po zbatohet me korrektësi dhe që do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e Shqipërisë ka rënë me 17 p.p dhe 18 p.p. përkatësisht.*

Në vitin 2016, Shqipëria ndërmori një proces jashtëzakonisht sfidues të reformimit të sistemit të saj të drejtësisë, duke synuar të luftojë korrupsionin e përhapur dhe ndikimin politik si dhe të (ri)ndërtojë besimin e publikut tek sistemi gjyqësor. Kjo paketë komplekse reformash nisi me procesin e vetingut për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët dhe me

ngritjen e institucioneve të reja siç janë Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK). Progresi me zbatimin e reformës në drejtësi, në mënyrë të veçantë procedura e vetingut, është njohur nga BE.<sup>13</sup> Gjithsesi, si BE ashtu dhe SHBA i kanë kërkuar qeverisë dhe aktorëve politikë në Shqipëri të ruajnë dhe thellojnë ritmin e reformës, veçanërisht në fushën e gjyqësorit dhe shtetit ligjor.

Në vitin 2020, 28.7% e popullsisë në Shqipëri e anketuar në këtë sondazh beson se reforma në drejtësi po zbatohet me korrektësi, ndërsa 53.3% e të anketuarve thanë se mendonin se reforma nuk po zbatohet me korrektësi. Megjithatë, shumica e të anketuarve (52.8%) besonin se reformat do të kenë ndikim pozitiv në zhvillimin e vendit. Vetëm 31% thanë se kjo reformë nuk do të ketë ndikim pozitiv në Shqipëri dhe 16.2% nuk dinin të përgjigjeshin.

**Figura 6: Ndikimi i perceptuar dhe zbatimi i reformës në drejtësi 2020**

Zbatimi i reformës në drejtësi



Ndikimi pozitiv i reformës në drejtësi



● Po ● Jo ● Nuk e di

Baza: N=2494 për zbatimin e reformës në drejtësi; N=2493 për ndikimin e reformës në drejtësi

Dallimet sipas gjinisë, nivelit arsimor, statusit të punësimit, nivelit të të ardhurave dhe vendbanimit nuk ishin të mëdha. Të anketuarat femra ishin njësoj të prirura të tregonin se mendojnë se reforma në drejtësi po zbatohet me korrektësi (28%) dhe se ka ndikim pozitiv në zhvillimin e Shqipërisë (52%) njësoj si meshkujt (29% dhe 54% përkatësisht). Të anketuarit në grupmoshën 36-45 vjeç ishin më pak të prirur të perceptonin se reforma në drejtësi po zbatohet me korrektësi (49%) ose se reforma do të ketë ndikim pozitiv (25%). Nga ana tjetër, të anketuarit në grupmoshën 46-55 vjeç ishin më shumë të predispozuar të mendonin se reforma po zbatohet në mënyrë korrekte (56%) ose se do të ketë ndikim pozitiv (33%). Të anketuarit që treguan se i përkasin një grupi pakicash kishin më pak gjasa të perceptonin se reforma në drejtësi po zbatohet siç duhet (20%), ndërsa të anketuarit që thanë se janë me aftësi të kufizuara kishin më shumë gjasa të raportonin se besonin që


•••••

13 Komisioni Evropian (2019), 'Raporti për Shqipërinë 2019. Gjetendet në adresën: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>.

reforma do të kishte ndikim pozitiv në zhvillimin e Shqipërisë (62%). Për një ndarje të plotë social-demografike të përgjigjeve për reformën në drejtësi, shihni Tabelën 7 në fund të këtij kapitulli.

Krahasuar me vitin 2019, perceptimi se reforma në drejtësi po zbatohet me korrektësi ka rënë me 3 p.p., ndërsa ndikimi i perceptuar në zhvillimin pozitiv në Shqipëri ka mbetur i njëjtë. Megjithatë, kur e rihedhim vështrimin te perceptimet e publikut në fillimin e reformave në vitin 2016, mund të shohim se perceptimi i zbatimit me korrektësi ka rënë me 17 p.p. nga 46% në 2016 në 29% në 2020. Në të njëjtën linjë, gjatë periudhës 2016-2020 përqindja e të anketuarve që besuan se reformat në drejtësi do të kishin ndikim pozitiv u ul me 18 p.p. nga 71% në 53%.

**Figura 7: ‘Ndikimi pozitiv’ përkundër ‘zbatimit me korrektësi’ të reformës në drejtësi në zhvillimin e vendit, përqindja e atyre që thanë ‘po’ në 2016–2020**



Baza: Për ndikimin e reformës në drejtësi, 2016 (N=1639); 2017 (N=1644); 2018 (N=1642); 2019 (N=2494); 2020 (N=2493). Për zbatimin e reformës në drejtësi, 2016 (N=1641); 2017 (N=1646); 2018 (N=1645); 2019 (N=2498); 2020 (N=2494).


\*Shënim: Që nga viti 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

## Media

*Edhe pse mediat sociale (36%) dhe portalet (15%) po bëhen përherë e më shumë popullore për shqiptarët, televizioni (58%) mbetet burimi mediatik më popullor për marrjen e të rejave më të fundit për aktualitetin, veçanërisht për banorët e zonave rurale. Krahasuar me vitet e mëparshme, mediat sociale po bëhen më popullore tek brezat në moshë të madhe, madje edhe tek ata mbi 65 vjeç. Mediat sociale janë veçanërisht popullore te të anketuarit me të ardhura mbi 70,001 lekë (48%).*

Shumica e të anketuarve të sondazhit të vitit 2020 (58%) thanë se përdornin televizionin si burimin kryesor për marrjen e të rejave nga aktualiteti, pasuar nga mediat sociale (36%), portalet (15.4%), gazetatat (6%) dhe radio (2.4%). Një tjetër 0.5% e të anketuarve thanë se përdornin një tjetër burim informacioni për të reja nga aktualiteti, përfshirë këtu edhe “çfarë më thonë fëmijët”, “Këtë informacion e marr nga miqtë”, “Informacionin e marr nga të njohurit”, apo “Nuk e ndjek [aktualitetin]”.

**Figura 8: Mediat më të përdorura për marrjen e informacionit për aktualitetin**



Baza: N = 2491

\*Shënim: disa të anketuar zgjodhën më shumë se një alternativë; përqindjet nuk plotësojnë totalin prej 100%.

Për sa i përket ndryshimeve sipas moshës, arsimit, statusit të punësimit dhe paaftësisë së kufizuar: gratë (60%) përdorën televizionin si burimin e tyre kryesor të informacionit më shpesh sesa burrat (57%), ndërsa burrat përdorën mediat sociale (38%) si burimin e tyre kryesor më shpesh se gratë (35%). Të anketuarit me të ardhura më të larta se 70,001 lekë ishin më shumë të prirur të përdornin mediat sociale si burimin e tyre kryesor të informacionit për aktualitetin (48%), ndërsa të anketuarit që banonin në zonat rurale (65%) dhe të anketuarit që i përkisnin një grupi minoriteti (64%) kishin më shumë të ngjarë të tregonin se për ta, televizioni ishte burimi kryesor i informacionit për aktualitetin. Për një ndarje të plotë të të dhënave sipas demografisë, shihni Tabelën 8 në fund të këtij kapitulli.


Edhe pse televizioni mbetet burimi më i përdorur për informim për aktualitetin te të anketuarit, ky medium ka regjistruar një rënie të madhe në krahasim me vitin 2017 kur 70% e të anketuarve deklaruan se televizioni ishte mediumi i tyre më i përdorur. Të dhënat nga Sondazhi i Opinioneve të vitit 2020 tregojnë një rritje të përdorimit të mediave sociale nga 18% në 2017, në 22% në 2018, në 25% në 2019 dhe 36% në 2020. Këtë vit, për herë të parë, edhe brezat e mëdhenj në moshë evidentuan mediat sociale si burimin kryesor për të reja më të fundit nga aktualiteti: 40% e të anketuarve të moshës 56-65 vjeç dhe 38% e të anketuarve në grupmoshën mbi 65 vjeç thanë se mediat sociale janë burimi i tyre kryesor i informacionit për aktualitetin. Po ashtu, përdorimi i portaleve është rritur nga 7% në 2018 në 15% në 2020.

## Saktësia e mediave

*Një në tre shqiptarë beson se informacioni i dhënë nga media në Shqipëri është i saktë/i vërtetë, me një rënie prej 15 p.p. krahasuar me vitin 2016. Shqiptarët që përdorin radion (57.4%) ose televizionin (39.3%) si burimin e tyre kryesor të informacionit për lajmet për aktualitetin kanë më shumë gjasa të besojnë se informacioni i dhënë nga mediat shqiptare është i saktë dhe/ose i vërtetë.*

35.1% e të anketuarve besojnë se informacioni i ofruar nga mediat shqiptare është i vërtetë/i saktë. 40.4% thanë se nuk e besonin një gjë të tillë dhe 24.5% nuk ishin të sigurt. Të anketuarit që raportuan mediat sociale si burimin më të përdorur për lajme për çështjet aktuale ishin më mosbesues për sa i përket saktësisë së informacionit të dhënë nga mediat shqiptare, ku vetëm 26.7% e të anketuarve thanë se informacioni i dhënë është i saktë/e vërtetë. Të intervistuarit që përdorin radion, nga ana tjetër, tregojnë më shpesh se informacioni i dhënë nga mediat shqiptare është i saktë dhe/ose i vërtetë (57.4%), pasuar nga ata që përdorin televizionin si burimin e tyre kryesor për lajmet e aktualitetit (39.3%).


**Figura 9: Perceptimi për saktësinë e informacionit të dhënë nga burimi më i përdorur mediatik 2020**



Baza: N = 2491

Krahasuar me vitet e mëparshme, përqindja e të anketuarve që mendonin se informacioni i dhënë nga mediat shqiptare është i saktë/i vërtetë ka rënë me 15 p.p., nga 50% në 2016 dhe 2017 në 35% në 2020.

Figura 10: Saktësia e mediave 2016–2020



Baza: 2016 (N=1639); 2017 (N=1646); 2018 (N=1643); 2019 (N=2496); 2020 (N=2491).

\*Shënim: Që nga viti 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.


### Mbështetja për donatorët e huaj

*Shumica e shqiptarëve ishin të kënaqur (53.4%) ose shumë të kënaqur (8%) me ndikimin e asistencës së huaj në Shqipëri.*

Shumica e shqiptarëve (61.4%) ishin të kënaqur me ndikimin e asistencës së huaj (donatorët) në Shqipëri: 8% ishin shumë të kënaqur dhe 53.4% ishin të kënaqur me ndikimin e donatorëve të huaj.

Nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, nivelit të të ardhurave apo vendbanimit. Të anketuarat femra (61%) dhe të anketuarit meshkuj (62%) kishin të njëjtat gjasa të raportonin se ishin të kënaqur me asistencën e donatorëve të huaj në Shqipëri. Grupmoshat më të mëdha në moshë, si të anketuarit e moshës 56-65 vjeç dhe mbi 66 vjeç, kishin më shumë gjasa të ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me ndikimin e asistencës së donatorëve të huaj në Shqipëri. Të anketuarit në pension (65.3%) dhe të anketuarit që punojnë në sektorin publik (65%) ishin më shumë të predispozuar të ishin të kënaqur me ndikimin e ndihmës së donatorëve të huaj, ndërsa studentët (56.3%) kishin më pak gjasa të ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me këtë asistencë. Të anketuarit që raportuan se ishin anëtarë të një grupi pakicash (57%) ose të anketuar që tregonin se kishin aftësi të kufizuara (58%) raportuan më rrallë se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me ndikimin e asistencës së donatorëve të huaj në Shqipëri.

Figura 11: Kënaqësia me donatorët e huaj në Shqipëri



Baza: N = 2466

Të anketuarit që thanë se besojnë se organizatat ndërkombëtare i kërkojnë llogari qeverisë ishin më shumë të prirur të ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me mbështetjen e donatorëve të huaj në Shqipëri (shihni pjesën 4.2 “Transparenca dhe llogaridhënia”, pyetja “Sipas jush, cila prej të mëposhtëmve e bën qeverinë më të përgjegjshme për veprimet/mosveprimet e saj?”). 65.8% e të anketuarve që besojnë se organizatat ndërkombëtare i kërkojnë llogari qeverisë shqiptare ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me ndikimin e asistencës së huaj (donatorët) në Shqipëri, ndërsa vetëm 49.5% e të anketuarve që nuk besojnë se organizatat ndërkombëtare i kërkojnë llogari qeverisë janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me ndikimin e donatorëve të huaj.



Tabela 6: Ndarja demografike e besimit ('Kam shumë besim' dhe 'Kam besim')

	Qeveria qendrore	Qeveria vendore	Presidenti	Parlamenti	Prokuroria	Gjykatat	Policia	Ushtria	Partitë politike	Kujdesi shëndetësor	Arsimi	Media	Institucionet fetare	OSHC	BE	OKB	NATO	
<b>Gjithsej (% e Besimit)</b>	36%	42%	24%	24%	24%	24%	43%	54%	20%	45%	54%	45%	70%	53%	75%	76%	76%	
Gender																		
Meshkuj	35%	41%	24%	24%	24%	24%	43%	54%	20%	46%	54%	47%	70%	52%	75%	77%	77%	
Femra	38%	42%	24%	25%	25%	24%	44%	54%	21%	44%	54%	44%	70%	53%	75%	75%	75%	
Age																		
18-25	35%	43%	23%	21%	25%	23%	43%	57%	19%	46%	58%	45%	68%	53%	74%	75%	76%	
26-35	37%	41%	25%	24%	25%	23%	41%	52%	20%	44%	53%	42%	67%	50%	73%	75%	75%	
36-45	33%	38%	23%	22%	23%	23%	40%	51%	17%	40%	50%	44%	71%	53%	74%	74%	74%	
46-55	40%	46%	25%	30%	26%	28%	49%	59%	24%	50%	58%	48%	72%	55%	78%	80%	79%	
56-65	36%	43%	21%	22%	21%	21%	44%	53%	20%	45%	51%	47%	72%	52%	76%	77%	78%	
mbi 66 vjeç	39%	40%	28%	28%	27%	27%	46%	57%	27%	44%	57%	52%	75%	55%	78%	79%	76%	
Educational attainment																		
Arsim deri 9-vjeçar *	36%	41%	21%	26%	25%	26%	44%	56%	20%	45%	55%	46%	73%	52%	78%	79%	77%	
Me arsim të mesëm	35%	41%	25%	24%	24%	24%	42%	52%	20%	44%	53%	45%	68%	52%	73%	74%	75%	
Me arsim universitar	38%	44%	24%	24%	24%	23%	43%	56%	21%	46%	55%	45%	70%	54%	76%	77%	76%	
Employment status																		
I/E punësuar	Gjithsej	35%	40%	24%	23%	23%	22%	41%	20%	45%	53%	45%	70%	52%	74%	77%	76%	
	Sektori publik	38%	43%	22%	22%	21%	18%	43%	24%	45%	53%	45%	72%	53%	75%	78%	78%	
I/E papunë	Sektori privat	34%	39%	25%	23%	23%	24%	40%	19%	45%	54%	46%	69%	52%	74%	75%	75%	
		38%	43%	21%	26%	26%	26%	45%	19%	43%	56%	43%	69%	51%	51%	76%	77%	
Student	35%	44%	27%	21%	27%	23%	46%	59%	19%	46%	53%	45%	70%	54%	54%	76%	72%	
Pensionist	39%	43%	26%	26%	26%	25%	48%	56%	23%	44%	56%	51%	73%	56%	56%	78%	77%	
Geographic representation																		
Urban	35%	41%	22%	23%	24%	24%	42%	54%	19%	44%	54%	45%	69%	51%	75%	77%	76%	
Rural	40%	44%	28%	26%	24%	24%	45%	54%	24%	46%	54%	47%	72%	56%	75%	75%	75%	
Income																		
Pa të ardhura	37%	44%	22%	26%	26%	26%	25%	45%	19%	44%	55%	44%	70%	52%	77%	76%	75%	
Deri në 24,000 lekë	35%	40%	24%	22%	24%	23%	42%	53%	18%	42%	50%	47%	70%	53%	75%	75%	76%	
24,001-50,000 lekë	35%	41%	25%	24%	23%	23%	42%	52%	22%	46%	54%	46%	69%	50%	73%	75%	77%	
50,001-70,000 lekë	38%	41%	23%	24%	23%	24%	41%	59%	22%	48%	58%	43%	73%	57%	77%	79%	77%	
Mbi 70,001 lekë	34%	39%	23%	15%	25%	21%	41%	52%	21%	52%	56%	46%	69%	49%	70%	74%	72%	

\* Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshihet të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar). Shënimi: Ngjyrat përfaqësojnë diferencat prej >5 p.p. me totalin e përgjigjeve.

Tabela 7: Ndarja demografike për reformën në drejtësi

	Ndikimi pozitiv i reformës në drejtësi (% 'Po')	Zbatimi me korrektësi i reformës në drejtësi (% 'Po')	
<b>Gjithsej</b>			
	<b>53%</b>	<b>29%</b>	
	<b>Gjinia</b>		
Meshkuj	54%	29%	
Femra	52%	28%	
	<b>Mosha</b>		
18 - 25 vjeç	55%	32%	
26 - 35 vjeç	52%	28%	
36 - 45 vjeç	49%	25%	
46 - 55 vjeç	56%	33%	
56 - 65 vjeç	51%	25%	
mbi 66 vjeç	55%	30%	
	<b>Niveli i arsimit</b>		
Arsim deri 9-vjeçar	53%	30%	
Me arsim të mesëm	51%	29%	
Me arsim universitar	55%	28%	
	<b>Statusi i punësimit</b>		
I/E punësuar	Gjithsej	54%	28%
	Sektori publik	55%	26%
	Sektori privat	29%	29%
I/E papunë	51%	29%	
Student	52%	31%	
Pensionist	53%	29%	
	<b>Niveli i të ardhurave</b>		
Pa të ardhura	52%	30%	
Deri në 24,000 lekë	53%	29%	
24,001 – 50,000 lekë	54%	28%	
50,001 – 70,000 lekë	55%	31%	
Mbi 70,001 lekë	49%	28%	
	<b>Vendbanimi</b>		
Urban	53%	28%	
Rural	53%	32%	

\* Grupi “Arsim deri 9-vjeçar” përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë diferencat prej >5 p.p. me totalin e përgjigjeve.

Tabela 8: Ndarja demografike për mediat

		Burimi mediatik më i përdorur				
		TV	Radio	Gazetat	Portalet	Mediat sociale
<b>Gjithsej</b>		<b>58%</b>	<b>2%</b>	<b>6%</b>	<b>15%</b>	<b>36%</b>
<b>Gjinia</b>						
Meshkuj		57%	3%	6%	16%	38%
Femra		60%	2%	6%	15%	35%
<b>Mosha</b>						
18 - 25 vjeç		61%	2%	4%	16%	34%
26 - 35 vjeç		58%	3%	6%	17%	39%
36 - 45 vjeç		60%	3%	8%	13%	32%
46 - 55 vjeç		57%	2%	6%	18%	36%
56 - 65 vjeç		58%	2%	5%	13%	40%
mbi 66 vjeç		55%	3%	7%	15%	38%
<b>Niveli arsimor</b>						
Arsim deri 9-vjeçar*		55%	2%	5%	15%	36%
Me arsim të mesëm		61%	2%	6%	15%	36%
Me arsim universitar		57%	3%	7%	17%	38%
<b>Statusi i punësimit</b>						
I/E punësuar	Gjithsej	59%	3%	7%	15%	37%
	Sektori publik	55%	3%	9%	18%	38%
	Sektori privat	60%	3%	6%	14%	37%
I/E papunë		59%	2%	5%	16%	34%
Student		62%	2%	4%	16%	37%
Pensionist		56%	3%	7%	15%	37%
<b>Niveli i të ardhurave</b>						
Pa të ardhura		60%	2%	4%	15%	35%
Deri në 24,000 lekë		55%	3%	6%	17%	34%
24,001 – 50,000 lekë		60%	3%	7%	14%	37%
50,001 – 70,000 lekë		58%	2%	6%	16%	37%
Mbi 70,001 lekë		56%	5%	5%	12%	48%
<b>Vendbanimi</b>						
Urban		56%	3%	6%	16%	37%
Rural		65%	2%	7%	13%	33%

\* Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë diferencat prej >5 p.p. me totalin e përgjigjeve.

## 4.2 Transparenca dhe llogaridhënia

Transparenca dhe llogaridhënia e administratës publike janë tejet të rëndësishme për teorinë dhe praktikën e qeverisjes së mirë dhe konsiderohen si elementë thelbësorë që lidhen me funksionimin e duhur të sistemit të demokracisë. Transparenca dhe llogaridhënia forcojnë njëra-tjetrën dhe në të njëjtën kohë u bëjnë të mundur qytetarëve të ndikojnë në procesin vendimmarrës dhe t’u kërkojnë llogari pushtetarëve. Prandaj, krijimi i institucioneve të përgjegjshme dhe transparente është pjesë e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së; në mënyrë më specifike ‘Objektivi 16: Promovimi i shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i aksesit në drejtësinë për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënese dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet’ dhe ‘Objektivi 16.6.: Zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënese dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet’.<sup>14</sup>

Në themel të konceptit të transparencës është supozimi kryesor se qeveria vepron në mënyrë të hapur. Kjo përfshin ndër të tjera transparencën e qeverisë për mënyrën si vepron, për veprimtarinë dhe shpenzimet e saj, për operacionet e saj dhe për vendimet që merr. Element kyç i transparencës është e drejta për akses tek informacioni që është në pronësi të autoriteteve publike. Megjithatë, transparenca përfshin edhe elementë të tjerë, si ofrimi i mundësive që takimet e institucioneve publike vendimmarrëse të jenë të hapura për publikun.<sup>15</sup>

Llogaridhënia presupozon se qeveria duhet të marrë përgjegjësinë për vendimet dhe veprimet e saj. Llogaridhënia ka dy dimensione: përgjegjësia për t’u përgjigjur – ose detyrimi i autoriteteve publike për t’i dhënë informacion dhe shpjegime publikut në lidhje me veprimtaritë e tyre; dhe zbatimi ose mekanizmat, me anë të të cilave merret informacioni nëpërmjet përgjegjësisë për t’u përgjigjur, mund të bëhen efikase në sigurimin e llogaridhënies. Kjo e fundit mund të jetë vertikale – drejtpërdrejtë me publikun – ose horizontale – mundësohet nëpërmjet mekanizmave që veprojnë ndërmjet institucioneve publike.<sup>16</sup>



- 14 Organizata e Kombeve të Bashkuara. (2019). Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Gjetet në adresën: <https://www.un.org/sustainabledevelopment/peace-justice/>
- 15 Shpjegimi i koncepteve bazohet kryesisht në kumtesën “Standartet Ndërkombëtare për Transparencën dhe Llogaridhënien”. Qendra për Ligj dhe Demokraci (2014). Marrë nga adresa: [http://www.law-democracy.org/live/wp-content/uploads/2014/04/Transparency-and-Accountability.final\\_.Mar14.pdf](http://www.law-democracy.org/live/wp-content/uploads/2014/04/Transparency-and-Accountability.final_.Mar14.pdf)
- 16 Po aty.


## Transparenca

*Shumica e shqiptarëve të anketuar i perceptojnë qeverinë qendrore (64.3%) dhe bashkitë (62.2%) si jo transparente. Në mënyrë të veçantë, të anketuarit me të ardhura mujore mbi 70 001 lekë thanë se nuk janë dakord me pohimin ‘qeveria qendrore/bashkia është transparente’: nga ky grup demografik vetëm 32% ishin dakord me pohimet.*

Shumica e të anketuarve nuk janë dakord (62.2%) se bashkia është transparente. Vetëm 6.4% e të anketuarve thanë se janë plotësisht dakord me pohimin ‘Bashkia është transparente’, ndërkohë që 36.8% ishin dakord ose plotësisht dakord. Po ashtu, 64.3% e të anketuarve nuk besojnë se qeveria qendrore është transparente, ndërsa 34.6% nuk janë të mendimit se qeveria qendrore është transparente: 28.2% ishin dakord me pohimin dhe 6.4% thanë se janë plotësisht dakord.

**Figura 12: Perceptimi për transparencën e qeverisë qendrore dhe vendore 2020**

Bashkia është transparente



Qeveria qendrore është transparente



Baza: Për qeverinë qendrore (N=2495), për bashkitë (N=2494)

Kur bëjmë krahasime sipas karakteristikave demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, nivelit arsimor, sektorit të punësimit, vendbanimit, aftësisë së kufizuar, apo nëse i anketuari i përkiste ndonjë grupi pakice. Të anketuarat femra ishin po aq të prirura të mendonin se qeveria qendrore (35%) dhe bashkia (37%) janë transparente në krahasim me të intervistuarit meshkuj (35% dhe 36% përkatësisht). Të anketuarit në grupmoshën 36-45 vjeç (32%) me nivel të ardhurash mbi 70 001 lekë (32%) ishin më pak të prirur të thonin se bashkia është transparente. Të anketuarit që janë anëtarë të një partie politike (43%)

janë më të prirur ta konsiderojnë bashkinë si transparente në krahasim me të anketuarit që thanë se nuk janë anëtarë të asnjë partie politike (36%).


Të anketuarit me nivel të ardhurash mujore prej 50 001 - 70 001 lekë (40%) apo të anketuarit në grupmoshën 46-55 vjeç (39%) ishin më të predispozuar të thonin se e mendojnë qeverinë qendrore si transparente, ndërsa të intervistuarit me nivel të ardhurash mbi 70 001 lekë (28%) ishin më pak të prirur të thonin se e konsideronin qeverinë qendrore si transparente. Për më shumë informacion për ndarjen demografike të përgjigjeve, shihni Tabelën 10 në fund të këtij kapitulli.

### Transparenca në vite

*Krahasuar me vitin 2019, perceptimi për transparencën në nivelin qendror dhe vendor të qeverisjes është rritur me 1 p.p. dhe 2 p.p. përkatësisht. Gjithsesi, kur shohim tendencën afatgjatë, perceptimi për transparencën e qeverisë, qendrore e vendore, ka rënë.*

Krahasuar me vitin 2019, perceptimi për transparencën në nivelin qendror dhe vendor të qeverisjes është rritur me 1 p.p. dhe 2 p.p. përkatësisht. Kur shohim perceptimin për transparencën e qeverisë qendrore dhe pushtetit vendor në vite, vihet re një rënie e vogël. Ndërkohë që në 2016 43% e të anketuarve thanë se qeveria qendrore ishte transparente, vetëm 37% thanë të njëjtën gjë në 2020 (-6 p.p.). Në të njëjtën linjë, në 2016 39% e të anketuarve e mendonin bashkinë si transparente, ndërkohë që në 2020 kjo përqindje ra në 35%.

**Figura 13: Ndryshimi në transparencën e perceptuar të institucioneve 2016-2020**



Baza: qeveria qendrore: 2016 (N=1647); 2017 (N=1636); 2018 (N=1644); 2019 (N=2492); 2020 (N=2495), dhe bashkia: 2016 (N=1645); 2017 (N=1637); 2018 (N=1642); 2019 (N=2489); 2020 (N=2494).


\*Shënim: Që nga viti 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

## Ushtrimi i të drejtës për informim

*Shumica e shqiptarëve të anketuar (64.1%) ishin të ndërgjegjësuar se e drejta për informim është e garantuar me ligj. Shqiptarët e moshës mbi 65 vjeç ose me të ardhura 50 001 - 70 000 lekë ishin më të predispozuar për të qenë të ndërgjegjësuar se e drejta për informim është e garantuar me ligj (të dy grupet me 70%).*

Një element kryesor për transparencën është aksesimi në informacion që kanë autoritetet publike, të rregulluara tashmë me Ligjin Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Ushtrimi i së drejtës për informim bazohet në dy dimensione: ndërgjegjësimi i qytetarëve për të drejtën e tyre për të marrë informacione dhe paraqitja nga ana e tyre e një kërkesë për informacion. Ligji për të drejtën e informacionit parashikon që çdokush ka të drejtë të ketë akses tek informacioni publik pa pasur nevojë të shpjegojë arsyen pse e ka kërkuar këtë informacion. Procedura kërkon që kërkesat për informacion të bëhen me shkrim dhe të dorëzohen me dorë, me postë ose email, me identitetin e saktë të kërkuarit dhe nënshkrimin e tij/saj. Autoriteti publik, nga ana e tij, përpunon kërkesën për informacion jo më vonë se 10 ditë pune pas ditës së marrjes së kërkesës (Ligji Nr. 119/2014). 64.1% e të anketuarve që iu përgjigjën kësaj pyetje thanë se e dinin që e drejta për informacion është e garantuar me ligj në Shqipëri, ndërsa 35.9% u përgjigjën se nuk ishin në dijeni.

**Figura 14: Ndërgjegjësimi publik për ligjin për të drejtën e informimit në 2020**



Baza: N = 2237

Nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, nivelit arsimor, sektorit të punësimit, vendbanimit apo nëse i anketuari është meaftësi të kufizuara. Femrat (64%) dhe meshkujt (65%) e anketuar ishin njësoj të prirur të thonin se e dinin që e drejta për informim garantohet me ligj.

Të anketuarit në grupmoshën mbi 66 vjeç (70%), studentët (69%), pensionistët (70%), të anketuarit me nivel të ardhurash 50 001 lekë deri 70 000 lekë (70%), apo të anketuarit që i përkasin një grupi pakice (70%) ishin më të predispozuar për të thënë se ishin të ndërgjegjësuar për të drejtën e tyre për informim, ndërsa të anketuarit në grupmoshën 36-45 vjeç ishin më pak të prirur (59%) të thonin se janë të ndërgjegjësuar për ligjin për të drejtën e informimit. Të anketuarit që jetojnë në bashki të vogla (56%) apo të mesme (59%) ishin më pak të prirur të deklaronin se kishin dijeni për ligjin e të drejtës për informim në krahasim me të intervistuarit që jetojnë në bashkitë e mëdha (68%).

Krahasuar me vitin e kaluar, ka rënë përqindja e të anketuarve që janë në dijeni për ligjin, duke qenë se 66.7% e të anketuarve të Sondazhit të Opinionit Publik të 2019 ishin në dijeni se e drejta për informim në Shqipëri garantohet me ligj. Në 2018 dhe 2017, 60% e të anketuarve ishin në dijeni se e drejta për informim garantohet me ligj, ndërkohë që në 2016 kjo përqindje ishte 57%.

## Llogaridhënia

*Shumica e të anketuarve nuk i konsideronin strukturat e qeverisë qendrore dhe vendore si të përgjegjshme (që japin llogari). Vetëm 36.6% e shqiptarëve e konsideronin bashkinë e tyre si të përgjegjshme dhe 34.5% thanë se e konsiderojnë qeverinë qendrore si të përgjegjshme. Të anketuarit me nivel të ardhurash mbi 70 001 lekë ishin më pak të prirur t'i konsideronin qeverinë qendrore dhe bashkitë si të përgjegjshme (28% dhe 32% përkatësisht).*

Shumica e të anketuarve nuk e konsideronin qeverinë qendrore dhe atë vendore si të përgjegjshme (që japin llogari). 62.4% e të anketuarve të Sondazhit të 2020 thanë se nuk i konsideronin bashkitë si të përgjegjshme (40.3%) apo si aspak të përgjegjshme (22.1%). Po ashtu, 64.3% e të anketuarve mendonin se qeveria qendrore nuk është transparente: 41.3% thanë se nuk ishin dakord me pohimin 'Qeveria qendrore është e përgjegjshme (jep llogari)', ndërsa 23% nuk ishin aspak dakord.




**Figura 15: Perceptimi i llogaridhënies së qeverisë qendrore dhe vendore në 2020**

Bashkia është e përgjegjshme (jep llogari)



Qeveria qendrore është e përgjegjshme (jep llogari)



Baza: Për qeverinë qendrore (N=2495); Për bashkinë (N=2489).


Kur analizojmë diferencat mes grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, nivelit arsimor, statusit të punësimit, vendbanimit, apo nëse i anketuari është me aftësi të kufizuara. 35% e të anketuarve femra e konsideronin qeverinë qendrore si të përgjegjshme, krahasuar me 34% të të anketuarve meshkuj. Të anketuarit me nivel të ardhurash mujore mbi 70 001 lekë ishin më pak të prirur të deklaronin se mendojnë se qeveria qendrore (32%) apo bashkia (28%) është e përgjegjshme (jep llogari). Të intervistuarit që thanë se i përkasin një pakice janë më pak të prirur të thonë se bashkia e tyre (32%) dhe qeveria qendrore (32%) janë të përgjegjshme. Për më tepër, të anketuarit që banojnë në bashki të vogla (40%) ishin më të predispozuar të thonin se e konsiderojnë bashkinë e tyre si të përgjegjshme në krahasim me të anketuarit që banojnë në bashkitë e mesme (37%) apo në ato të mëdha (36%). Për një ndarje më të plotë demografike, shihni Tabelën 10 në fund të këtij kapitulli.

### Perceptimi i llogaridhënies së qeverisë qendrore dhe asaj vendore 2016–2020

*Krahasuar me vitin 2019, përqindja e shqiptarëve që mendojnë se qeveria vendore është e përgjegjshme është rritur me 6 p.p. në 37% dhe për qeverinë qendrore me 4 p.p. në 35%. Megjithatë, kur analizojmë vlerësimin e pesë viteve të fundit, vëmë re një rënie krahasuar me vitin 2016.*

Krahasuar me rezultatet e sondazhit të vitit 2019, përqindja e të anketuarve që mendojnë se qeveria qendrore dhe ajo vendore janë të përgjegjshme është rritur. Për pushtetin vendor, përqindja e të intervistuarve që e konsiderojnë bashkinë si të përgjegjshme u rrit me 6 p.p. në 37%. Po ashtu, përqindja e të anketuarve që e konsideron qeverinë qendrore si të përgjegjshme është rritur me 4 p.p. në 35%. Kur e hedhim vështrimin te perceptimet për përgjegjshmërinë që nga viti 2016, vihet re një rënie elehtë. Në vitin 2016, 43% e të anketuarve e konsideronin pushtetin vendor si të përgjegjshëm, 6 p.p. më shumë se në vitin 2020. Perceptimi për llogaridhënien e qeverisë qendrore ra me 1 p.p. në të njëjtën periudhë, nga 36% në 2016, në 35% në 2020.

**Figura 16: Ndryshimi për perceptimin e llogaridhënies 2016–2020**



Baza: Qeveria qendrore: 2016 (N=1646); 2017 (N=1635); 2018 (N=1644); 2019 (N=2491); 2020 (N=2495), dhe Qeveria vendore: 2016 (N=1645); 2017 (N=1633); 2018 (N=1643); 2019 (N=2485); 2020 (N=2489).

\*Shënim: Që nga viti 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.


## Llogaridhënia horizontale dhe vertikale

*Shqiptarët e anketuar priren të besojnë se mekanizmi më efikas i llogaridhënies është Kontrolli i Lartë i Shtetit (60.7%), i ndjekur nga media (52.8%), Parlamenti (48.1%), shoqëria civile (44.8) dhe Avokati i Popullit (44.3%). 40.7% besojnë se deputetë të caktuar mund t'i kërkojnë llogari qeverisë. Në përgjithësi, shqiptarët besojnë se organizatat ndërkombëtare i kërkojnë llogari qeverisë shumë më tepër se organizatat vendase të renditura më sipër.*

Llogaridhënia mund të klasifikohet sipas llojit të kërkesës së llogarisë që bëhet dhe/ose personit, grupit apo institucionit para të cilit përgjigjet zyrtari publik dhe këto mund të grupohen më tej në dy forma kryesore: llogaridhënia horizontale dhe llogaridhënia vertikale. Llogaridhënia horizontale ka të bëjë me kapacitet e institucioneve shtetërore (si parlamenti dhe gjyqësori) për të mbikëqyrur politikat e qeverisë duke i kërkuar asaj informacione, duke kontrolluar zyrtarët dhe duke ndëshkuar shkeljet apo sjelljet e gabuara. Nga ana tjetër, llogaridhënia vertikale ka të bëjë me instrumentet me të cilat qytetarët, masmedia, dhe shoqëria civile kërkojnë zbatimin e standardeve të performancës së mirë nga zyrtarët e qeverisë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) vazhdon të perceptohet si institucioni me rolin më të madh në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë (60.7%), pasuar nga Parlamenti (48.1%), Avokati i Popullit (44.3%), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave (41.7%), Komisioneri për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit (40.7%) dhe deputetë të veçantë (40.7%). Vetëm 38% e të anketuarve vlerësojnë se partitë e opozitës mund t'i kërkojnë llogari qeverisë.

Figura 17: Perceptimi për efektivitetin e mekanizmave të llogaridhënies horizontale 2020



Baza: Parlamenti (N=2497); Deputetë të caktuar (N=2492); KLSH (N=2495); partitë e opozitës (N=2492); Avokati i Popullit (N=2488); Komisioneri për të Drejtën e Informimit (N=2487); Komisioneri për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit (N=2489).


Kur analizojmë perceptimin e llogaridhënies horizontale sipas karakteristikave demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, nivelit arsimor, apo sektorit të punësimit. Të anketuarat femra ishin më pak të prirura për të thënë se Parlamenti (47%) dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit (41%) i kërkojnë llogari qeverisë. Të anketuarit në grupmoshën mbi 66 vjeç (54%) dhe të anketuarit që banojnë në zonat rurale (55%) ishin më të predispozuar për të menduar se qeverisë i kërkohet llogari nga Parlamenti, ndërsa studentët (43%) dhe të anketuarit me nivel të ardhurash mbi 70 001 (39%) ishin më pak të mendimit se Parlamenti i kërkon llogari qeverisë për veprimet/mosveprimet e saj.

Studentët (46%) apo të anketuarit në grupmoshën 56 – 65 vjeç (46%) ishin më të predispozuar për të thënë se deputetë të caktuar mund t'i kërkojnë llogari qeverisë, ndërsa të anketuarit në grupmoshën 36-45 ishin më pak të prirur (34%) për pasur një perceptim të tillë. Të anketuarit në grupmoshën mbi 66 vjeç (67%) dhe pensionistët (67%) ishin më të predispozuar për të deklaruar se KLSH mund t'i kërkojë llogari qeverisë, ndërkohë që studentët ishin më pak të prirur për të menduar kështu (55%).

Për më tepër, të anketuarit me nivel të ardhurash mbi 70 001 lekë janë më pak të prirur të mendojnë se Avokati i Popullit (39%) i kërkon llogari qeverisë. Të anketuarit në grupmoshën 46-55 vjeç ishin më të shumtë në përqindje që mendonin se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (46%) i kërkon llogari qeverisë për veprimet/mosveprimet e saj. Të intervistuarit që thanë se kishin aftësi të kufizuara ishin më të predispozuar të mendonin se Parlamenti (52%), deputetë të caktuar (48%), dhe partitë e opozitës (43%) i kërkonin llogari qeverisë, ndërsa të anketuarit me aftësi të kufizuara janë më pak të prirur për të menduar se është Avokati i Popullit institucioni që i kërkon llogari qeverisë (40%). Të anketuarit që i përkasin një grupi pakice u shprehën më shumë se deputetë të caktuar (46%), partitë e opozitës (48%), dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit (52%) i kërkojnë llogari qeverisë. Për të gjitha konstatimet sipas ndarjeve demografike, shihni Tabelën 11 në fund të këtij kapitulli.

Sa i përket mekanizmave të llogaridhënies vertikale, media u perceptua se kishte rolin më të madh në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë (52.8%), e ndjekur nga shoqëria civile (44.8%), biznesi/shoqatat e biznesit (41.2%) dhe sindikatat (38.9%). Rreth 3/4 e qytetarëve shqiptarë (74.5%) besojnë se organizatat ndërkombëtare i kërkojnë llogari qeverisë.

Figura 18: Perceptimi për efektivitetin e mekanizmave të llogaridhënies vertikale 2020



Baza: OSHC (N=2491); Media (N=2491); Biznesi/shoqatat e biznesit (N=2492); Sindikatat (N=2491); Organizatat ndërkombëtare (N=2494).

Kur bëjmë krahasime sipas karakteristikave demografike, nuk u regjistruan dallime të konsiderueshme sipas gjinisë, moshës, nivelit arsimor, apo sektorit të punësimit. Të anketuarat femra u shprehën më pak se OSHC (44%) dhe sindikatat (38%) i kërkojnë llogari qeverisë. Të anketuarit me nivel të ardhurash mbi 70 001 lekë ishin më pak të prirur të besonin se shoqëria civile (38%) apo organizatat ndërkombëtare e detyrojnë qeverinë të japë llogari (70%). Studentët ishin më pak të prirur të besonin se media (48%) i kërkon llogari qeverisë. Të anketuarit që banojnë në zonat rurale ishin më të predispozuar të mendonin se bizneset/shoqatat e biznesit (47%) apo sindikatat (44%) e bëjnë të japë llogari. Të intervistuarit që kanë aftësi të kufizuar janë më të prirur të mendojnë se media (60%) i kërkon llogari qeverisë. Po ashtu, të anketuarit që i përkasin një grupi pakice ishin më të predispozuar të thonin se media (60%) dhe organizatat ndërkombëtare (79%) i kërkojnë llogari qeverisë. Për ndarjen e plotë demografike të përgjigjeve shihni Tabelën 11 në fund të këtij kapitulli.

Krahasuar me vitin 2019, kemi një përqindje më të ulët të të anketuarve që mendojnë se ka mekanizma që bëjnë që qeveria të japë llogari. Për 8 nga 12 institucionet e përfshira në pyetjen “cila prej tyre e bën qeverinë më të përgjegjshme (të japë llogari) për veprimet/mosveprimet e saj”, përqindja e të anketuarve që thanë “Po” ka rënë. Në mënyrë të veçantë, Parlamenti (-6 p.p.), media (-5 p.p.), organizatat ndërkombëtare (-4 p.p.), dhe partitë e opozitës (-4 p.p.) u konsideruan nga një përqindje më e vogël të anketuarish me rol në llogaridhënien e qeverisë. Nga ana tjetër, Komisioneri për të Drejtën e Informimit

(+3 p.p.) dhe bizneset/shoqatat e biznesit (+2 p.p.) mendohet se kanë më shumë rol në llogaridhënien e qeverisë.

Kur shqyrtojmë tendencat në vite, Kontrollit i Lartë i Shtetit dhe media konsiderohen si dy institucionet më të efektshme në vend për t'i kërkuar llogari qeverisë. Duke qenë se organizatat ndërkombëtare u përfshinë në pyetësor në vitin 2019, këto llogariten si më shpesh të vlerësuara si institucione që kanë një rol në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë. Me kalimin e viteve, partitë e opozitës, Avokati i Popullit dhe media shihen si gjithnjë e më pak efektive në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë. Që nga viti 2016, përqindja e të anketuarve që përgjigjen “po” është ulur me 13 p.p., 10 p.p. dhe 9 p.p. përkatësisht.

**Tabela 9: Perceptimi i efektivitetit të mekanizmave të llogaridhënies 2016–2020**

	2016	2017	2018	2019	2020
Parlamenti	51%	63%	54%	54%	48%
Deputetë të veçantë	X	X	X	44%	41%
Kontrolli i Lartë i Shtetit	63%	67%	61%	64%	61%
Partitë opozitare	51%	54%	43%	42%	38%
Avokati i Popullit	54%	55%	59%	44%	44%
Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	X	X	X	39%	42%
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	46%	45%	44%	41%	41%
Organizatat e shoqërisë civile	46%	51%	49%	48%	45%
Media	62%	65%	58%	58%	53%
Bizneset/shoqatat e biznesit	43%	44%	40%	39%	41%
Sindikatat	39%	46%	42%	41%	39%
Organizatat Ndërkombëtare	X	X	X	79%	75%

\*Shënim: Që nga viti 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

Tabela 10: Ndarja demografike për transparencën dhe llogaridhënien

	Qeveria qendrore është transparente	Bashkia ime është transparente	Qeveria qendrore është e përgjegjshme	Bashkia ime është e përgjegjshme	
<b>Gjithsej</b>	<b>35%</b>	<b>37%</b>	<b>35%</b>	<b>37%</b>	
<b>Gjinia</b>					
Meshkuj	35%	36%	34%	36%	
Femra	35%	37%	35%	37%	
<b>Mosha</b>					
18 - 25 vjeç	32%	36%	32%	37%	
26 - 35 vjeç	35%	37%	35%	36%	
36 - 45 vjeç	32%	32%	33%	34%	
46 - 55 vjeç	39%	40%	39%	40%	
56 - 65 vjeç	35%	38%	35%	39%	
mbi 66 vjeç	36%	39%	34%	34%	
<b>Niveli arsimor</b>					
Arsim deri 9-vjeçar*	34%	36%	34%	36%	
Me arsim të mesëm	33%	35%	34%	35%	
Me arsim universitar	37%	39%	35%	38%	
<b>Statusi i punësimit</b>					
I/E punësuar	Gjithsej	34%	36%	34%	36%
	Spektori publik	37%	38%	37%	40%
	Spektori privat	34%	36%	34%	35%
I/E papunë	35%	37%	35%	38%	
Student	31%	37%	32%	38%	
Pensionist	35%	38%	34%	34%	
<b>Niveli i të ardhurave</b>					
Pa të ardhura	34%	37%	35%	38%	
Deri në 24,000 lekë	34%	36%	33%	34%	
24,001 – 50,000 lekë	34%	37%	34%	37%	
50,001 – 70,000 lekë	40%	39%	38%	38%	
Mbi 70,001 lekë	28%	32%	28%	32%	
<b>Vendbanimi</b>					
Urban	34%	36%	34%	36%	
Rural	36%	39%	36%	39%	

\* Grupi “Arsim deri 9-vjeçar” përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë diferencat prej >5 p.p. me totalin e përgjigjeve.

Tabela 11: Ndarja social-demografike e llogaridhënies horizontale dhe vertikale

	Parlamenti	Deputetë të caktuar	KLSH	Partitë e opozitës	Avokati i Popullit	Komisioneri për të Drejtën e Informimit	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	Organizatave shoqërisë civile	Media	Bizneset / Shoqatat e biznesit	Sindikatat	Organizatave ndërkombëtare
<b>Gjithsej (% për llogaridhënien)</b>	<b>48%</b>	<b>41%</b>	<b>61%</b>	<b>38%</b>	<b>44%</b>	<b>42%</b>	<b>41%</b>	<b>45%</b>	<b>53%</b>	<b>41%</b>	<b>39%</b>	<b>75%</b>
	<b>Gjinia</b>											
Meshkuj	49%	41%	61%	38%	44%	43%	41%	46%	53%	41%	40%	75%
Femra	47%	40%	61%	38%	44%	41%	40%	44%	52%	41%	38%	74%
	<b>Mosha</b>											
18 - 25 vjeç	46%	42%	58%	37%	44%	41%	39%	45%	52%	40%	40%	74%
26 - 35 vjeç	47%	41%	59%	38%	45%	43%	40%	44%	51%	43%	38%	74%
36 - 45 vjeç	45%	34%	59%	36%	41%	38%	37%	44%	53%	40%	40%	76%
46 - 55 vjeç	51%	44%	64%	41%	48%	44%	46%	43%	56%	41%	37%	74%
56 - 65 vjeç	51%	46%	61%	39%	45%	44%	43%	47%	53%	43%	39%	75%
mbi 66 vjeç	54%	39%	67%	40%	44%	40%	42%	49%	55%	42%	43%	72%
	<b>Niveli arsimor</b>											
Arsim deri 9-vjeçar*	47%	42%	60%	39%	41%	41%	41%	46%	52%	42%	39%	76%
Me arsim të mesëm	48%	40%	62%	38%	45%	41%	41%	45%	53%	38%	39%	74%
Me arsim universitar	49%	40%	60%	37%	44%	43%	40%	44%	53%	43%	39%	75%



	Parlamenti	Deputetë të caktuar	KLSH	Partitë e opozitës	Avokati i Popullit	Komisioneri për të Drejtën e Informimit	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	Organizatave shoqërisë civile	Media	Shoqatat e biznesit / Bizneset	Sindikatat	Organizatave ndërkombëtare
<b>Gjithsej (% për llogaridhënien)</b>	<b>48%</b>	<b>41%</b>	<b>61%</b>	<b>38%</b>	<b>44%</b>	<b>42%</b>	<b>41%</b>	<b>45%</b>	<b>53%</b>	<b>41%</b>	<b>39%</b>	<b>75%</b>
<b>Statusi i punësimit</b>												
I/E	48%	39%	60%	37%	45%	41%	41%	45%	53%	42%	39%	75%
punësuar	53%	40%	60%	36%	44%	42%	44%	43%	56%	41%	39%	74%
Sektori privat	46%	39%	61%	37%	44%	41%	40%	46%	52%	42%	38%	75%
I/E papunë	46%	43%	59%	38%	42%	41%	37%	43%	53%	41%	37%	74%
Student	43%	46%	55%	40%	47%	46%	42%	45%	48%	39%	43%	75%
Pensionist	54%	40%	67%	41%	43%	42%	43%	48%	55%	41%	41%	75%
<b>Niveli i të ardhurave</b>												
Pa të ardhura	46%	44%	59%	40%	43%	43%	39%	44%	53%	40%	39%	75%
Deri në 24,000 lekë	48%	40%	63%	38%	45%	40%	40%	43%	52%	42%	40%	74%
24,001 – 50,000 lekë	49%	39%	61%	38%	42%	42%	41%	47%	56%	42%	38%	75%
50,001 – 70,000 lekë	48%	40%	63%	34%	47%	41%	45%	43%	52%	44%	41%	75%
Mbi 70,001 lekë	39%	41%	46%	37%	39%	39%	36%	38%	49%	41%	34%	70%
<b>Vendbanimi</b>												
Urban	45%	40%	60%	37%	44%	42%	41%	44%	52%	39%	37%	75%
Rural	55%	43%	63%	41%	45%	41%	40%	48%	55%	47%	44%	73%

\* Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).  
Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë diferencat prej >5 p.p. me totalin e përgjigjeve.

### 4.3 Korrupsioni në institucionet publike

Korrupsioni – abuzimi i postit publik për përfitime private – klasifikohet në korrupsion i nivelit të ulët (korrupsioni i nivelit të ulët) dhe korrupsion i nivelit të lartë (korrupsioni i nivelit të lartë). Korrupsioni i nivelit të ulët i referohet abuzimit të pushtetit që i është besuar një zyrtari publik në marrëdhëniet me qytetarët; ndërkohë që korrupsioni i nivelit të lartë është abuzimi i pushtetit të nivelit të lartë që u sjell fitime një grupi të vogël njerëzish në kurriz të shumicës dhe u shkakton dëm serioz dhe të gjithanshëm individëve dhe shoqërisë.<sup>17</sup> Për disa vite me radhë, në sondazh bëhen pyetje për përhapjen e korrupsionit, nivelin e besimit në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit si dhe institucionin më të korruptuar. Të anketuarit pyeten për përvojat e tyre personale me fenomenin si në nivel vendor ashtu dhe atë qendror të qeverisjes, përfshirë këtu edhe pyetje nëse kanë qenë dëshmitarë të ndonjë rasti korrupsioni apo i kanë paguar ryshfet një zyrtari të qeverisë qendrore apo vendore dhe arsyet pse kanë paguar ryshfetin dhe nuk e kanë raportuar kërkesën për ryshfet tek autoritetet zyrtare.

#### Perceptimet për përhapjen e korrupsionit

*Ashtu si në vitin 2019, shumica e shqiptarëve mendojnë se korrupsioni i nivelit të lartë dhe ai i nivelit të ulët është ‘i përhapur’ dhe ‘shumë i përhapur’. 86.7% raportuan se korrupsioni i nivelit të ulët është (shumë) i përhapur dhe 84.1% thanë se korrupsioni i nivelit të lartë është (shumë) i përhapur. Institucionet gjyqësore u renditën si më të korruptuara në 2020, ndjekur nga institucionet e kujdesit shëndetësor, organet e zbatimit të ligjit, dhe Parlamenti.*

Të anketuarit u pyetën për të vlerësuar përhapjen e korrupsionit të nivelit të lartë dhe atij të nivelit të ulët në një shkallë me katër pikë nga 1 (aspak i përhapur) në 4 (shumë i përhapur). U bënë krahasime mes korrupsionit të nivelit të ulët (abuzimit të pushtetit që i është besuar një zyrtari publik në marrëdhëniet me qytetarët) dhe korrupsionit të nivelit të lartë (abuzimit të pushtetit të nivelit të lartë që u sjell fitime një grupi të vogël njerëzish në kurriz të shumicës dhe u shkakton dëm serioz dhe të gjithanshëm individëve dhe shoqërisë).


Shumica dërmuese e të anketuarve (86.7%) raportuan se korrupsioni i nivelit të ulët është i përhapur (52.5%) ose shumë i përhapur (34.2%). Ndërkohë, 2.8% raportuan se korrupsioni i nivelit të ulët nuk është aspak i përhapur dhe 8.7% raportuan se korrupsioni i nivelit të



17 Për një përkufizim të saktë të korrupsionit të nivelit të lartë dhe korrupsionit të nivelit të ulët shihni Fjalori i Korrupsionit i Transparency International: <https://www.transparency.org/en/corruptionary>

ulët nuk është i përhapur. Lidhur me korrupsionin e nivelit të lartë, 84.1% raportuan se korrupsioni i nivelit të lartë është ose i përhapur (41.8%) ose shumë i përhapur (42.3%). 2.3% raportuan se korrupsioni i nivelit të lartë nuk është aspak i përhapur dhe 11.4% raportuan se korrupsioni i nivelit të lartë nuk është i përhapur.

**Figura 19: Perceptimi i përhapjes së korrupsionit 2020**



Baza: Korrupsioni i nivelit të ulët (N = 2499); korrupsioni i nivelit të lartë (N = 2499).

Për sondazhin e vitit 2020, krahasimi sipas gjinisë, moshës, nivelit arsimor, vendbanimit, ose përkitjes së një grupi pakice nuk nxori në pah dallime të mëdha për sa i përket përhapjes së korrupsionit. Për të anketuarit femra e meshkuj, përqindja që thanë se korrupsioni i nivelit të lartë është i përhapur ose shumë i përhapur është 84%. Përqindja që thanë se korrupsioni i nivelit të ulët është i përhapur ose shumë i përhapur është 86% (femra) dhe 87% (meshkuj). 89% e punonjësve të sektorit publik dhe 87% e punonjësve të sektorit privat raportuan se korrupsioni i nivelit të ulët është i përhapur ose shumë i përhapur në vend.

Krahasuar me studimin e vitit 2019, një përqindje më e madhe e atyre të punësuar në sektorin publik raportuan se korrupsioni i nivelit të ulët është i përhapur ose shumë i përhapur (88.5% me 77.7%). U vu re i njëjti model për korrupsionin e nivelit të lartë. 84.8% e punonjësve të sektorit publik (përkundër 78.2% në 2019) raportuan se korrupsioni i nivelit të lartë është i përhapur apo shumë i përhapur. Të anketuarit që thanë se kanë një aftësi të kufizuar ishin më pak të prirur të mendonin se korrupsioni i nivelit të ulët është i përhapur ose shumë i përhapur.

Ashtu si në sondazhin e vitit 2019, shumica e shqiptarëve mendojnë se korrupsioni është i përhapur ose shumë i përhapur. Me kalimin e kohës, përqindja e të anketuarve

që raportojnë se korrupsioni i nivelit të ulët është ‘i përhapur’ ose ‘shumë i përhapur’ nuk ka ndryshuar. Konkretisht, 87% e të anketuarve në sondazhin e opinionit të viteve 2017, 2018, 2019 dhe 2020 raportuan se korrupsioni i nivelit të ulët është i përhapur ose shumë i përhapur, ndonëse krahasuar me vitin 2019 përqindja e të anketuarve në 2020 që perceptojnë korrupsionin e nivelit të ulët si shumë të përhapur ra paksa (me -3 p.p.). Ndonëse pakonsiderueshme, rënia vihet re edhe me përqindjen e të anketuarve që raportojnë se korrupsioni i nivelit të lartë është ‘i përhapur’ ose ‘shumë i përhapur’: në 2017 kjo përqindje ishte 88%, ndërsa në 2020 ra në 84%. Në Tabelën 12 jepet perceptimi për përhapjen e korrupsionit nga 2017 në 2020.

**Tabela 12: Perceptimi i përhapjes së korrupsionit 2017–2020**

		2017	2018	2019	2020
<b>Korrupsioni i nivelit të ulët</b>	I përhapur	54%	53%	50%	53%
	Shumë i përhapur	33%	34%	37%	34%
<b>Korrupsioni i nivelit të lartë</b>	I përhapur	48%	48%	43%	42%
	Shumë i përhapur	40%	41%	43%	42%

Baza: Korrupsioni i nivelit të ulët, 2017 (N=1641); 2018 (N=1644); 2019 (N=2494); 2020 (N=2499); Korrupsioni i nivelit të lartë, 2017 (N=1641); 2018 (N=1644); 2019 (N=2495); 2020 (N=2499).

\*Shënim: Që nga viti 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

Të anketuarve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre se “cili ishte institucioni më i korruptuar në vitin 2020?” Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve (602 nga 2407) treguan se institucionet e sistemit të drejtësisë ishin më të korruptuarat në vitin 2020, pasuar nga institucionet e sistemit shëndetësor (398 nga 2407) dhe institucionet e zbatimit të ligjit (167 nga 2407). Në Tabelën 13 jepen numri dhe përqindja e përgjigjeve sipas institucionit.

Tabela 13: Institucioni më i korruptuar në 2020

	Numri	Përqindja
Institucionet e sistemit gjyqësor	602	25.0%
Institucionet e kujdesit shëndetësor	398	16.5%
Institucionet e zbatimit të ligjit (policia)	167	6.9%
Parlamenti	148	6.1%
Institucionet e qeverisjes vendore	128	5.3%
Institucionet e arsimit	107	4.4%
Presidenti	76	3.2%
Partitë politike	71	2.9%
Tjetër*	281	11.7%
Gjithsej	2407	100.0%

\*Institucionet e tjera janë kryeministria, media, ALUIZNI, organizatat e shoqërisë civile, dhe “të gjitha institucionet publike janë të korruptuara” ose “të gjitha njësoj janë”.


### Besimi në ndjekjen penale të rasteve të korrupsioni

*Përqindja e shqiptarëve që nuk kanë besim në ndjekjen penale të korrupsionit të nivelit të ulët është rritur: nga 61.1% në 2019 në 64.5% në 2020. Ndonëse për qindja e popullsisë që nuk ka besim në ndëshkimin e korrupsionit të nivelit të lartë nuk ka ndryshuar shumë, kjo përqindje vazhdon të mbetet e lartë. 7 në 10 shqiptarë nuk kanë besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë.*



Të anketuarve iu kërkua të vlerësonin nivelin e besimit në ndjekjen penale të çështjeve të korrupsionit duke përdorur një shkallë prej 4 pikësh - nga 1 (kam shumë besim) në 4 (nuk kam aspak besim). Pati dallime mes korrupsionit të nivelit të ulët dhe korrupsionit të nivelit të lartë. 64.5% e pjesëmarrësve në studim raportuan se ‘nuk kanë besim’ ose ‘nuk kanë aspak besim’ në ndjekjen penale të korrupsionit të nivelit të ulët. Më konkretisht, 35.9% raportuan se ‘nuk kanë besim’ dhe 28.6% raportuan se ‘nuk kanë aspak besim’. 5.7% raportuan se kishin shumë besim dhe 28.6% raportuan se kishin besim në ndjekjen penale të korrupsionit të nivelit të ulët.

**Figura 20: Perceptimi i ndjekjes penale të rasteve të korrupsionit 2020**

Korrupsioni i nivelit të ulët



Korrupsioni i nivelit të lartë




Baza: Korrupsioni i nivelit të lartë (N=2494); korrupsioni i nivelit të ulët (N=2496).

Pati dallime mes grupeve sipas gjinisë, nivelit arsimor, statusit të punësimit, sektorit të punësimit, vendbanimit, apo që i përkasin një grupi pakice. Të anketuarit meshkuj dhe femra janë shpesh të të njëjtit mendim (65%) kur thonë se nuk kanë besim apo aspak besim në ndëshkimin e rasteve të korrupsionit të nivelit të ulët. Për rastet e korrupsionit të nivelit të lartë, 69% e përqindjes së të anketuarve femra kanë (shumë) besim se rastet e korrupsionit do të ndiqen penalisht, ndërsa për të intervistuarit meshkuj kjo përqindje ishte 71. Të anketuarit me nivel më të lartë të ardhurash - 70 001 lekë ose më shumë në muaj - ishin më të predispozuar për të raportuar se ‘nuk kanë besim’ ose ‘nuk kanë aspak besim’ në ndjekjen penale të korrupsionit të nivelit të ulët dhe të nivelit të lartë (për të dy në 25%).

Çdo vit që kur u shtua kjo pyetje në pyetësor, përqindja e të anketuarve që thonë se kanë besim ose shumë besim në ndjekjen penale të korrupsionit të nivelit të ulët ka qenë më e lartë sesa me besimin në ndjekjen penale të korrupsionit të nivelit të lartë. Megjithatë, kjo diferencë po ngushtohet, duke qenë se besimi në ndëshkimin e korrupsionit të nivelit të lartë po rritet teksa besimi në ndëshkimin e korrupsionit të nivelit të ulët po bie. In Në vitin 2017, besimi në ndëshkimin e rasteve të korrupsionit të nivelit të ulët ishte 36%, ndërsa për korrupsionin e nivelit të lartë ishte 25%, një diferencë prej 11 p.p. Në 2020, kjo diferencë është vetëm 5 p.p.: 34% për korrupsionin e nivelit të ulët dhe 29% për korrupsionin e nivelit të lartë.

Figura 21: Besimi në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit 2017-2020



Baza: Korrupsioni i nivelit të lartë: 2017 (N=1639), 2018 (N=1644), 2019 (N=2490), 2020 (N=2494); Korrupsioni i nivelit të ulët: 2017 (N=1639), 2018 (N=1644), 2019 (N=2461), 2020 (N=2496).


\*Shënim: Që nga viti 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

### Përvoja personale me rastet e korrupsionit

*Përvoja personale me korrupsionin vazhdon të mbetet e madhe për të dy nivelet e qeverisjes. 15.3% e shqiptarëve kanë qenë dëshmitarë të rasteve të korrupsionit në qeverinë qendrore dhe 22.7% kanë qenë dëshmitarë të rasteve të korrupsionit në njësitë e qeverisjes vendore.*

15.3% e pjesëmarrësve në këtë studim raportuan se kanë qenë dëshmitarë të rasteve të korrupsionit në qeverinë qendrore; ndërkohë që përqindje e këtyre pjesëmarrësve që kanë qenë dëshmitarë të rasteve të korrupsionit në njësitë e qeverisjes vendore ishte 22.7%.

Figura 22: Përvoja personale me korrupsionin 2020



Baza: qeveria qendrore (N=2483); qeveria vendore (N=2483)


Kur bëjmë krahasime sipas karakteristikave demografike, nuk vihen re dallime të mëdha mes të anketuarve sipas sektorit të punësimit, statusit të punësimit, vendbanimit, përkatësisë në një grup pakice apo aftësisë së kufizuar. 16% e të intervistuarve meshkuj dhe 15% e të anketuarve femra raportuan se kanë qenë dëshmitarë të korrupsionit në nivel qendror. Ndërkohë që 24% e të intervistuarve meshkuj dhe 22% e të anketuarve femra raportuan se kanë qenë dëshmitarë korrupsioni në nivel vendor.

Të anketuarit në grupmoshën 'mbi 56 vjeç' ishin më të predispozuar të raportnin se kanë qenë dëshmitarë të korrupsionit në nivel qendror (56-65: 18%, mbi 66 vjeç: 18%). E njëjta tendencë u vu re edhe për korrupsionin në nivel vendor. 26% e të anketuarve në grupmoshën '56-65 vjeç' dhe 29% e të intervistuarve 'mbi 66 vjeç' raportuan se kanë qenë dëshmitarë të korrupsionit në nivel vendor. Për sa i përket nivelit të të ardhurave, të anketuarit me të ardhura mujore deri në 24 000 lekë ishin më të predispozuar për të deklaruar se kanë qenë dëshmitarë të korrupsionit në nivel qendror (18%) në nivel vendor (24%) të qeverisjes. Edhe të anketuarit me të ardhura mujore mbi 70 001 lekë raportuan se kanë qenë dëshmitarë të korrupsionit në nivel vendor (28%).

Në Figurën 23 jepen ndryshimet në përvojat personale me korrupsionin në të dy nivelet e qeverisjes në vite. Të dhënat japin përqindje të njëjta të të anketuarve që kanë qenë dëshmitarë të korrupsionit në vitet 2019 dhe 2020.



Figura 23: Përvoja personale me korrupsionin në nivel qendror e vendor 2015-2020



Baza: Për qeverinë qendrore: 2015 (N=1585); 2016 (N=1633); 2017 (N=1638); 2018 (N=1631); 2019 (N=2487); 2020 (N=2483). Për qeverinë vendore: 2015 (N=1571); 2016 (N=1633); 2017 (N=1639); 2018 (N=1631); 2019 (N=2487); 2020 (N=2483).

\*Shënim: Që nga viti 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

### Përhapja e ryshfetit


*Ndërkohë që përqindja e shqiptarëve që morën një shërbim nga qeveria qendrore në vitin 2020 u rrit - nga 32% në 2019 në 41% në 2020 - po kështu u rrit edhe përqindja e atyre që raportuan se kishin paguar ryshfet - nga 19% në 2019 në 32% në vitin 2020. Përqindja e shqiptarëve që morën shërbim nga pushteti vendor në vitin 2020 nuk pati ndryshime të konsiderueshme, krahasuar me vitin 2019. Ndërkohë, përqindja e atyre që raportuan se kishin paguar ryshfet u ul - nga 35.8% në 2019 në 32.4% në 2020.*

41.8% e të anketuarve raportuan se kishin marrë një shërbim nga qeveria qendrore. Një përqindje edhe më e madhe raportuan se kishin marrë një shërbim nga qeveria qendrore në 2020 krahasuar me 2019 – 41.8% me 34.8%. 31.5% e atyre që thanë se kishin marrë një shërbim nga qeveria qendrore raportuan se kishin paguar ryshfet.

Kur bëjmë krahasime sipas karakteristikave demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, statusit të punësimit, dhe nëse i anketuari ka aftësi të kufizuar apo jo. 31% e të anketuarve femra që kishin marrë një shërbim nga qeveria qendrore raportuan se kishin paguar ryshfet. Ndërkohë, përqindja e të intervistuarve meshkuj ishte 32. Të anketuarit në grupmoshën ‘mbi 66 vjeç’ (42%), me nivel arsimor deri në të mesëm (36%), dhe që banojnë


në zonat urbane (32%) ishin më të predispozuar për të raportuar se i kishin paguar ryshfet një zyrtari publik në qeverinë qendrore, ndërsa të anketuarit që i përkasin një grupi pakice ishin më pak të prirur (26%) për të deklaruar një gjë të tillë.

**Figura 24: Shërbimet e marra në nivel qendror 2020**



Baza: N = 2500

**Figura 25: Ryshfet i paguar në nivel qendror 2020**




Baza: N = 1046

Një përqindje më e lartë, 63.0%, raportuan se ata kishin marrë një shërbim nga zyrtarët e qeverisë vendore. 32.4% e atyre që morën një shërbim nga qeveria vendore raportuan se kishin paguar ryshfet.


Të anketuarit në grupmoshën ‘mbi 66 vjeç’ (39%) ishin më të predispozuar të deklarorin se kishin paguar ryshfet tek një zyrtar publik i bashkisë, ndërsa të anketuarit që thanë se kishin aftësi të kufizuar ishin më pak të prirur të deklarorin se kishin paguar ryshfet për të marrë një shërbim nga qeveria qendrore në 2020 (25%). Nuk vihen re dallime të mëdha mes grupeve të tjera demografike, si gjinia, niveli arsimor, statusi i punësimit, apo përkatësia te një grup pakice.

**Figura 26: Shërbimet e marra në nivel vendor 2020**



Baza: N = 2500


**Figura 27: Ryshfet i paguar në nivel vendor 2020**



Baza: N = 1575

Në Figurën 28 paraqitet përhapja e ryshfetit në vite. Krahasimi tregon se përhapja e ryshfetit në të dy nivelet e qeverisjes është njësoj, duke i ngjarë kështu situatës së vitit 2017. Krahasuar me vitin 2019, një përqindje më e lartë të anketuarish raportuan se kanë paguar ryshfet për të marrë një shërbim nga qeveria qendrore: 31.5% kundrejt 19.1% , ndërsa përqindja e atyre që raportuan se kanë paguar ryshfet për të marrë një shërbim nga njësia e vetëqeverisjes vendore në vitin 2020 ishte më e ulët se në vitin 2019: 32.4% kundrejt 35.8%. Që nga viti 2016, vit kur kjo pyetje u përfshi për herë të parë, përqindja e të anketuarve që raportuan se kishin dhënë ryshfet për një shërbim që morën nga qeveria qendrore u rrit me 3 p.p. dhe nga qeveria vendore me 6 p.p.

Figura 28: Përhapja e ryshfetit 2016-2020



Baza: Niveli vendor: 2016 (N=838); 2017 (N=916); 2018 (N=924); 2019 (N=1744); 2020 (N=1046). Niveli qendror: 2016 (N=406); 2017 (N=561); 2018 (N=648); 2019 (N=1518); 2020 (N=1575).

\*Shënim: Që nga viti 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

Arsyeja kryesore për dhënien e ryshfetit, sipas të anketuarve, ishte se u ishte kërkuar një gjë e tillë. 46.8% e të anketuarve që treguan se kishin paguar ryshfet raportuan se u ishte kërkuar të paguanin ryshfet, 25.3% raportuan se kishin dhënë ryshfet për të marrë shërbime më të mira në të ardhmen, dhe 16.4% raportuan se kishin paguar ryshfet për të shprehur mirënjohjen e tyre të zyrtari që u kishte shërbyer. Mes atyre që zgjodhën përgjigjen ‘tjetër’, një përgjigje e zakonshme ishte “nëse nuk paguan ryshfet, shërbimi do të ishte i papërshtatshëm” ose “nuk të shërbejnë fare”.

Tabela 14: Arsyet e pagimit të ryshfetit 2020

	Përqindja	Numri
Ma kërkuar ryshfetin	46.8%	285
E dhashë vetë, si mirënjohje për shërbimin e marrë	16.4%	100
E dhashë vetë, që të marr një shërbim më të mirë herës tjetër	25.3%	154
Tjetër*	11.5%	70
Gjithsej	100%	609

\*Tjetër: “Nuk të shërbejnë nëse nuk u jep ryshfet”; “për të marrë shërbim më të shpejtë”.

Vetëm 30 të anketuar ose 4.8% e atyre që kishin dhënë ryshfet thanë se e kishin raportuar një gjë të tillë tek autoritetet përkatëse. Arsyeja kryesore për mosraportimin e ryshfetit ishte se “Është e kotë të raportosh, askush nuk i kushton rëndësi” (40.7%). Përgjigje të tjera të zakonshme ishin se “Të paguash ryshfet është diçka e zakonshme” (27.7%), se “Të paguash ryshfet është një shenjë mirënjohje për shërbimin e marrë” (9.4%). Një përqindje më e vogël, 6.7%, tha se “Nuk dija se ku/kujt duhet t’i drejtohesha”. Rreth 10% e të anketuarve u përgjigjën se kishin frikë nga hakmarrja nëse do të merrnin nismën për të raportuar dhënien e ryshfetit.

## 4.4 Ndikimi politik


Ndikimi politik – që ndikon te vendimet politike për përfitimin e grupeve të interesit – minon pavarësinë e institucioneve publike dhe funksionimin e shoqërisë demokratike dhe dëmton besimin e qytetarëve tek qeveria. Për të pestin vit radhazi, të anketuarve iu kërkua të vlerësonin në një shkallë prej pesë pikësh nga 1 (nuk ndikon aspak) në 5 (ndikon jashtëzakonisht shumë) – sipas mendimit të tyre, sa ndikojnë interesat politike në axhendën e nëntë institucioneve – prokuroria, gjykatat, policia, ushtria, institucionet e shëndetit publik, institucionet arsimore, media, institucionet fetare, dhe organizatat e shoqërisë civile.

### Interesat politike në axhendën e institucioneve

*Ashtu si në vitin 2019, institucionet fetare u perceptuan si institucionet më pak të ndikuara politikisht, ndërkohë që prokuroria dhe gjykatat u konsideruan si institucionet më shumë të ndikuara politikisht.*

Institucionet fetare u perceptuan si më pak të ndikuara nga interesat politike në 2020. 65.9% e pjesëmarrësve në këtë studim raportuan se institucionet fetare nuk ishin aspak të ndikuara (36.0%) ose shumë pak të ndikuara (29.9%) nga interesat politike. Pas institucioneve fetare, institucionet që u perceptuan si më të pavarurat nga interesat politike ishin organizatat e shoqërisë civile (48.6%), ushtria (37.6%), institucionet e sistemit arsimor (28.9%) dhe institucionet e kujdesit shëndetësor (25.6%).

**Figura 29: Perceptimi për ndikimin e interesave politike në axhendën e institucioneve 2020**



Baza: Prokuroria (N=2496); gjykatat (N=2496); police (N=2490); ushtria (N=2488); kujdesi shëndetësor (N=2493); arsimiti (N=2492); media (N=2493); institucionet fetare (N=2489); CSOs (N=2491).

Prokuroria dhe gjykatat u perceptuan si institucionet më të ndikuara politikisht. 57.6% e pjesëmarrësve në sondazh e konsideronin prokurorinë si jashtëzakonisht të ndikuar (20,2%) ose shumë të ndikuar (37.4%) nga interesat politike. Vetëm 3.9% e pjesëmarrësve në studim e konsideronin prokurorinë si aspak të ndikuar nga interesat politike. 55.5% e të anketuarve i konsideronin gjykatat si jashtëzakonisht të ndikuara (20.7%) ose shumë të ndikuara (34.8%) nga interesat politike. Vetëm 3.6% e pjesëmarrësve në studim mendonin se gjykatat nuk janë aspak të ndikuara nga interesat politike.

### Krahasimi demografik për perceptimin e ndikimit politik tek institucionet

*Lidhja mes karakteristikave demografike dhe perceptimi i ndikimit politik tek institucionet ndryshonte sipas llojit të institucionit. Megjithatë, punonjësit e sektorit publik ishin vazhdimisht më pak të prirur për të raportuar se axhenda e institucioneve publike ndikohet nga politika.*

Kur bëjmë krahasime sipas karakteristikave demografike, nuk vihen re dallime të konsiderueshme sipas gjinisë apo vendbanimit. Të anketuarat femra ishin më të predispozuara për të raportuar se policia (46%), ushtria (30%), institucionet e kujdesit shëndetësor (38%) janë shumë ose jashtëzakonisht shumë të ndikuara nga politika, krahasuar me meshkujt (44%, 28%, dhe 36% përkatësisht). Të anketuarit në grupmoshën 26-35 vjeç ishin më të predispozuar të thonë se policia (51%) është shumë e ndikuar apo jashtëzakonisht e ndikuar nga politika, ndërsa të anketuarit në grupmoshën mbi 66 vjeç ishin më pak të prirur të raportojnë se prokuroria (48%), gjykatat (46%), policia (37%) dhe institucionet arsimore (28%) janë shumë të ndikuar apo jashtëzakonisht të ndikuar nga politika.

Të anketuarit që punojnë në sektorin publik ishin më pak të prirur për të raportuar se institucionet e sipërpërmendura janë shumë apo jashtëzakonisht të ndikuara nga politika në krahasim me të anketuarit që punojnë në sektorin privat. Në mënyrë të veçantë për prokurorinë (44%), gjykatat (44%), dhe policinë (34%), të anketuarit që punojnë në sektorin publik ishin shumë më pak të prirur të raportojnë se Axhenda e institucioneve ndikohet nga politika.

Të anketuarit me të ardhura deri në 24 000 lekë ishin më pak të prirur të raportojnë se prokuroria (50%), gjykatat (50%), policia (39%), dhe media janë shumë ose jashtëzakonisht të ndikuara nga politika. Të intervistuarit me të ardhura mujore mbi 70 001 lekë, nga ana tjetër, ishin më të predispozuar të deklaronin se axhenda e institucioneve në fjalë ndikohet shumë ose jashtëzakonisht shumë nga politika. Për të gjitha institucionet, ky grup ishin më shpesh të predispozuar të raportojnë se ato ndikohen nga politika.

Të anketuarit që i përkasin një grupi pakicash ishin më të predispozuar të thonin se institucionet janë shumë ose jashtëzakonisht shumë të ndikuara nga politika. Këtu përfshihen prokuroria (63%), institucionet e sistemit arsimor (40%), dhe organizatat e shoqërisë civile (24%). Të intervistuarit që kanë aftësi të kufizuara ishin më të predispozuar të deklaronin se e konsiderojnë median (33%) si shumë ose jashtëzakonisht shumë të ndikuar nga politika, ndërkohë që një përqindje më e vogël i konsideronin gjykatat (51%) si shumë ose jashtëzakonisht shumë të ndikuara nga politika. Për një krahasim sipas grupeve demografike, shihni edhe Tabelën 16 në fund të këtij kapitulli.

### **Krahasimi vjetor i ndikimit të interesave politike**

*Krahasuar me vitin 2019, një përqindje më e vogël të anketuarish konsideronin gjykatat, median, dhe organizatat e shoqërisë civile si të ndikuara nga interesat politike; ndërkohë që një përqindje më e madhe e shqiptarëve mendonin se sistemi shëndetësor ndikohet nga interesat politike.*

Ndikimi i perceptuar i politikës në axhendën e institucioneve publike ka mbetur kryesisht i njëjtë për të nëntë institucionet e vlerësuara. Krahasuar me vitin 2019, përqindja e të anketuarve që i konsideron gjykatat, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat si



jashtëzakonisht të ndikuara ose shumë të ndikuara nga interesat politike ka rënë me 5 p.p., 4 p.p. dhe 3 p.p. përkatësisht. Ndërkohë, sistemi i kujdesit shëndetësor dhe institucionet fetare shiheshin më shpesh si shumë ose jashtëzakonisht të ndikuara nga politika (+4 p.p. dhe +3 p.p. përkatësisht). Vlerësimet për katër institucionet - prokuroria, policia, forcat e armatosura dhe sistemi arsimor - nuk kanë ndryshuar shumë nga 2019 në 2020: ndryshimi është vetëm me 1 p.p.

**Tabela 15: Institucionet që perceptohen si “shumë të ndikuara” ose “jashtëzakonisht shumë të ndikuara” nga politika 2016–2020**

	2016	2017	2018	2019	2020
<b>Prokuroria</b>	X	67%	60%	59%	58%
<b>Gjykatat</b>	X	70%	63%	61%	56%
<b>Policia</b>	46%	47%	48%	44%	45%
<b>Forcat e armatosura</b>	33%	29%	33%	30%	29%
<b>Sistemi shëndetësor</b>	41%	34%	36%	33%	37%
<b>Sistemi arsimor</b>	38%	29%	34%	33%	34%
<b>Media</b>	45%	37%	39%	45%	42%
<b>Institucionet fetare</b>	9%	9%	12%	10%	12%
<b>Organizatat e shoqërisë civile</b>	20%	26%	24%	23%	19%

Baza: Në rendin sipas listës: 2016 (N= 1633, 1621, 1621, 1626, 1629, 1628, 1630, 1628); 2017 (N= 1615, 1616, 1611, 1608, 1615, 1613, 1612, 1614, 1615); 2018 (N= 1628, 1631, 1624, 1614, 1626, 1633, 1629, 1628, 1632); 2019 (N=2488); 2020, shih Figurën 29.

\*Shënim: Që nga viti 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

Tabela 16: Ndarja demografike e institucioneve të ndikuara shumë ose jashtëzakonisht shumë 2020

	Prokuroria	Gjykatat	Policia	Forcat e armatosura	Sistemi shëndetësor	Sistemi arsimor	Media	Institucion fetare	OSHC
<b>GJITHSEJ (% e 'shumë' ose 'jashtëzakonisht shumë')</b>	<b>58%</b>	<b>56%</b>	<b>45%</b>	<b>29%</b>	<b>37%</b>	<b>34%</b>	<b>42%</b>	<b>12%</b>	<b>19%</b>
	<b>Gjinia</b>								
Meshkuj	58%	55%	44%	28%	36%	33%	41%	12%	19%
Femra	58%	56%	46%	30%	38%	34%	42%	12%	18%
	<b>Mosha</b>								
18-25	60%	56%	47%	31%	37%	35%	38%	10%	18%
26-35	61%	60%	51%	31%	40%	36%	46%	12%	21%
36-45	54%	50%	41%	27%	34%	33%	42%	12%	17%
46-55	59%	57%	46%	28%	38%	32%	42%	12%	18%
56-65	58%	56%	42%	28%	38%	33%	39%	13%	20%
mbi 66 vjeç	48%	46%	37%	25%	32%	28%	38%	10%	21%
	<b>Niveli arsimor</b>								
Arsim deri 9-vjeçar *	55%	51%	43%	26%	37%	33%	41%	14%	19%
Me arsim të mesëm	60%	57%	45%	29%	37%	34%	40%	13%	20%
Me arsim universitar	57%	56%	48%	31%	37%	34%	45%	10%	18%

	Prokuroria	Gjykatat	Policia	Forcat e armatosura	Sistemi shëndetësor	Sistemi arsimor	Media	Institucion fetare	OSHC
<b>GJITHSEJ (% e 'shumë' ose 'jashtëzakonisht shumë')</b>	<b>58%</b>	<b>56%</b>	<b>45%</b>	<b>29%</b>	<b>37%</b>	<b>34%</b>	<b>42%</b>	<b>12%</b>	<b>19%</b>
<b>Statusi i punësimit</b>									
I/E punësuar	Gjithsej	55%	45%	28%	37%	33%	42%	10%	17%
	Sektori publik	44%	34%	24%	30%	28%	40%	8%	16%
	Sektori privat	59%	47%	29%	38%	34%	43%	11%	18%
I/E papunë		65%	50%	32%	42%	39%	44%	16%	23%
Student		62%	58%	33%	34%	35%	36%	12%	17%
Pensionist		49%	47%	38%	33%	28%	38%	12%	21%
<b>Niveli i të ardhurave</b>									
Pa të ardhura		65%	58%	49%	32%	38%	44%	16%	23%
Deri në 24,000 lekë		50%	50%	39%	26%	30%	37%	11%	19%
24,001–50,000 lekë		56%	54%	44%	26%	32%	41%	10%	18%
50,001–70,000 lekë		58%	58%	45%	30%	35%	42%	9%	15%
Mbi 70,001 lekë		62%	63%	58%	43%	50%	57%	18%	27%
<b>Vendbanimi</b>									
Urban		56%	54%	43%	29%	37%	43%	12%	20%
Rural		62%	59%	50%	30%	35%	39%	12%	17%

\* Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).  
Shënimi: Ngjyrat përfaqësojnë diferencat prej >5 p.p. me totalin e përgjigjeve

## 4.5 Pjesëmarrja qytetare


Angazhimi (apo pjesëmarrja) qytetare është themeli i demokracisë. Ashtu si në vitet e kaluara, Sondazhi i Opinioneve të vitit 2020 bën dallimin e angazhimit të qytetarëve në nivel qendror dhe vendor. Për të kuptuar më mirë pjesëmarrjen e qytetarëve, pyetjet u përqendruan në interesin dhe mundësitë për të marrë pjesë në vendimmarrje, për pjesëmarrjen në proceset dhe takimet konsultuese, dhe arsyet për mospjesëmarrje në vendimmarrje. Pyetjet e tjera u bënë për përfshirjen në punë vullnetare, pjesëmarrjen në demonstrata/ tubime dhe për nënshkrimin e peticioneve. Ashtu si në sondazhin e vitit 2019, të anketuarit u pyetën për portalin “www.konsultimipublik.gov.al” – për të marrë informacione apo për të dhënë mendimin e tyre për nisma ligjore apo projekt strategji/ plane veprimi. Në këtë kapitull, të anketuarit u pyetën edhe nëse kanë ndërmend të largohen nga vendbanimi i tyre.

### Pjesëmarrja në vendimmarrje

*Krahasuar me vitin e kaluar, një përqindje më e vogël shqiptarësh ishte e interesuar për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes së institucioneve publike: 49% në 2020 në krahasim me 57% në 2019. Të anketuarit me diplomë universitare (apo pasuniversitare), studentët, punonjësit e sektorit publik, dhe anëtarët e partive politike ishin më të predispozuar për të raportuar se janë të interesuar të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes. Shumica e shqiptarëve mendojnë se nuk kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen e institucioneve publike.*

48.6% e të anketuarve thanë se ishin të interesuar të merrnin pjesë në proceset vendimmarrëse të institucioneve publike, që është një përqindje më e vogël se në 2019 (56.5%).


**Figura 30: Interesi për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse së institucioneve publike 2020**



Baza: N = 2498

Kur bëjmë krahasime sipas karakteristikave demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas vendbanimit apo përkatësisë ndaj një pakice. Pothuajse e njëjta përqindje e femrave (48%) dhe meshkujve (49%) të anketuar thanë se do të donin të merrnin pjesë në procesin e vendimmarrjes së institucioneve publike. Të anketuarit e rinj në moshë (18-35 vjeç) janë më të prirur të raportojnë se janë të interesuar të marrin pjesë në vendimmarrjen e institucioneve publike (55%), krahasuar me të anketuarit në moshë të madhe. Të intervistuarit me diplomë universitare apo pasuniversitare shprehën interes më të madh: 60% e tyre, 47% e të anketuarve me arsim të mesëm, dhe 35% e të anketuarve me arsim deri 8/9 vjeçar deklaruan se janë të interesuar për të marrë pjesë në vendimmarrjen e institucioneve publike. Studentët (62%) dhe të punësuarit në sektorin publik (66%) ishin më të predispozuar për të raportuar interesin e tyre për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes së institucioneve publike, ndërsa të anketuarit që deklaruan se kanë aftësi të kufizuar ishin më pak të prirur (42%) të shprehnin interesin për pjesëmarrje në vendimmarrjen e institucioneve publike. Shihni Tabelën 18 në fund të këtij kapitulli për më shumë informacione.

71.8% e të anketuarve raportuan se nuk kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes në qeverinë qendrore - një përqindje e ngjashme me vitin 2019 (70.6%). Ndërkohë, një përqindje më e vogël, 61.2%, raportuan se nuk kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes në qeverinë vendore. Në studimin e vitit 2019, 58.6% e të anketuarve raportuan se nuk kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes në nivelin vendor.

**Figura 31: Mundësitë për të marrë pjesë në vendimmarrjen e institucioneve publike 2020**


Baza: Për qeverinë qendrore (N=2482); për qeverinë vendore (N=2491).

Njësoj si me studimin e vitit 2019, një përqindje më e madhe e të intervistuarve meshkuj (30%) në krahasim me të anketuarat femra (26%) raportuan se ata kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen në qeverinë qendrore. E njëjta tendencë u evidentua edhe në nivelin vendor: 37% e të anketuarve femra dhe 41% e të intervistuarve meshkuj raportuan se kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen e qeverisë vendore. Dallime u konstatuan edhe mes grupmoshave, ku të anketuarit në grupmoshat '56 deri 65 vjeç' dhe 'mbi 66 vjeç' kanë më pak gjasa të raportojnë se kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje si në nivel qendror (19% dhe 16% përkatësisht) dhe nivelin vendor (28% dhe 22% përkatësisht).

Të anketuarit me arsim universitar apo më shumë ishin më të predispozuar për të deklaruar se kishin mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje në qeverinë qendrore (40%) dhe atë vendore (51%). Punonjësit e sektorit publik, krahasuar me ata të sektorit privat, ishin më të predispozuar për të raportuar se kishin mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje në qeverinë qendrore (44%) dhe atë vendore (57%). Të anketuarit që i përkasin një grupi pakice (34%) apo që raportuan aftësi të kufizuar (34%) ishin më pak të prirur për të menduar se kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes në nivel vendor. Shihni Tabelën 18 në fund të këtij kapitulli për më shumë informacione.

Në Figurën 32 tregohen ndryshimet në përqindjen e të anketuarve që raportuan se kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje me kalimin e kohës. Ndonëse përqindja e të anketuarve që deklarojnë se kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen në nivelin qendror dhe vendor është rritur me kalimin e viteve, ka pasur një rënie të vogël por të dukshme krahasuar me vitin e kaluar (1 p.p. dhe 2 p.p. përkatësisht). Në vazhdimësi, një përqindje më e lartë e të anketuarve kanë raportuar se kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen në qeverinë vendore, krahasuar me qeverinë qendrore.

Figura 32: Mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje 2016–2020



Baza: qeveria qendrore 2016 (N=1633); 2017 (N=1634); 2018 (N=1630); 2019 (N=2480); 2020 (N = 2482); qeveria vendore 2016 (N=1634); 2017 (N=1630); 2018 (N=1638); 2019 (N=2463); 2020 (N = 2491).


\*Shënim: Që nga viti 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

### Proceset e konsultimit

*10.9% e shqiptarëve ishin ftuar të merrnin pjesë në proceset e konsultimit të organizuar nga institucionet publike në nivel qendror, ndërsa 20.3% ishin ftuar të merrnin pjesë në proceset e konsultimit në nivel vendor. 12.9% e pjesëmarrësve në studim raportuan se kanë përdorur portalin online “[www.konsultimipublik.gov.al](http://www.konsultimipublik.gov.al)” për të marrë informacione apo për të dhënë opinionin për nisma ligjore apo projekt strategjitë/planet e veprimit– përqindje më e lartë se në sondazhin publik të vitit 2019 (8%).*

10.9% e shqiptarëve ishin ftuar të merrnin pjesë në proceset e konsultimit të organizuar nga institucionet publike në nivel qendror. Një përqindje më e lartë, 20.3%, raportuan se ishin ftuar të merrnin pjesë në proceset e konsultimit të organizuara institucionet publike të nivelit vendor. Përqindja e pjesëmarrësve të këtij studimi që raportuan se janë ftuar të marrin pjesë në proceset e konsultimit në 2020 është më e ulët se në 2019. Në mënyrë të veçantë, përqindja është 4 pikë më poshtë në lidhje me ftesat për të marrë pjesë në proceset e konsultimit në nivel qendror (20% në 2020 në krahasim me 24% në 2019) dhe 2 pikë më e ulët në nivel vendor (11% në 2020 në krahasim me 13% në 2019).

Figura 33: Ftesat për të marrë pjesë në proceset e konsultimit 2016–2020



Baza: Niveli vendor: 2016 (N=1624), 2017 (N=1635), 2018 (N=1629), 2019 (N=2482), 2020 (N=2486); Niveli qendror: 2016 (N=1631), 2017 (N=1635), 2018 (N=1630), 2019 (N=2483), 2020 (N=2486).

\*Shënim: Që nga viti 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.


8.3% e pjesëmarrësve në studim raportuan se kanë marrë pjesë në procesin e konsultimit të organizuar nga qeveria qendrore, krahasuar me 10.7% në vitin 2019. 15.9% e pjesëmarrësve të studimit raportuan se kanë marrë pjesë në proceset e konsultimit të zhvilluara nga qeveria vendore, një përqindje më e vogël se në 2019 (24.6%).

Figura 34: Pjesëmarrja në takime konsultimi 2020

Në qeverisjen vendore



Në qeverisjen qendrore



Baza: Për qeverinë qendrore (N=2258); për qeverinë vendore (N=2285).

Arsyeja kryesore për mungesën e pjesëmarrjes ishte mosbesimi në takimet e konsultimit (27.5%), pasuar nga pritshmëria që duhet të marrin pjesë të tjerët (16.6%), dhe besimi se nuk ka mekanizma konsultimi (14.4%). Arsye të tjera janë mungesa e informacionit (9.8%) dhe vështirësitë për të ndjekur takimet e konsultimit (6.8%).




Tabela 17: Arsyet për mospjesëmarrje në takimet e konsultimit në vitin 2020

Mendoj që duhet të shkojnë të tjerët	16.6% (n = 416)
Nuk besoj tek këto procese konsultuese	27.5% (n = 687)
Nuk kam pasur informacion mbi temën që diskutohej	9.8% (n = 245)
Nuk kisha mundësi të shkoja tek vendi i takimit	6.8% (n = 171)
Mendoj se nuk ka mekanizma apo procese konsultuese	14.4% (n = 360)
Tjetër*	6.6% (n = 166)

\* Përgjigje të shpeshta në kategorinë “tjetër” ishin: probleme shëndetësore, mosha e thyer, mungesa e interesit, apo përgjigje që ishin përfshirë si alternativë, si mungesa e informacionit.

13% e pjesëmarrësve në studim raportuan se kanë përdorur portalin “www.konsultimipublik.gov.al” për të marrë informacione ose për të dhënë mendimin e tyre për nismat ligjore apo projekt-strategjitë/planet e veprimit - një përqindje më e lartë se në vitin 2019 (8%).

Figura 35: Përdorimi i portalit “www.konsultimipublik.gov.al” 2020



Baza: N = 2451

Kur bëjmë krahasime sipas karakteristikave demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, vendbanimit, statusit të aftësisë së kufizuar, apo përkatësi të një pakice kombëtare. Gratë (15%), krahasuar me burrat (11%), ishin më të predispozuar për të raportuar se kishin përdorur portalin online “www.konsultimipublik.gov.al”. Të anketuarit në grupmoshat e ‘26-35 vjeç’ (19%) dhe ‘36-45 vjeç’ (15%), me arsim universitar apo pasuniversitar (21%), studentët (16%), punonjësit e sektorit publik (28%), të anketuarit

me të ardhura mujore nga 50 001 lekë deri në 70 000 lekë (24%), apo të anketuarit nga zonat urbane (14%) ishin më të predispozuar për të raportuar se kanë përdorur portalin online “www.konsultimipublik.gov.al”. Shihni Tabelën 19 për më shumë informacione për dallimet sipas karakteristikave demografike.

### **Pohimet për pjesëmarrjen qytetare**

*Shumica e shqiptarëve besojnë se qytetarët kanë njohuri të mjaftueshme për të kuptuar vendimet e qeverisë (71%) dhe se dëgjesat publike vendore janë ngjarje formale (65%). Ndërkohë, më pak se 40% besojnë se sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit mbi projektligjet merren në konsideratë (38%) dhe se këshilltarët e bashkisë përfaqësojnë komunitetin dhe mbrojnë interesat e qytetarëve (35%).*

Pjesëmarrësve të sondazhit iu kërkua të jepnin vlerësimin e tyre duke përdorur një shkallë prej 4 pikësh për të deklaruar sa janë dakord me 5 pohimet që kanë të bëjnë me përfaqësimin vendor dhe angazhimin e qytetarëve në vendimmarrje. 71.2% e pjesëmarrësve në studim thanë se janë dakord ose plotësisht dakord me pohimin ‘Qytetarët kanë njohuri të mjaftueshme për të kuptuar vendimet e qeverisë’. 71% e të anketuarve femra dhe 72% e të intervistuarve meshkuj thanë se janë plotësisht dakord ose përgjithësisht dakord me pohimin. Të anketuarit me arsim universitar apo pasuniversitar (74%), që jetojnë në bashki të vogla (76%), ose që janë me aftësi të kufizuara (77%) ishin më të predispozuar për të rënë dakord me pohimin, ndërsa ata me nivel të ardhurash mbi 70 001 lekë (64%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord me pohimin.

Një përqindje më e vogël, 38%, thanë se janë plotësisht dakord ose përgjithësisht dakord me pohimin ‘Sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit mbi projektligjet, në përgjithësi, merren në konsideratë’. 37% e të anketuarve femra dhe 39% e të intervistuarit meshkuj thanë se janë dakord ose plotësisht dakord me pohimin. Punonjësit e sektorit publik (57%) dhe studentët (43%) ishin më të predispozuar për të rënë dakord me pohimin, ndërsa të anketuarit e papunë (30%), ata me nivel të ardhurash mbi 70 001 lekë (31%), apo të anketuarit me aftësi të kufizuara (30%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord me pohimin.


Shumica e të anketuarve, 64.8%, thanë se janë dakord ose plotësisht dakord me pohimin se ‘Dëgjesat publike vendore janë ngjarje formale’. 37% e të anketuarve femra dhe 39% e të anketuarve meshkuj thanë se janë plotësisht dakord ose përgjithësisht dakord me pohimin. Të papunët (70%), të anketuarit që banojnë në bashki të mesme (70%), të anketuarit me nivel të ardhurash mbi 70 001 (73%), apo të anketuarit që i përkasin një pakice kombëtare (71%) ishin më të predispozuar për të rënë dakord me pohimin.

34.6% thanë se ‘janë plotësisht dakord’ apo ‘përgjithësisht dakord’ me pohimin ‘Këshilltarët e bashkisë përfaqësojnë komunitetin dhe mbrojnë interesat e qytetarëve përballë kryetarit të bashkisë dhe administratës bashkiake’. 34% e të anketuarve femra

dhe 36% e të intervistuarve meshkuj deklaruan se janë dakord ose plotësisht dakord me pohimin. Të anketuarit mbi 66 vjeç (48%) dhe punonjësit e sektorit publik (40%) ishin më të predispozuar për të rënë dakord me pohimin, ndërsa të anketuarit që punojnë në sektorin privat (23%), ata me nivel të ardhurash mbi 70 001 lekë (20%), apo të anketuarit me aftësi të kufizuara (28%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord se këshilltarët bashkiakë përfaqësojnë komunitetin’.

32.2% thanë se janë ‘plotësisht dakord’ ose ‘përgjithësisht dakord’ me pohimin ‘Buxheti i bashkisë ku unë banoj reflekton prioritetet e qytetarëve’. 31% e të anketuarve femra dhe 33% e të intervistuarve meshkuj thanë se janë dakord ose plotësisht dakord me pohimin. Të anketuarit në grupmoshën ‘mbi 66 vjeç’ (44%) dhe punonjësit e sektorit publik (54%) ishin më të predispozuar për të rënë dakord me pohimin, ndërsa ata me nivel të ardhurash mbi 70 001 lekë (20%) apo të anketuarit me aftësi të kufizuara (19%) ishin më pak të prirur për të rënë dakord me pohimin. Në Tabelën 20 jepen më shumë informacione për dallimet sipas karakteristikave demografike.

**Figura 36: Pohimet për përfaqësimin vendor dhe angazhimin qytetar 2020**




Baza: Buxheti i bashkisë (N=2495); këshilltarët përfaqësojnë komunitetin (N=2495); dëgjesat publike (N=2490); sugjerimet merren në konsideratë (N=2490); qytetarët kanë njohuri të mjaftueshme (N=2488).

### Pjesëmarrja në një demonstratë/tubim apo nënshkrimi i një peticioni

*22% e të anketuarve kanë marrë pjesë në një demonstratë/tubim apo kanë nënshkruar një peticion në vitin 2020. Të anketuarit në grupmoshën 18-25 vjeç dhe ata me arsim universitar (apo pasuniversitar), studentët, punonjësit e sektorit privat, dhe banorët e zonave urbane ishin më të predispozuar për të raportuar se kanë marrë pjesë në një demonstratë/tubim apo të kenë nënshkruar një peticion në vitin 2020.*

77.9% e pjesëmarrësve në studim deklaruan se nuk kanë marrë pjesë në një demonstratë/tubim apo të kenë nënshkruar një peticion në vitin 2020 – një përqindje e përafërt me atë të sondazhit të vitit 2019 (76.4%).

**Figura 37: Pjesëmarrja në një demonstratë/tubim apo nënshkrimi i një peticioni në 2020**



Baza: N = 2483

Arsyeja kryesore për pjesëmarrjen në një demonstrim/tubim apo për nënshkrimin e një peticioni në vitin 2020 ishte ‘interesi i përbashkët i komunitetit ku jetoj’ (53,9%), pasuar nga interesi personal (25,7%), militantizmi (për mbështetje politike) (11,8%) dhe presioni i shokëve/të njohurve (6.6%). Disa të anketuar zgjodhën të japin arsyen e tyre personale, e cila përfshinte pjesëmarrjen në protestë kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave (N = 3) për shkak të një rasti tejet shqetësues të përdhunimit të një të miture nga roja i shkollës së saj; një person vuri në dukje se mori pjesë në protestë kundër shembjes së Teatrit Kombëtar dhe një tjetër mori pjesë në një demonstrim/tubim për ‘interesat kombëtare’.

Kur bëjmë krahasime sipas karakteristikave demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë dhe përkatësisë së një pakice kombëtare. 21% e të anketuarve femra dhe 23%


e të intervistuarve meshkuj deklaruan se kanë marrë pjesë në një demonstratë/tubim apo kanë nënshkruar një peticion në 2020. Të anketuarit në grupmoshën '18-25 vjeç' (36%) dhe me arsim universitar apo pasuniversitar (31%), studentët (35%), të punësuarit në sektorin privat (26%), të anketuarit nga zonat urbane (24%), dhe anëtarët e partive politike (37%) ishin më të predispozuar për të deklaruar se kanë marrë pjesë në një demonstratë/tubim apo kanë nënshkruar një peticion në 2020, ndërsa të anketuarit me aftësi të kufizuar ishin më pak të prirur (15%) për të deklaruar se kanë marrë pjesë në një demonstratë/tubim apo të kenë nënshkruar një peticion. Anëtarët e Partisë Demokratike (59.6%) – krahasuar me anëtarët e Partisë Socialiste (27.7%) dhe të Lëvizjes Socialiste për Integrim (40.7%) – ishin më të prirur të deklarorin se kishin marrë pjesë në një demonstratë/tubim apo kanë nënshkruar një peticion në 2020.

### Gatishmëria për t'u angazhuar në punë vullnetare

*Krahasuar me vitin 2019, një përqindje më e vogël e shqiptarëve ishin të gatshëm të angazhoheshin në punë vullnetare (67% me 78%). Shqiptarët nën moshën 45 vjeç, që po ndjekin studimet universitare, që punojnë në sektorin privat, dhe që banojnë në zonat rurale ishin më të predispozuar për të deklaruar se janë të gatshëm për t'u angazhuar në punë vullnetare.*

66.4% e pjesëmarrësve në sondazh raportuan se janë të gatshëm për t'u angazhuar në punë vullnetare për të mirën e komunitetit. Krahasuar me sondazhin e viteve 2019 (78%), 2018 (67%), 2017 (75%), dhe 2016 (77%), shohim një përqindje më të vogël të shqiptarëve që janë të gatshëm të angazhohen në punë vullnetare.

**Figura 38: Gatishmëria për t'u angazhuar në punë vullnetare 2020**



Baza: N = 2489


66.5% e të anketuarve femra dhe 66.2% e të intervistuarve meshkuj raportuan se janë të gatshëm për t'u angazhuar në punë vullnetare. Të intervistuarit e moshës nën 45 vjeç (mes 72% dhe 76%) dhe ata me arsim universitar apo pasuniversitar (77%), studentët (79%), punonjësit e sektorit publik (78%), të anketuarit me të ardhura mbi 24 001 lekë (73% to 75%), banorët e zonave rurale (69%), dhe të anketuarit që i përkasin një pakice kombëtare (70%) ishin më të prirur për të thënë se janë të gatshëm për t'u angazhuar në punë vullnetare. Të anketuarit me aftësi të kufizuara janë më pak të prirur (52%) në këtë drejtim, pra për t'u angazhuar në punë vullnetare për të mirën e komunitetit.

### Largimi nga vendbanimi aktual

*Përqindja e shqiptarëve që duan të largohen drejt një vendi tjetër mbetet e lartë. Në sondazhin e opinionit të vitit 2020, 44% e të anketuarve raportuan se duan të migrojnë. Gratë, të rinjtë e intervistuar (të moshës 18-25 vjeç), të anketuarit me diplomë universitare (ose pasuniversitare), studentët, punonjësit e sektorit privat, banorët e zonave rurale dhe të anketuarit që nuk kishin të ardhura ishin më të predispozuar për të deklaruar se më shumë dëshirë për t'u larguar drejt një vendi tjetër.*

Përqindja e shqiptarëve që duan të migrojnë drejt një vendi tjetër mbetet e lartë. 43.8% e pjesëmarrësve në studim thanë se donin të lëviznin jashtë vendit, 4.8% brenda vendit dhe 51.4% nuk donin të lëviznin. Këto përqindje për vitin 2019 ishin 46.3, 4.7 dhe 49.0, përkatësisht.

Figura 39: Largimi nga vendbanimi aktual 2020



Baza: N = 2481

47% e të anketuarve femra dhe 41% e të intervistuarve meshkuj raportuan se duan të zhvendosen në një shtet tjetër. Të anketuarit e moshës 18-25 vjeç (66%), ata me arsim universitar apo pasuniversitar (51%), studentët (67%), të punësuarit në sektorin privat (49%), banorët e zonave rurale (48%), dhe të anketuarit që raportuan se nuk kanë të ardhura (56%) ishin më të prirur të deklaronin se donin të zhvendoseshin në një shtet tjetër. Të anketuarit që i përkasin një pakice kombëtare (58%) dhe të anketuarit me aftësi të kufizuara (61%) ishin më të predispozuar të deklaronin se nuk duan të shkojnë në asnjë vend tjetër.

Pjesa më e madhe e të anketuarve që thanë se duan të ikin në një vend tjetër cilësuan faktorët ekonomikë si motivin kryesor për largimin (487 nga 1197), pasuar nga nevoja për një arsim më të mirë (67 nga 1197), dhe bashkimi familjar me anëtarë të familjes që jetojnë jashtë vendit (54 nga 1197). Arsye të tjera janë shërbim më i mirë shëndetësor, jeta në një vend me stabilitet politik dhe me shoqëri më të drejtë. Një numër i konsiderueshëm i pjesëmarrësve të sondazhit (543 nga 1197) përmendën më shumë se një faktor (p.sh., nivel më të lartë të ardhurash dhe shërbime më të mira shëndetësore).

**Tabela 18: Ndarja demografike – interesi dhe mundësitë e mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje 2020**

		Interesi për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes	Mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje	
			Qeveria qendrore	Qeveria vendore
<b>Gjithsej</b>		<b>49%</b>	<b>28%</b>	<b>39%</b>
<b>Gjinia</b>				
Femra		48%	26%	37%
Meshkuj		49%	30%	41%
<b>Mosha</b>				
18-25 vjeç		55%	32%	44%
26-35 vjeç		55%	32%	43%
36-45 vjeç		52%	33%	44%
46-55 vjeç		42%	24%	37%
56-65 vjeç		40%	19%	28%
mbi 66 vjeç		28%	16%	22%
<b>Niveli arsimor</b>				
Arsim deri 9-vjeçar*		35%	18%	25%
Me arsim të mesëm		47%	24%	36%
Me arsim universitar		60%	40%	51%
<b>Statusi i punësimit</b>				
I/E punësuar	Gjithsej	54%	33%	45%
	Spektori publik	66%	44%	57%
	Spektori privat	50%	29%	41%
I/E papunë		41%	21%	30%
Student		62%	35%	48%
Pensionist		31%	19%	23%
<b>Niveli i të ardhurave</b>				
Pa të ardhura		45%	23%	32%
Deri në 24,000 lekë		40%	22%	30%
24,001 – 50,000 lekë		55%	33%	47%
50,001 – 70,000 lekë		60%	41%	52%
Mbi 70,001 lekë		51%	38%	48%
<b>Vendbanimi</b>				
Urban		49%	28%	38%
Rural		48%	29%	40%

\* Grupi “Arsim deri 9-vjeçar” përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë diferencat prej >5 p.p. me totalin e përgjigjeve.



Tabela 19: Ndarja demografike e procesit të konsultimit në vitin 2020

	Ftesa për të marrë pjesë në konsultime në 2020		Pjesëmarrja në konsultime në 2020		Përdorimi i portalit <a href="http://www.konsultimi publik.gov.al">www.konsultimi publik.gov.al</a>
	Në nivel qendror	Në nivel vendor	Në nivel qendror	Në nivel vendor	
<b>Gjithsej</b>	<b>10.9%</b>	<b>20.3%</b>	<b>8.3%</b>	<b>15.9%</b>	<b>13%</b>
<b>Gjinia</b>					
Femra	10%	19%	8%	14%	15%
Meshkuj	12%	22%	9%	17%	11%
<b>Mosha</b>					
18-25 vjeç	10%	20%	6%	15%	12%
26-35 vjeç	12%	22%	11%	20%	19%
36-45 vjeç	14%	24%	10%	18%	15%
46-55 vjeç	10%	19%	7%	14%	10%
56-65 vjeç	7%	17%	5%	12%	9%
mbi 66 vjeç	7%	12%	6%	11%	2%
<b>Niveli arsimor</b>					
Arsim deri 9-vjeçar*	7%	14%	4%	9%	3%
Me arsim të mesëm	10%	18%	6%	14%	11%
Me arsim universitar	16%	27%	13%	23%	21%
<b>Statusi i punësimit</b>					
Gjithsej	13%	25%	11%	20%	17%
I/E punësuar	22%	40%	20%	33%	28%
Sektori publik	10%	20%	8%	16%	13%
Sektori privat	8%	13%	3%	8%	7%
I/E papunë	9%	22%	5%	17%	16%
Student	7%	11%	6%	12%	4%
Pensionist					

	Ftesa për të marrë pjesë në konsultime në 2020		Pjesëmarrja në konsultime në 2020		Përdorimi i portalit <a href="http://www.konsultimi publik.gov.al">www.konsultimi publik.gov.al</a>
	Në nivel qendror	Në nivel vendor	Në nivel qendror	Në nivel vendor	
<b>Niveli i të ardhurave</b>					
Pa të ardhura	8%	15%	4%	10%	9%
Deri në 24,000 lekë	8%	15%	6%	12%	6%
24,001 – 50,000 lekë	13%	26%	10%	20%	17%
50,001 – 70,000 lekë	17%	31%	16%	26%	24%
Mbi 70,001 lekë	18%	20%	12%	16%	12%
<b>Vendbanimi</b>					
Urban	11%	20%	9%	16%	14%
Rural	11%	20%	8%	15%	11%

\* Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).  
Shënimi: Ngjyrat përfaqësojnë diferencat prej >5 p.p. me totalin e përgjigjeve.

Tabela 20: Ndarja demografike e pohimeve për pjesëmarrjen/angazhimin qytetar në 2020

	Njohuri të mjaftueshme për të kuptuar nëse një vendim i qeverisë është i mirë apo i keq	Sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit merren në konsideratë	Dëgjuesat publike vendore janë ngjarje formale	Këshilltarët bashkiakë përfaqësojnë komunitetin	Buxheti i bashkisë reflekton prioritetet e qytetarëve
<b>Gjithsej</b>	<b>71%</b>	<b>38%</b>	<b>65%</b>	<b>35%</b>	<b>32%</b>
<b>Gjinia</b>					
Femra	71%	37%	65%	34%	31%
Meshkuj	72%	39%	64%	36%	33%
<b>Mosha</b>					
18-25 vjeç	70%	38%	68%	31%	24%
26-35 vjeç	70%	36%	68%	30%	28%
36-45 vjeç	72%	38%	66%	36%	37%
46-55 vjeç	72%	40%	64%	37%	35%
56-65 vjeç	73%	40%	63%	38%	35%
mbi 66 vjeç	74%	40%	50%	48%	44%
<b>Niveli arsimor</b>					
Arsim deri 9-vjeçar*	69%	33%	63%	35%	30%
Me arsim të mesëm	71%	38%	66%	34%	31%
Me arsim universitar	74%	41%	65%	35%	35%
<b>Statusi i punësimit</b>					
Gjithsej	72%	40%	65%	34%	35%
Spektori publik	74%	57%	59%	40%	54%
Spektori privat	71%	34%	66%	23%	28%

	Njohuri të mjaftueshme për të kuptuar nëse një vendim i qeverisë është i mirë apo i keq	Sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit merren në konsideratë	Dëgjesat publike vendore janë ngjarje formale	Këshilltarët bashkiakë përfaqësojnë komunitetin	Buxheti i bashkisë reflekton prioritetet e qytetarëve
<b>Gjithsej</b>	<b>71%</b>	<b>38%</b>	<b>65%</b>	<b>35%</b>	<b>32%</b>
I/E papunë	71%	30%	70%	29%	22%
Student	71%	43%	66%	36%	30%
Pensionist	73%	41%	54%	46%	42%
<b>Niveli i të ardhurave</b>					
Pa të ardhura	71%	33%	70%	32%	24%
Deri në 24,000 lekë	72%	39%	63%	36%	33%
24,001 – 50,000 lekë	73%	42%	64%	36%	37%
50,001 – 70,000 lekë	72%	42%	63%	40%	40%
Mbi 70,001 lekë	64%	31%	73%	20%	20%
<b>Vendbanimi</b>					
Urban	70%	38%	64%	34%	32%
Rural	74%	38%	67%	37%	32%
<b>Madhësia e bashkisë</b>					
E vogël	76%	39%	65%	33%	27%
E mesme	72%	40%	70%	36%	37%
E madhe	70%	37%	63%	35%	32%

\* Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).  
Shënimi: Ngjyrat përfaqësojnë diferencat prej >5 p.p. me totalin e përgjigjeve.

## 4.6 Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike

Nënkapitulli “Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike” ka qenë një pjesë e rëndësishme e Sondazhit të Opinionit Publik që në fillesat e tij në vitin 2013. Pyetjet janë hartuar për të mbledhur informacione për kënaqshmërinë e qytetarëve me 16 shërbimet bazë dhe administrative publike. Në shërbimet bazë janë shërbimet e shëndetit publik, shërbimet e arsimit publik (përfshirë atë parashkollor), furnizimi me ujë të pijshëm, transporti publik, shërbimet e pastrimit (të qytetit, fshatit), shërbimet e emergjencave (zjarrfikësja, ambulanca etj.), shërbimet gjyqësore, shërbimet e policisë. Në shërbimet administrative përfshijnë shërbimet e ndihmës sociale, shërbimet e punësimit (Shërbimi Kombëtar i Punësimit SHKP), shërbimet e pronësisë (Agjencia Shtetërore e Kadastrës ASHK: ish-Hipoteka dhe ALUIZNI), shërbimet e gjendjes civile, shërbimet e sigurimeve shoqërore (Instituti i Sigurimeve Shoqërore ISSH), shërbimet e transportit rrugor (Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor DPSHTRR), regjistrimi dhe licencimi i biznesit (Qendra Kombëtare e Biznesit QKB), lejet e ndërtimit.

Pyetjet u fokusuan edhe për të evidentuar nëse të anketuarit bënë ndonjë ankesë për ofruesit e shërbimit, paraqitën një ankesë në platformën e bashkëqeverisjes [www.shqiperiaqeduam.al](http://www.shqiperiaqeduam.al), dhe vizituan sportelet e Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA). Në këtë pjesë, të anketuarit u pyetën se sa të sigurt ndihen në jetën e tyre të përditshme dhe tre arsytet që i bëjnë ata të ndihen të pasigurt.

Gjatë vitit 2020, ofrimi i shërbimeve publike u ndërpre në zonat e dëmtuara nga tërmeti i muajit nëntor 2019, dhe më pas në të gjithë vendin si rezultat i kufizimeve të diktuar nga pandemia Covid-19. Kur u diagnostikuan rastet e para në fillim të muajit mars 2020, në fillim Shqipëria hyri në periudhën e mbylljes totale, gjatë të cilës u pezulluan shërbimet jo të domosdoshme. Pas rihapjes, rifilloi gradualisht ofrimi i shërbimeve, ndonëse u ruajtën kufizimet për të parandaluar përhapjen e mëtejshme e virusit, përfshirë ofrimin e disa shërbimeve vetëm në formatin online. Kështu, disa nga rezultatet në këtë nënkapitull ka gjasa të ndikohen nga këto kufizime.


### **Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike bazë**

*Në vitin 2020, 38% e shqiptarëve, mesatarisht, ishin të kënaqur me ofrimin e shërbimeve publike bazë – përqindje më e ulët se në 2019 (42%). Ofrimi i shërbimeve gjyqësore mori vlerësimin më të ulët, ndjekur nga shërbimi i transportit publik dhe shërbimet e policisë.*

Të anketuarve iu kërkua të vlerësonin sa të kënaqur janë me shërbimet publike duke përdorur një shkallë nga 1 (shumë i kënaqur) në 4 (shumë i pakënaqur). Gjetjet sugjerojnë se mesatarisht 38% e pjesëmarrësve në këtë studim ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me shërbimet publike bazë. Krahasuar me rezultatet e sondazhit të vitit të kaluar, kemi

një përqindje më të vogël të të anketuarve (38% në 2020 nga 42% në 2019) që raportuan se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me shërbimet publike bazë. Mesatarisht 56.5% e pjesëmarrësve të këtij studimi raportuan se ishin të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me ofrimin e shërbimeve publike bazë. Një përqindje më e madhe të anketuarish deklaruan se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me ofrimin e shërbimit të arsimit publik (48.6%) shërbimet e pastrimit (të qytetit, fshatit) (48.5%). Ndërkohë, një përqindje më e vogël e të anketuarve raportuan se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me shërbimet gjyqësore (19.6%), transportin publik (32.4%), dhe shërbimet e policisë (32.6%). Për vlerësimin e të gjitha shërbimeve bazë publike shihni Figurën 40.

Figura 40: Kënaqshmëria me shërbimet publike 2020



Baza: Kujdesi shëndetësor (N=2471); Arsimi (N=2449); Ujësjellësi (N=2475); Transporti publik (N=2465); Pastrimi (N=2463); Emergjenca (N=2422); Gjyqësori (N=2368); Policia (N=2375); Asistenca sociale (N=2362); Punësimi (N=2384); Pronat (N=2349); Gjendja civile (N=2418); Sigurimet shoqërore (N=2399); Transporti rrugor (N=2376); Regjistrimi i biznesit (N=2329); Lejet e ndërtimit (N=2338).

## Kënaqshmëria me shërbimet publike administrative

*44.7% e të anketuarve të këtij sondazhi që kishin përdorur një shërbim administrativ në vitin 2020 ishin të kënaqur me atë shërbim. Shërbimi i punësimit, i lejeve të ndërtimit dhe ai i pronësisë morën vlerësimet më të ulëta mes shërbimeve publike administrative.*

Të anketuarit dhanë vlerësimin e tyre për faktin sa të kënaqur janë me ofrimin e tetë shërbimeve administrative publike, përfshirë shërbimet e ndihmës sociale, shërbimet e punësimit, shërbimet e pronësisë, shërbimet e gjendjes civile, shërbimet e sigurimeve shoqërore, shërbimet e transportit rrugor, regjistrimi dhe licencimi i biznesit dhe lejet e ndërtimit. Mesatarisht, 32.8% e të anketuarve raportuan se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me ofrimin e shërbimeve administrative publike, me një rënie prej 1.7 p.p. krahasuar me sondazhin e vitit 2019 (32.8% në 2020 nga 34.5% në 2019).<sup>18</sup> Një përqindje më e madhe e të anketuarve deklaruan se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me shërbimet e gjendjes civile (55.0%), shërbimet e sigurimeve shoqërore (39.6%), dhe shërbimet e transportit rrugor (37.7%). Nga ana tjetër, një përqindje më e vogël raportuan se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me shërbimin e punësimit (23.3%), lejet e ndërtimit (23.5%), dhe shërbimin e hipotekës (25.7%). Për vlerësimin e të gjitha shërbimeve administrative të renditura në këtë sondazh shihni Figurën 40.

Përdoruesit e shërbimit, krahasuar me ata që nuk i kanë përdorur këto shërbime, ishin më të predispozuar për të raportuar se ishin të kënaqur me shërbimet publike administrative. Mesatarisht, 44.7% e të anketuarve që kishin përdorur një shërbim administrativ në 2020 ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me ofrimin e shërbimeve administrative.<sup>19</sup>

Niveli i kënaqshmërisë ishte dukshëm më i lartë te të anketuarit që kishin përdorur shërbimin administrativ që u kërkohet të vlerësonin në krahasim me totalin e të anketuarve në përgjithësi. Për shembull, shërbimi i transportit rrugor regjistroi një nivel kënaqshmërie prej 56% për ata që kishin përdorur shërbimin, krahasuar me nivelin e përgjithshëm prej 38% të kënaqësisë me shërbimin (një rritje prej 18 p.p.); shërbimi i sigurimeve shoqërore (54% niveli i kënaqësisë për ata që kishin përdorur shërbimin, krahasuar me nivelin total prej 40% të kënaqësisë – me një rritje prej 14 p.p.); dhe shërbimi i gjendjes civile (me 68% nivel kënaqësie për ata që kishin përdorur shërbimin, krahasuar me 55% të nivelit të përgjithshëm të kënaqësisë - një rritje prej 13 p.p.). Po ashtu, të anketuarit që kishin përdorur shërbimin e asistencës sociale, shërbimin e punësimit dhe të lejeve të ndërtimit ishin më të kënaqur me ofrimin e shërbimit sesa ata të anketuarit që nuk i kishin përdorur këto shërbime. Në Tabelën 21 jepen informacione për përdorimin dhe kënaqshmërinë me ofrimin e shërbimeve administrative.



18 Kjo përqindje është niveli i kënaqshmërisë për të gjitha shërbimet administrative publike të marra së bashku.

19 Kjo përqindje është niveli i kënaqshmërisë për të gjitha shërbimet administrative publike të marra së bashku mes të anketuarve që përdorën shërbimin në 2020.

**Tabela 21: Përdorimi dhe kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike administrative 2020**

	Niveli i përgjithshëm i kënaqshmërisë	% e të anketuarve që përdorën shërbimin në 2020	Niveli i kënaqshmërisë mes atyre që kishin përdorur shërbimin
Shërbimi i asistencës sociale	28%	29%	37%
Shërbimi i punësimit	23%	31%	29%
Shërbimi i pronësisë	26%	28%	34%
Shërbimi i gjendjes civile	55%	52%	68%
Shërbimi i sigurimeve shoqërore	40%	41%	54%
Shërbimet e transportit rrugor	38%	29%	56%
Regjistrimi dhe licencimi i bizneseve	29%	16%	48%
Lejet e ndërtimit	23%	20%	29%

\* Shënim: Ngjyra e gjelbër përfaqëson përmirësim prej >5 p.p. krahasuar me nivelin e përgjithshëm të kënaqshmërisë.

Shërbimi i gjendjes civile (52%), shërbimi i sigurimeve shoqërore (41%), dhe shërbimi i punësimit (31%) ishin shërbimet që u përdorën më shpesh në vitin 2020. Shërbimet më pak të përdorura ishin shërbimi i regjistrimit dhe licencimit të biznesit (16%) dhe ai i lejeve të ndërtimit (20%).

### **Krahasimi demografik për kënaqshmërinë me ofrimin e shërbimeve publike**

*Shqiptarët e moshës mbi 65 vjeç, ata me arsim universitar (apo pasuniversitar), ata të punësuar në sektorin publik dhe ata që banojnë në zonat urbane ishin më të kënaqur me shërbimet e ofruara publike bazë si dhe me shërbimet administrative publike.*

Kur bëjmë krahasime sipas karakteristikave demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë apo vendbanimit. Të anketuarat femra ishin më të predispozuara për të qenë të kënaqura me shërbimin e arsimit (50%), shërbimin e emergjencës (41%), shërbimi e policisë (34%), dhe atë të sigurimeve shoqërore (56%), ndërsa të intervistuarit meshkuj ishin më të predispozuar për të qenë të kënaqur me shërbimin e transportit rrugor (59%), shërbimin e regjistrimit dhe licencimit të biznesit (50%), dhe atë të lejeve të ndërtimit (31%).



Të anketuarit në grupmoshën ‘mbi 66 vjeç’ ishin më të predispozuar për të raportuar se ishin të kënaqur apo shumë të kënaqur me shërbimet bazë publike dhe shërbimet administrative publike (si për përdoruesit ashtu edhe për jo-përdoruesit), si shërbimi i kujdesit shëndetësor (49%), shërbimi i arsimit publik (58%), shërbimi i ujësjellësit (47%), shërbimi i transportit publik (40%), shërbimi i pastrimit (57%), shërbimi i emergjencës (49%), shërbimi i policisë (43%), shërbimi i asistencës sociale (39%), shërbimi i pronësisë (46%), dhe shërbimi i gjendjes civile (78%). Të anketuarit me arsim universitar apo pasuniversitar ishin më të prirur për të raportuar se ishin të kënaqur apo shumë të kënaqur me shërbimet publike si shërbimi i kujdesit shëndetësor (48%), shërbimi i arsimit (54%), shërbimi i ujësjellësit (46%), shërbimi i pastrimit (55%), shërbimi i emergjencës (46%), shërbimi i asistencës sociale (48%), shërbimi i punësimit (37%), shërbimi i pronësisë (41%), dhe shërbimi i transportit rrugor (64%).

Të punësuarit në sektorin publik, krahasuar me ata të punësuar në sektorin privat, ishin më të predispozuar për të raportuar se ishin të kënaqur apo shumë të kënaqur me të gjitha shërbimet (pavarësisht nëse i kanë përdorur këto shërbime apo jo). Të anketuarit e papunë dhe ata pa të ardhura mujore ishin më pak të prirur për të raportuar se ishin të kënaqur apo shumë të kënaqur me të gjitha shërbimet publike bazë dhe me disa shërbime administrative publike. Të anketuarit pa të ardhura raportojnë më pak se janë të kënaqur apo shumë të kënaqur me shërbimin e punësimit (17%), shërbimin e gjendjes civile (57%), me sigurimet shoqërore (32%), transportin rrugor (44%), dhe regjistrimin e licencimin e biznesit (32%). Të anketuarit me të ardhura mes 50,001 lekë dhe 70,000 lekë ishin më të predispozuar të ishin të kënaqur apo shumë të kënaqur me pjesën më të madhe të shërbimeve të vlerësuara. Shihni Tabelën 24 për kënaqshmërinë me shërbimet publike bazë sipas karakteristikave demografike.

Të anketuarit që thanë se ishin anëtarë të një pakice kombëtare (si përdoruesit ashtu edhe jo-përdoruesit) ishin më pak të prirur për të qenë të kënaqur me shërbimin e arsimit publik (36%), shërbimin e pastrimit (39%), shërbimin e emergjencës (32%), dhe shërbimin e gjendjes civile (49%) sesa të anketuarit që nuk i përkasin një pakice kombëtare (49%, 49%, 40%, dhe 55% përkatësisht). Nga ana tjetër, të anketuarit që i përkasin një pakice kombëtare ishin më të predispozuar të ishin të kënaqur apo shumë të kënaqur me shërbimin e transportit publik (38%) në krahasim me ata që nuk i përkasin asnjë pakice kombëtare (32%).

Të intervistuarit që deklaruan se kanë aftësi të kufizuara (si përdoruesit ashtu edhe jo-përdoruesit) ishin më pak të prirur për të deklaruar se ishin të kënaqur apo shumë të kënaqur me shërbimin e arsimit publik (41%), shërbimin e ujësjellësit (35%), shërbimin e transportit publik (27%), shërbimin e pastrimit (38%), shërbimin e emergjencës (30%), shërbimet gjyqësore (12%), shërbimin e punësimit (17%), shërbimin e transportit rrugor (31%), dhe shërbimin e lejeve të ndërtimit (19%) në krahasim me të anketuarit që nuk kanë aftësi të kufizuara (49%, 42%, 33%, 49%, 40%, 20%, 24%, 38%, dhe 24% përkatësisht).

## Tendenca vjetore me kënaqshmërinë me ofrimin e shërbimeve publike

*Krahasuar me vitin 2019, një përqindje më e vogël shqiptarësh raportuan se ishin të kënaqur apo shumë të kënaqur me ofrimin e shërbimeve publike. Rënie u vu re, në mënyrë të veçantë, me shërbimin e kujdesit shëndetësor publik, shërbimin e furnizimit me ujë, shërbimin e transportit publik, shërbimin e emergjencës, shërbimin e policisë, shërbimin e transportit rrugor dhe shërbimin e regjistrimit dhe licencimit të biznesit.*

Krahasuar me Sondazhin e vitit 2019, përqindja e të gjithë të anketuarve që ishin të kënaqur me shërbimet publike ra në 11 nga 16 kategoritë e shërbimeve publike bazë dhe administrative. Kjo përqindje mbeti e njëjtë për shërbimet gjyqësore, atë të pronësisë, lejeve të ndërtimit dhe pati një përmirësim fare të vogël (1 p.p.) në shërbimin e arsimit publik dhe atë të punësimit. Përqindje të ulëta të anketuarish që raportuan se ishin të kënaqur apo shumë të kënaqur me shërbimet publike u regjistruan në fusha të tilla si shërbimi i kujdesit shëndetësor (44% me 41%), ai i furnizimit me ujë (47% me 42%), transportit publik (36% me 32%), shërbimi i emergjencës (47% me 40%), shërbimi i policisë (41% me 33%), transportit rrugor (43% me 38%), dhe regjistrimi dhe licencimi i biznesit (35% me 29%).

**Tabela 22: Niveli i kënaqshmërisë me ofrimin e shërbimeve publike 2016–2020**


	2016	2017	2018	2019	2020
<b>Shërbimet publike bazë</b>					
Shërbimet e kujdesit shëndetësor	47%	42%	41%	44%	41%
Shërbimet e arsimit publik	58%	54%	50%	48%	49%
Furnizimi me ujë të pijshëm	72%	56%	50%	47%	42%
Spektori publik transport	55%	50%	37%	36%	32%
Transporti publik	61%	57%	49%	51%	49%
Shërbimet e emergjencave	55%	53%	44%	47%	40%
Shërbimet gjyqësore	21%	15%	19%	20%	20%
Shërbimi i policisë	66%	50%	40%	41%	33%
<b>Shërbimet administrative</b>					
Shërbimi i asistencës sociale	34%	34%	31%	30%	28%
Shërbimi i punësimit	18%	19%	17%	22%	23%
Shërbimi i pronësisë (hipoteka)	X	X	26%	26%	26%
Shërbimet e gjendjes civile	X	X	X	57%	55%
Shërbimet e sigurimeve shoqërore	X	X	X	42%	40%
Shërbimet e transportit rrugor	X	X	X	43%	38%
Regjistrimi dhe licencimi i biznesit	35%	36%	32%	35%	29%
Lejet e ndërtimit	X	X	24%	24%	24%

## Paraqitja e ankesave

*Krahasuar me vitin 2019, një përqindje më e vogël të anketuarish kishin bërë ankesë tek institucioni publik që ofron shërbimin (12% me 17%). Të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç dhe ata me arsim të mesëm, të papunët dhe të intervistuarit me të ardhura mujore 24,000 lekë në muaj ishin më pak të prirur për të bërë ndonjë ankesë.*

Pjesëmarrësit e këtij sondazhi u pyetën nëse kishin bërë ndonjë ankesë për një shërbim që kishin marrë nga një prej institucioneve publike që ofronin shërbimin. 12% e pjesëmarrësve në sondazh të cilët kishin marrë një shërbim thanë se kishin bërë një ankesë, ndërsa 88% deklaruan se nuk kishin bërë asnjë ankesë. Kur bëjmë krahasime sipas karakteristikave demografike, nuk vihen re dallime të mëdha mes grupmohave, sektorit të punësimit, vendbanimit, dhe (pa)aftësisë fizike së të anketuarit. 11% e të anketuarve femra dhe 14% e të intervistuarve meshkuj raportuan se kishin bërë një ankesë për një shërbim të marrë nga institucionet. Të anketuarit në grupmohën ‘mbi 66 vjeç’ (5%), ata me arsim deri të mesëm (7%), të papunët(11%), dhe ata me të ardhura mujore deri në 24,000 lekë (10%) ishin më pak të prirur për të bërë ndonjë ankesë, ndërsa të anketuarit që i përkasin një pakice kombëtare kishin më shumë gjasa (18%) se mund të kishin bërë ndonjë ankesë.

**Figura 41: Të anketuarit që kishin paraqitur ankesë tek institucionet 2016–2020**



Baza: 2016 (N = 1627); 2017 (N = 1639); 2018 (N = 1628); 2019 (N = 2491); 2020 (N = 2488)

Krahasuar me vitin 2019, një përqindje më e vogël të anketuarish kishin bërë ankesë tek institucioni publik që ofron shërbimin (12% me 17%). Në vitin 2018, 11% e të anketuarve të këtij sondazhi thanë se kishin bërë ankesë në një nga institucionet publike ku kishin marrë shërbimin, krahasuar me 15% në 2017, dhe 16% në 2016.

### **Platforma e bashkëqeverisjes ‘shqiperiaqeduam.al’**


*Krahasuar me vitin 2019, një përqindje më e vogël e të anketuarve bënë ankesë te platforma online [www.shqiperiaqeduam.al](http://www.shqiperiaqeduam.al) (12% me 14%). Shqiptarët me të ardhura mujore mbi 70,001 lekë ishin më të predispozuar për të bërë ankesë në platformën [shqiperiaqeduam.al](http://shqiperiaqeduam.al).*

12.1% e pjesëmarrësve të këtij studimi thanë se e kishin përdorur platformën [www.shqiperiaqeduam.al](http://www.shqiperiaqeduam.al), ndërsa 87.9% thanë se nuk e kishin përdorur këtë platformë.

Kur bëjmë krahasime sipas karakteristikave demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, statusit të punësimit, sektorit të punësimit, vendbanimit, dhe nëse i anketuari ka apo jo aftësi të kufizuar. 11% e të anketuarve femra dhe 13% e të intervistuarve meshkuj deklaruan se kishin përdorur platformën [shqiperiaqeduam.al](http://shqiperiaqeduam.al). Të anketuarit në grupmoshën ‘mbi 66 vjeç’ (4%) dhe ata me arsim deri të mesëm (9%) ishin më pak të prirur për të përdorur platformën. Të anketuarit që i përkasin një pakice kombëtare (21%) apo me të ardhura mujore mbi 70,001 lekë ishin më të predispozuar për të bërë ankesë në platformën në fjalë. 22% e të anketuarve me të ardhura mbi 70,001 lekë dhe 8% e të intervistuarve me të ardhura mujore deri në 24,000 lekë raportuan se e kishin përdorur platformën.

Krahasuar me vitin e kaluar, përqindja e të anketuarve që kishin përdorur platformën pati një rënie të lehtë. Në mënyrë të veçantë, 12.1% e pjesëmarrësve të këtij studimi në 2020 dhe 13.9% në 2019 raportuan se kishin përdorur platformën [shqiperiaqeduam.al](http://shqiperiaqeduam.al) – një diferencë prej 1.8 p.p.

**Figura 42: A keni bërë ndonjë ankesë tek Platforma e Bashkëqeverisjes ‘www.shqiperiaqeduam.al’? 2020**



Baza: N = 2482

Të anketuarit që kishin bërë ankesë nëpërmjet platformës shqiperiaqeduam.al u pyetën më pas nëse ankesa e tyre ishte trajtuar apo zgjidhur. Nga të anketuarit që kishin bërë ankesë, vetëm 44% thanë se u ishte zgjidhur problemi, ndërsa 53% deklaruan se ankesa e tyre nuk ishte trajtuar fare. Në sondazhin e vitit 2019, 37% e të anketuarve thanë se ankesa e tyre ishte trajtuar.

Kur bëjmë krahasime sipas karakteristikave demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, nivelit arsimor, ose vendbanimit. 44% e të anketuarve femra dhe 45% e të intervistuarve meshkuj thanë se ankesa e tyre ishte trajtuar. Të anketuarit në grupmoshën ‘56–65 vjeç’ (56%), të anketuarit në marrëdhënie pune (51%), punonjësit e sektorit publik (66%), dhe të anketuarit që i përkasin një pakice kombëtare (61%) ishin më të predispozuar për të raportuar se ankesa e tyre ishte trajtuar. Të anketuarit mbi 66 vjeç (22%), të anketuarit e papunë (31%), të anketuarit pa të ardhura (28%), dhe ata që thanë se kanë një aftësi të kufizuar (29%) ishin më pak të prirur të raportonin se ankesa e tyre ishte trajtuar.


### **Institucionet shqiptare “i dëgjojnë” qytetarët**

*Ashtu si në vitin 2019, afërsisht 1 në 4 shqiptarë besojnë se institucionet ‘i dëgjojnë’ dhe i trajtojnë siç duhet ankesat e qytetarëve. Të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç, ata me arsim universitar (apo pasuniversitar) dhe ata të punësuar në sektorin publik ishin më të predispozuar për të besuar se institucionet “i dëgjojnë” dhe i trajtojnë siç duhet ankesat e qytetarëve.*

Të anketuarit u pyetën nëse besojnë se institucionet ‘i dëgjojnë’ dhe i trajtojnë siç duhet ankesat që vijnë nga qytetarët. 24.5% e anketuarve u përgjigjën se ata besojnë se institucionet ‘i dëgjojnë’ dhe trajtojnë siç duhet ankesat që vijnë nga qytetarët. 50.9% e tyre menduan se institucionet nuk i dëgjojnë ankesat e qytetarëve dhe nuk i trajtojnë më vëmendjen e duhur shqetësimit e tyre, ndërsa 23.7% nuk ishin të sigurt nëse institucionet publike punojnë mirë për të trajtuar sugjerimet dhe ankesat e qytetarëve. Të ndarë sipas gjinisë, 24% e të anketuarve femra dhe 27% e të intervistuarve meshkuj besojnë se institucionet ‘i dëgjojnë’ dhe i trajtojnë siç duhet ankesat që vijnë nga qytetarët. Të anketuarit në grupmoshën ‘mbi 66 vjeç’ (35%), ata me arsim universitar dhe pasuniversitar (29%), apo ata të punësuar në sektorin publik (46%) ishin më të predispozuar për të besuar se institucionet ‘i dëgjojnë’ dhe i trajtojnë siç duhet ankesat që vijnë nga qytetarët. Të anketuarit që i përkasin një pakice kombëtare (19%) dhe të anketuarit që kanë një aftësi të kufizuar (18%) ishin më pak të prirur për të besuar se institucionet ‘i dëgjojnë’ dhe i trajtojnë siç duhet ankesat që vijnë nga qytetarët.

Në Figurën 43 jepet ndryshimi në deklaratimet e të anketuarve nëse institucionet “i dëgjojnë” dhe i trajtojnë siç duhet ankesat e qytetarëve. Përqindja e të intervistuarve të këtij sondazhi që besonin se institucionet “i dëgjojnë” dhe i trajtojnë siç duhet ankesat e qytetarëve ishte më e ulët këtë vit se në vitet 2016 dhe 2017, por nuk ndryshoi shumë në krahasim me periudhën 2018-2020.

**Figura 43: Institucionet “i dëgjojnë” dhe i trajtojnë siç duhet ankesat që vijnë nga qytetarët? 2016-2020**



Baza: 2016 (N = 1259); 2017 (N = 1599); 2018 (N = 1565); 2019 (N = 2464); 2020 (N = 2475)


## Vlerësimi i cilësisë së shërbimeve sociale të ofruara nga bashkia

*Më shumë se gjysma e shqiptarëve nuk mendojnë se ka ndryshim në cilësinë e shërbimeve sociale në vitin 2020. Shqiptarët e moshës mbi 65 vjeç, me arsim universitar ose pasuniversitar, dhe të punësuarit në sektorin publik ishin më të predispozuar për të raportuar se cilësia e shërbimeve sociale ishte përmirësuar.*

Të anketuarve iu kërkua të vlerësonin cilësinë e shërbimeve sociale të ofruara nga bashkitë për vitin 2020 për t'i krahasuar me vitin 2019. 57.2% e të anketuarve thanë se cilësia e shërbimeve sociale nuk kishte ndryshuar. Ndërkohë, 23.6% thanë se cilësia e shërbimeve sociale ishte përmirësuar dhe 19.2% deklaruan se kjo cilësi ishte përkeqësuar.

Kur bëjmë krahasime sipas karakteristikave demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas nivelit të të ardhurave, vendbanimit, aftësisë së kufizuar, apo përkatësisë në pakicë kombëtare. 22% e të anketuarve femra dhe 25% e të intervistuarve meshkuj thanë se cilësia e shërbimeve sociale në bashkinë e tyre ishte përmirësuar. Të anketuarit në grupmoshën 'mbi 66 vjeç' (30%), ata me arsim universitar ose pasuniversitar (28%), dhe të punësuarit në sektorin publik (42%) ishin më të predispozuar për të raportuar se cilësia e shërbimeve sociale ishte përmirësuar. Krahasuar me sondazhin e vitit 2019, kemi një përqindje më të madhe të të anketuarve që deklaruan se cilësia e shërbimeve sociale nuk kishte ndryshuar (57.2% në 2020 me 52.8% në 2019).

**Figura 44: Ndryshimet në cilësinë e shërbimeve sociale të bashkive 2020**




Baza: N = 2467

## Sportelet e shërbimit në ADISA

*29% e shqiptarëve të anketuar kishin vizituar një sportel shërbimi të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA). Mes atyre që kishin vizituar ADISA-n, 73.4% thanë se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me shërbimin që morën, i cili ishte më i mirë se në vitin 2019. Ndërkohë që shqiptarët mbi 66 vjeç ishin veçanërisht të kënaqur me ofrimin e shërbimit në sportelin e shërbimit ADISA, ata me nivel më të lartë të ardhurash ishin më pak të prirur të raportonin se ishin të kënaqur me shërbimet e ofruara.*

29.4% e të anketuarve të këtij studimi raportuan se kishin vizituar një sportel shërbimi ADISA. Krahasuar me vitin 2019, një përqindje më e madhe e pjesëmarrësve në këtë sondazh raportuan se kishin vizituar një sportel shërbimi ADISA; 29.4% krahasuar me 23.9% – një diferencë prej 5.5 p.p.

**Figura 45: Të anketuarit që kanë vizituar një sportel shërbimi ADISA në 2020**



Baza: N = 2473

Kur bëjmë krahasime sipas karakteristikave demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas vendbanimit apo përkatësisë ndaj një pakice kombëtare. 28% e të anketuarve femra dhe 31% e të intervistuarve meshkuj raportuan se kishin vizituar një sportel shërbimi në vitin 2020. Të anketuarit në grupmoshën ‘mbi 66 vjeç’ (15%), ata me arsim deri të mesëm (24%), dhe ata të punësuar në sektorin privat (29%) ishin më pak të prirur të raportonin se kishin vizituar një sportel shërbimi ADISA në vitin 2020, ndërsa të anketuarit me nivel të ardhurash 50,001 deri në 70,000 lekë (39%) apo mbi 70,001 lekë (38%) ishin më të predispozuar të deklaronin se kishin vizituar një sportel shërbimi ADISA në 2020. Si për




krahasim, pjesëmarrësit në këtë sondazh që thanë se kanë një aftësi të kufizuar (24%) ishin më pak të prirur të raportonin se kishin vizituar një sportel shërbimi ADISA në vitin 2020.

Të anketuarit që kishin vizituar një sportel shërbimi ADISA, u pyetën për të deklaruar sa të kënaqur ishin me shërbimin. Mes tyre, 73.4% thanë se ishin të kënaqur (51.0%) ose shumë të kënaqur (22.4%) me shërbimin që morën. Krahasuar me sondazhin e 2019, një përqindje më e madhe e të anketuarve thanë se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me shërbimin (73.4% me 69.3%).

**Figura 46: Kënaqshmëria me sportelet e shërbimit me një ndalesë në zyrat e ADISA në 2020**

Baza: N = 722



Kur i analizojmë sipas karakteristikave demografike, nuk vihen re dallime të mëdha për nga niveli arsimor, statusi i punësimit, vendbanimi, apo përkatësia ndaj një pakice kombëtare. 75% e të anketuarve femra dhe 72% e të intervistuarve meshkuj raportuan se ishin të kënaqur apo shumë të kënaqur me shërbimet e ofruara nga ADISA. Të anketuarit e moshës mbi 66 vjeç (80%) ishin më të predispozuar për të deklaruar se ishin të kënaqur me shërbimet e ofruara nga ADISA, ndërsa të anketuarit me të ardhura mbi 70,001 lekë (52%) ishin më pak të prirur për të raportuar se ishin të kënaqur apo shumë të kënaqur me shërbimet e ofruara nga ADISA në sportelet e shërbimit.


### Siguria në jetën e përditshme

*In 2020, 70% e shqiptarëve të anketuar nuk ndihen të sigurt në jetën e përditshme - përqindje më e madhe se në 2019 (65%). Gratë, të papunët, studentët, të punësuarit në sektorin privat, banorët e zonave rurale dhe ata pa të ardhura ishin më të prirur të raportonin se nuk ndihen të sigurt në jetën e përditshme. Arsyeja kryesore e ndjenjës së pasigurisë lidhet me kriminalitetin, shëndetësia pa cilësi e standard, pasiguria e vendit të punës, dhe padrejtësia.*

Që nga viti 2016, në sondazhin e opinionit të anketuarit janë pyetur se sa të sigurt ndihen në jetën e tyre të përditshme. 70% e të anketuarve nuk ndihen të sigurt në jetën e përditshme. Gratë (72%), krahasuar me burrat (68%), prireshin më shumë për të deklaruar se nuk ndihen të sigurt në jetën e përditshme. Të papunët (79%), studentët (75%), të punësuarit në sektorin privat (72%), banorët e zonave rurale (75%), dhe të intervistuarit pa të ardhura (77%) kishin më shumë gjasa të raportonin se nuk ndiheshin të sigurt në jetën e përditshme. Të anketuarit që raportuan se kanë aftësi të kufizuar (81%), krahasuar me ata që raportuan se nuk kanë aftësi të kufizuar (70%), kishin edhe më shumë gjasa të raportonin se nuk ndihen të sigurt në jetën e përditshme. 68% e të anketuarve që vetë-identifikohen si anëtarë të një pakice kombëtare dhe 70% e atyre që nuk u vetë-identifikuan si anëtarë të ndonjë pakice kombëtare raportuan se nuk ndihen të sigurt në jetën e përditshme.

Krahasuar me sondazhin e vitit 2019, kur 65% e të anketuarve thanë se nuk ndiheshin të sigurt në jetën e përditshme, këtë vit përqindja u rrit në 70%. Në Figurën 47 tregohet ndryshimi në perceptimin e sigurisë në jetën e përditshme gjatë periudhës 2016–2020. Duke filluar që nga viti 2017, vëmë re një rënie të përqindjes së të anketuarve që thonë se ndihen të sigurt – nga 51% në 2017 në 30% në 2020.

**Figura 47: Perceptimi për sigurinë në jetën e përditshme 2016 –2020**



**Baza:** 2016 (N=1608); 2017 (N=1615); 2018 (N=1629); 2019 (N=2500); 2020 (N=2492)

Të anketuarve që treguan se nuk ndiheshin të sigurt në jetën e tyre të përditshme iu kërkua të identifikonin tre faktorët kryesorë që i bënin të ndiheshin të pasigurt. Ashtu si me sondazhin e vitit 2019, tre faktorët kryesorë ishin kriminaliteti (59%), shëndetësia pa cilësi e standard (49%) dhe pasiguria e vendit të punës (41%). Opsioni i shtuar rishtazi, “ndjenja e pasigurisë për shkak të fatkeqësive të tilla si tërmeti dhe pandemia”, u përmend nga një në katër, ose 27% e të anketuarve. Faktorë të tjerë të përmendur më shpesh ishin padrejtësia (37%), politika (23%), dhe shpërndarja e pabarabartë e pasurisë (18%). Në Tabelën 23 jepet lista e arsyeve e ndjenjës së pasigurisë gjatë viteve 2016-2020.

Tabela 23: Faktorët për ndjenjën e pasigurisë 2016–2020

Faktorët për ndjenjën e pasigurisë	2016	2017	2018	2019	2020
Kriminaliteti (vjedhjet, grabitjet)	49%	58%	71%	67%	59% (N=1017)
Shëndetësia pa cilësi e standard	11%	30%	50%	49%	49% (N=833)
Pasiguria e vendit të punës	X	42%	52%	36%	41% (N=696)
Padrejtësia	11%	32%	45%	36%	37% (N=632)
Ndjenja e pasigurisë për shkak të fatkeqësive natyrore (p.sh., tërmete, pandemi)	X	X	X	X	27% (N=468)
Politika	5%	29%	45%	28%	23% (N=393)
Pabarazia në pasuri	3%	23%	23%	16%	18% (N=311)
Ndotja e mjedisit	3%	12%	20%	17%	12% (N=214)
Përdorimi i lëndëve narkotike	6%	23%	29%	15%	9% (N=146)
Trafiku	7%	11%	13%	13%	8% (N=135)
Dhuna në familje	3%	15%	19%	7%	6% (N=108)
Mungesa e lirisë së fjalës	1%	5%	11%	4%	3% (N=58)
Mungesa e konfidencialitetit dhe mbrojtjes kur raportohen shkeljet	1%	6%	12%	3%	3% (N=44)
Diskriminimi në bazë të gjinisë, besimit fetar, pasurisë, etj.	X	5%	7%	3%	1% (N=21)

Baza: 2016 (N=1608); 2017 (N=1615); 2018 (N=1629); 2019 (N=1613); 2020 (N=1713)

Shënim: Lejohen disa përgjigje; përqindjet nuk plotësojnë koeficientin 100%.

Tabela 24: Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike sipas karakteristikave demografike 2020

	Shërbimet publike bazë (të gjithë të anketuarit)								Shërbimet administrative (të anketuarit që përdorën shërbimin)							
	Shëndetësia	Arsimi	Furnizimit	Transporti publik	Pastrimi	Emergenca	Gjyqësori	Policia	Asistenca sociale	Punësimi	Pronat	Gjendja civile	Sigurimet shoqërore	Transporti rrugor	Regjistrimi i biznesit dhe licencimi	Lejet e ndërtimit
<b>GJITHSEJ (% e të kënaqurve)</b>	<b>41%</b>	<b>49%</b>	<b>42%</b>	<b>32%</b>	<b>49%</b>	<b>40%</b>	<b>20%</b>	<b>33%</b>	<b>37%</b>	<b>29%</b>	<b>34%</b>	<b>68%</b>	<b>54%</b>	<b>56%</b>	<b>48%</b>	<b>29%</b>
<b>Gjinia</b>																
Femra	41%	48%	41%	32%	49%	38%	19%	31%	38%	28%	35%	67%	52%	59%	50%	31%
Meshkuj	41%	50%	42%	32%	48%	41%	20%	34%	37%	29%	34%	69%	56%	54%	47%	28%
<b>Mosha</b>																
18 - 25 vjeç	39%	46%	39%	29%	48%	40%	19%	30%	49%	21%	37%	62%	53%	61%	46%	24%
26 - 35 vjeç	40%	45%	39%	31%	48%	38%	18%	30%	37%	26%	31%	66%	55%	56%	49%	27%
36 - 45 vjeç	41%	50%	42%	34%	48%	39%	20%	30%	35%	36%	35%	69%	57%	63%	52%	35%
46 - 55 vjeç	40%	49%	46%	31%	49%	37%	19%	34%	38%	35%	34%	71%	54%	46%	48%	29%
56 - 65 vjeç	43%	52%	43%	35%	46%	40%	22%	38%	31%	29%	33%	73%	49%	58%	50%	31%
mbi 66 vjeç	49%	58%	47%	40%	57%	49%	22%	43%	39%	27%	46%	78%	56%	36%	20%	27%
<b>Niveli arsimor</b>																
Arsim deri 9-vjeçar*	35%	44%	37%	30%	42%	36%	18%	33%	30%	19%	25%	65%	41%	37%	32%	21%
Me arsim të mesëm	38%	46%	40%	33%	46%	36%	19%	31%	34%	24%	34%	66%	53%	53%	49%	29%
Me arsim universitar	48%	54%	46%	34%	55%	46%	21%	35%	48%	37%	41%	72%	64%	64%	55%	35%

Shërbimet publike bazë (të gjithë të anketuarit)										Shërbimet administrative (të anketuarit që përdorën shërbimin)						
	Shëndetësia	Arsimi	Furnizimit	Transporti publik	Pastrimi	Emergjencia	Gjyqësori	Policia	Asistenca sociale	Punësimi	Pronat	Gjendja civile	Sigurimet shoqërore	Transporti rrugor	Regjistrimi i biznesit dhe licencimi	Lejet e ndërtimeve
<b>GJITHSEJ (% e të kënaqurve)</b>	<b>41%</b>	<b>49%</b>	<b>42%</b>	<b>32%</b>	<b>49%</b>	<b>40%</b>	<b>20%</b>	<b>33%</b>	<b>37%</b>	<b>29%</b>	<b>34%</b>	<b>68%</b>	<b>54%</b>	<b>56%</b>	<b>48%</b>	<b>29%</b>
<b>Statusi i punësimit</b>																
I/E Gjithsej	44%	53%	45%	35%	52%	43%	22%	34%	43%	36%	35%	71%	60%	61%	55%	35%
punë- Sektori publik	62%	66%	54%	47%	66%	60%	35%	49%	58%	66%	51%	81%	78%	75%	80%	47%
suar Sektori privat	38%	48%	40%	30%	48%	37%	17%	29%	38%	25%	29%	67%	54%	55%	49%	32%
I/E papunë	31%	37%	32%	27%	39%	31%	14%	27%	29%	16%	27%	62%	32%	44%	37%	19%
Student	37%	46%	37%	23%	40%	31%	16%	27%	36%	16%	36%	47%	42%	54%	35%	18%
Pensionist	48%	55%	49%	38%	55%	46%	22%	41%	37%	26%	44%	80%	56%	38%	16%	18%
<b>Niveli i të ardhurave</b>																
Pa të ardhura	32%	39%	34%	27%	40%	32%	15%	25%	30%	17%	28%	57%	32%	44%	32%	20%
Deri në 24,000 lekë	42%	48%	40%	35%	48%	39%	21%	36%	38%	21%	36%	71%	50%	43%	39%	19%
24,001 – 50,000 lekë	46%	57%	46%	36%	55%	44%	22%	35%	40%	37%	34%	73%	58%	59%	55%	39%
50,001 – 70,000 lekë	51%	56%	48%	34%	54%	49%	24%	36%	51%	50%	43%	74%	73%	67%	63%	34%
Mbi 70,001 lekë	33%	33%	38%	21%	41%	35%	10%	32%	50%	21%	25%	60%	44%	48%	33%	17%
<b>Vendbanimi</b>																
Urban	42%	48%	41%	34%	50%	40%	21%	34%	36%	29%	35%	66%	54%	56%	49%	29%
Rural	38%	50%	42%	29%	46%	40%	16%	30%	42%	28%	33%	74%	56%	56%	46%	30%

\* Përqindja llogaritet si shuma e përqindjes së të anketuarve "të kënaqur" dhe "shumë të kënaqur".

\*\* Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

Shënim: Për shërbimet bazë, ngjyrat përfaqësojnë diferencat prej >5 p.p. me totalin e përgjigjeve. Për shërbimet administrative, ngjyrat përfaqësojnë diferencat prej >10 p.p. me totalin e përgjigjeve

## 4.7 Fatkeqësitë natyrore

Viti 2020 në Shqipëri u karakterizua nga pasojat e tërmetit shkatërrimtar i nëntorit 2019 dhe nga pandemia COVID-19, e cila shkaktoi ndërprerje të mëdha në të gjitha aspektet e jetës në vend. Për të vlerësuar perspektivën e qytetarëve për trajtimin e këtyre ngjarjeve, në sondazhin e vitit 2020 u shtua një seksion i ri, “Fatkeqësitë natyrore”.


Duke përdorur një shkallë prej katër pikësh - nga 1 (shumë i kënaqur) në 4 (shumë i pakënaqur), pjesëmarrësve të këtij sondazhi iu kërkua të vlerësonin sa të kënaqur ishin - në tre aspekte që kishin të bënin me pandeminë COVID-19: Transparenca në vendimmarrje nga qeverisja qendrore; mundësia e marrjes së shërbimeve online (p.sh. konsultim online, mësimi online, etj.), dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut. Disa pyetje të tjera u përqendruan në veprimet e qeverisë në lidhje me tërmetin. Në mënyrë të veçantë, pjesëmarrësve në sondazh iu kërkua të thonin sa të kënaqur ishin me përgjigjen fillestare të qeverisë pas tërmetit (p.sh., komunikimi me publikun; ofrimi i kujdesit, strehimit, ushqimit dhe vlerësimi i dëmit) si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor.

### Qeverisja gjatë pandemisë COVID-19

*63% e shqiptarëve të anketuar ishin të pakënaqur me respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, 58% ishin të pakënaqur me transparencën e vendimmarrjes së qeverisë qendrore dhe 53% e të anketuarve ishin të pakënaqur me ofrimin e shërbimeve online gjatë pandemisë COVID-19. Nivel më të lartë pakënaqësie u evidentua kryesisht te grupmoshat e reja, studentët, të papunët, të punësuarit në sektorin privat, dhe personat me aftësi të kufizuar.*

40.3% pjesëmarrësve të këtij sondazhi raportuan se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me nivelin e transparencës së vendimmarrjes së qeverisë vendore; 43.7% ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me shërbimet online, dhe 34.5% ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut gjatë pandemisë COVID-19.

**Figura 48: Kënaqshmëria e qytetarëve me trajtimin e krizave dhe qeverisjen gjatë pandemisë COVID-19 2020**



Baza: Transparenca (N=2496); shërbimet online (N=2497); të drejtat dhe liritë e njeriut (N=2491).

E analizuar sipas gjinisë, një përqindje më e madhe e meshkujve krahasuar me femrat raportuan se ishin të kënaqur me transparencën e vendimmarrjes, ofrimin e shërbimeve online dhe respektimin e të drejtave dhe liritë të njeriut. Në mënyrë të veçantë, 39% e të anketuarve femra dhe 42% e të intervistuarve meshkuj ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me transparencën e qeverisë vendore gjatë pandemisë COVID-19. 43% e të anketuarve femra dhe 45% e të intervistuarve meshkuj ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur ofrimin e shërbimeve online. 33% e të anketuarve femra dhe 36% e të intervistuarve meshkuj ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me respektimin e të drejtave dhe liritë të njeriut.

Të anketuarit e moshës mbi 66 vjeç (51%), ata me arsim universitar (45%), të punësuarit në sektorin publik (65%), dhe ata me të ardhura mujore të nivelit 50,001 dhe 70,000 lekë ishin më të predispozuar për të raportuar se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me transparencën e vendimmarrjes. Po ashtu, të anketuarit e moshës mbi 66 vjeç (49%), ata me arsim universitar (50%), të punësuarit në sektorin publik (66%), dhe ata me të ardhura mujore 50,001 deri në 70,000 lekë (55%) ishin më të prirur të raportonin se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me ofrimin e shërbimeve online. Të anketuarit e moshës mbi 66 vjeç (52%), të punësuarit në sektorin publik (54%), dhe ata me të ardhura mujore 50,001 deri në 70,000 lekë (41%) ishin, po ashtu, më të prirur të deklaronin se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me respektimin e të drejtave dhe liritë të njeriut. Të anketuarit që raportuan se nuk kanë të ardhura prireshin më shumë të shprehnin pakënaqësinë me transparencën e vendimmarrjes (30%), me shërbimet online (37%) dhe të drejtat dhe liritë e njeriut (33%). Shihni Tabelën 25 për ndarjen demografike të kënaqshmërisë me qeverisjen e fatkeqësive e natyrore.

Personat me aftësi të kufizuar ishin më të predispozuar për të shprehur pakënaqësinë me transparencën e vendimmarrjes. 71% e të anketuarve me aftësi të kufizuara deklaruan se ishin të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me transparencën e vendimmarrjes; ndërkohë që një përqindje shumë më e vogël raportuan se ishin të pakënaqur apo shumë të pakënaqur me transparencën e vendimmarrjes. Kjo është në kontrast me 41% të të anketuarve që nuk janë me aftësi të kufizuar se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me transparencën e vendimmarrjes. Personat me aftësi të kufizuar, po ashtu, ishin më pak të prirur për të raportuar se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me ofrimin e shërbimeve online (32%) dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut (25%).

Krahasime u bënë edhe mes të anketuarve që janë vetë-deklaruar si anëtarë të pakicave kombëtare dhe atyre që nuk i përkasin pakicave. 39% e pjesëmarrësve të këtij studimi që u identifikuan si anëtarë të grupeve të pakicave deklaruan se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me transparencën e vendimmarrjes. Përqindja respektive e atyre që deklaruan se nuk ishin anëtarë të pakicave kombëtare ishte 41%. Dallimet për sa i përket ofrimin të shërbimeve online dhe respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut nuk ishin të mëdha. Mes atyre që u vetë-deklaruan si anëtarë të një pakice, 43% raportuan se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me ofrimin e shërbimeve online dhe 34% me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Për ata që kanë deklaruar se nuk i përkasin asnjë pakice, përqindjet ishin 44 dhe 35, përkatësisht.


### **Përgjigja fillestare e qeverisë pas tërmetit**

*Më shumë se gjysma e shqiptarëve të anketuar ishin të pakënaqur me përgjigjen fillestare të qeverisë qendrore (55%) dhe të qeverisë vendore (55%) pas tërmetit. Pakënaqësia ishte më e theksuar mes grupmoshave të reja, të papunëve, studentëve, të punësuarve në sektorin privat, dhe personave me aftësi të kufizuar.*

Më pak se gjysma e të anketuarve raportuan se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me përgjigjen fillestare të qeverisë pas tërmetit. Në mënyrë të veçantë, 37.9% raportuan se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me përgjigjen fillestare të qeverisë qendrore, dhe 37.5% raportuan se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me përgjigjen fillestare të qeverisë vendore.



**Figura 49: Kënaqshmëria e qytetarëve me përgjigjen fillestare të qeverisë pas tërmetit 2020**



Baza: qeveria vendore (N=2034); qeveria qendrore (N=2034).

Kënaqshmëria me reagimin e qeverisë qendrore pas tërmetit ishte më e theksuar mes të intervistuarve meshkuj (39%) krahasuar me të anketuarat femra (37%), si dhe te të anketuarit e moshës mbi 66 vjeç (47%), punonjësit e sektorit publik (55%), dhe ata me të ardhura mujore në nivel 50,001 dhe 70,000 lekë (45%). Po ashtu, kënaqshmëria me reagimin e qeverisë vendore pas tërmetit ishte më e madhe tek të intervistuarit meshkuj (39%) sesa te të anketuarat femra (36%), si dhe te të anketuarit e moshës mbi 66 vjeç (48%), punonjësit e sektorit publik (55%), dhe ata me të ardhura mujore në nivel 50,001 dhe 70,000 lekë (43%). Shihni Tabelën 25 për ndarjen demografike të kënaqshmërisë me përgjigjen e të dy niveleve të qeverisjes pas tërmetit.

Personat me aftësi të kufizuar ishin shumë më të prirur të shprehnin pakënaqësinë me reagimin e qeverisë qendrore pas tërmetit. Në mënyrë të veçantë, 67% e të anketuarve me aftësi të kufizuara raportuan se ishin të pakënaqur apo shumë të pakënaqur me përgjigjen e qeverisë qendrore; ndërkohë, vetëm 28% raportuan se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur. 39% e të anketuarve që thanë se nuk kanë aftësi të kufizuar raportuan se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me përgjigjen e qeverisë qendrore. I njëjti qëndrim u vu re edhe për përgjigjen e qeverisë vendore. 66% e të anketuarve me aftësi të kufizuar raportuan se ishin të pakënaqur apo shumë të pakënaqur me përgjigjen e qeverisë vendore; vetëm 29% raportuan se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur. Si për krahasim, 38% e të anketuarve që thanë se nuk janë me aftësi të kufizuar raportuan se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me përgjigjen e qeverisë vendore.

Nuk pati dallime mes atyre që u deklaruan si anëtarë të një pakice kombëtare dhe atyre që nuk u deklaruan të tillë për sa i përket kënaqshmërisë me përgjigjen pas tërmetit të të dy niveleve të qeverisjes.

Tabela 25: Ndarja demografike e kënaqshmërisë me përgjigjen fillestare të qeverisë gjatë fatkeqësive natyrore 2020

	Transparenca në vendimmarrje	Mundësia e marrjes së shërbimeve online	Respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut	Përgjigja fillestare e qeverisjes qendrore pas tërmetit	Përgjigja fillestare e qeverisjes vendore pas tërmetit
<b>GJITHSEJ</b> (% e të kënaqurve)	<b>40%</b>	<b>44%</b>	<b>34%</b>	<b>38%</b>	<b>38%</b>
<b>Gjinia</b>					
Femra	39%	43%	33%	37%	36%
Meshkuj	42%	45%	36%	39%	39%
<b>Mosha</b>					
18 - 25 vjeç	37%	42%	28%	36%	35%
26 - 35 vjeç	41%	45%	33%	38%	38%
36 - 45 vjeç	41%	43%	35%	37%	37%
46 - 55 vjeç	38%	42%	33%	33%	34%
56 - 65 vjeç	40%	43%	39%	43%	41%
mbi 66 vjeç	51%	49%	52%	47%	48%
<b>Niveli arsimor</b>					
Arsim deri 9-vjeçar*	34%	40%	30%	34%	36%
Me arsim të mesëm	39%	41%	35%	37%	36%
Me arsim universitar	45%	50%	36%	41%	40%

	Transparenca në vendimmarrje	Mundësia e marrjes së shërbimeve online	Respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut	Përgjigjia fillestare e qeverisjes qendrore pas tërmetit	Përgjigjia fillestare e qeverisjes vendore pas tërmetit
<b>GJITHSEJ</b> (% e të kënaqurve)					
<b>Statusi i punësimit</b>					
I/E Gjithsej	44%	47%	36%	40%	39%
I/E punë-suar	65%	66%	54%	55%	55%
Sektori publik	37%	41%	30%	35%	34%
Sektori privat	31%	36%	26%	31%	33%
I/E papunë	34%	41%	29%	33%	30%
Student	46%	45%	46%	45%	42%
Pensionist	<b>Niveli i të ardhurave</b>				
Pa të ardhura	30%	37%	27%	33%	35%
Deri në 24,000 lekë	40%	42%	38%	39%	37%
24,001–50,000 lekë	45%	48%	37%	41%	40%
50,001–70,000 lekë	49%	55%	41%	45%	43%
Mbi 70,001 lekë	47%	40%	32%	41%	41%
<b>Vendbanimi</b>					
Urban	41%	44%	34%	38%	38%
Rural	39%	44%	35%	37%	36%

\* Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).  
Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë diferencat prej >5 p.p. me totalin e përgjigjeve.

## 4.8 Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit

Dixhitalizimi i shërbimeve publike i bën këto shërbime më të lehta për t'u përdorur, më efikase dhe transparente për qytetarët, gjë që bën të bie niveli i korrupsionit dhe të rritet kënaqshmëria e qytetarëve me shërbimin e ofruar.<sup>20</sup> Platforma e qeverisjes elektronike e-Albania, e krijuar në vitin 2012, ofron 1922 shërbime për individë dhe biznese.<sup>21</sup> Në këtë pjesë të studimit, **të anketuarit iu përgjigjën pyetjeve në lidhje me njohuritë dhe përdorimin e faqeve të internetit të bashkive dhe portalit e-Albania. Të anketuarit u pyetën edhe në lidhje me përshtypjet e tyre për portalin e-Albania.**

### Faqja e internetit e bashkisë

*Krahasuar me vitin 2019, një përqindje më e madhe e shqiptarëve të anketuar ishin në dijeni se bashkia e tyre kishte një faqe interneti (63% me 54%). Po ashtu, një përqindje më e madhe e kishin përdorur faqen e internetit (39% me 36%). Grupmoshat e reja, të anketuarit me arsim universitar (ose pasuniversitar), studentët, punonjësit e sektorit publik, dhe të anketuarit nga zonat urbane ishin më të predispozuar të raportonin se ishin në dijeni që bashkia e tyre kishte faqe interneti.*


63.1% e pjesëmarrësve të këtij studimi raportuan se bashkia e tyre kishte faqe interneti – një përqindje më e madhe sesa në vitin 2019 (54%). 63% e të anketuarve femra dhe 63% e të intervistuarve meshkuj raportuan se bashkia e tyre kishte faqe interneti. Grupmoshat e reja (18-25 vjeç: 80%, 26-35 vjeç: 78%), të anketuarit me arsim universitar apo pasuniversitar (84.4%), studentët (79.5%), punonjësit e sektorit publik (83.7%), dhe të anketuarit nga zonat urbane (63.3%) ishin më të predispozuar të raportonin se ishin në dijeni që bashkia e tyre kishte faqe interneti. Të anketuarit me aftësi të kufizuara (40%) apo ata që i përkasin një grupi pakice (45%) ishin më pak të prirur të thonin se ishin në dijeni që bashkia e tyre kishte faqe interneti.



20 Shihni raportin, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (March 2018) Embracing Digitalisation: How to use ICT to strengthen Anti-Corruption, available at [https://www.giz.de/de/downloads/giz2018-eng\\_ICT-to-strengthen-Anti-Corruption.pdf](https://www.giz.de/de/downloads/giz2018-eng_ICT-to-strengthen-Anti-Corruption.pdf)

21 E-Albania. (n.d.). Statistika për nëntor 2020. Marrë nga: <https://e-albania.al/Pages/Statistics/statistika.pdf>


Figura 50: A e dini se bashkia juaj ka një faqe interneti? 2020



Baza: N = 2500

Përqindja e të anketuarve që raportojnë se bashkia e tyre ka një faqe interneti është rritur me kalimin e kohës. 43% e të anketuarve në studimin e vitit 2015 dhe 63% e të anketuarit në studimin e vitit 2020 raportuan se bashkia e tyre ka një faqe interneti – një rritje prej 20 p.p.

Figura 51: A e dini se bashkia juaj ka një faqe interneti? 2015–2020



Baza: 2015 (N=1565), 2016 (N=1618), 2017 (N=1640), 2018 (N=1638), 2019 (N=2493), 2020 (N=2500).


\*Shënim: Që nga viti 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

### Cilësia dhe arsyet e përdorimit të faqes së internetit të bashkisë

*Arsyeja kryesore për përdorimin e faqes së bashkisë në vitin 2020 ishte për të marrë informacione për llojet e shërbimeve që ofrohen dhe se si mund të aksesohen ato. Gratë, grupmoshat e reja, të anketuarit me arsim universitar (ose pasuniversitar), studentët, dhe punonjësit e sektorit publik ishin më të predispozuar për të raportuar se përdorin faqen e internetit të bashkisë.*

39.3% e pjesëmarrësve të këtij studimi raportuan se përdorin faqen e internetit të bashkisë – një përqindje më e madhe sesa në vitin 2019 (35.7%), 2018 (35%) dhe 2017 (33%). Në vitin 2016, 41% e të anketuarve thanë se përdorin faqen e internetit të bashkisë.

**Figura 52: Përqindja e të anketuarve që përdorin faqen e internetit të bashkisë 2020**



Baza: N = 1575

Kur bëjmë krahasime sipas karakteristikave demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas vendbanimit dhe përkatësisë ndaj një pakice kombëtare. 42% e të anketuarve femra dhe 37% e të intervistuarve meshkuj raportuan se përdorin faqen e internetit të bashkisë – me një diferencë prej 5.4 p.p. Grupmoshat e reja, të anketuarit me arsim universitar apo pasuniversitar (49%), studentët (42%), punonjësit e sektorit publik (59%), të anketuarit me aftësi të kufizuara (47%) ishin më të predispozuar për të raportuar se përdorin faqen e internetit të bashkisë.

Arsyeja kryesore për përdorimin e faqes së bashkisë në vitin 2020 ishte ‘për të marrë informacione për llojet e shërbimeve që ofrohen dhe se si mund të aksesohen ato’ (12.5%), ndjekur nga ‘për të marrë informacione për programe apo aktivitete në vendbanimin e tyre’ (11.4%), ‘për të ndjekur vendimet e këshillit’ (5.1%), ‘për të dërguar ankesa, komente te një drejtori/staf i bashkisë’ (2.5%).

**Tabela 26: Arsyet e përdorimit të faqes së internetit të bashkisë 2020**


	Proportion of respondents
Kontrolloj programet / aktivitetet në qytetin tim	11.4% (n = 284)
Ndjek vendimet e këshillit, lexoj procesverbalet e mbledhjeve	5.1% (n = 127)
Dërgoj ankesa, komente te një drejtori/staf i bashkisë	2.5% (n = 62)
Për të marrë informacion mbi llojet e shërbimeve që ofrohen dhe se si mund të aksesohen	12.5% (n = 313)
Tjetër*	1.6% (n = 40)

\*Tjetër: Për të gjitha arsyet e përmendura më sipër apo për të marrë informacione për një vend pune.

## E-qeverisja në Shqipëri

*Krahasuar me vitin 2019, një përqindje më e madhe e shqiptarëve thanë se ishin në dijeni se administrata shtetërore ofronte shërbime elektronike nëpërmjet portalit e-Albania (93% me 71%) dhe se kishin marrë shërbime elektronike nëpërmjet portalit e-Albania (74% me 53%). Grupmoshat e reja, të anketuarit me arsim universitar (ose pasuniversitar), studentët, dhe punonjësit e sektorit publik ishin më të predispozuar për të raportuar se kishin marrë shërbime elektronike nëpërmjet portalit e-Albania. Krahasuar me vitin 2019, një përqindje më e vogël e shqiptarëve i vlerësuan shërbimet elektronike si funksionale, të lehta për t'u përdorur, dhe që u ofronte mundësi qytetarëve të shprehnin mendimet/sugjerimet e tyre.*

93.0% e pjesëmarrësve të këtij studimi raportuan se ishin në dijeni se administrata shtetërore ofronte shërbime elektronike nëpërmjet portalit e-Albania – një përqindje shumë më e madhe se në 2019. Në vitin 2019, 71.2% e pjesëmarrësve të këtij studimi raportuan se ishin në dijeni të portalit e-Albania.

**Figura 53: Dijenia për portalin e-Albania 2020**


Baza: N = 2492

93% e të anketuarve femra dhe 94% e të intervistuarve meshkuj raportuan se ishin në dijeni të portalit e-Albania. Grupmoshat e reja, të anketuarit me arsim universitar apo pasuniversitar (99%), studentët (97%), atë në marrëdhënie pune (96%), dhe të anketuarit nga zonat urbane (94%) ishin më të predispozuar për të raportuar se ishin në dijeni të portalit e-Albania. Të anketuarit që i përkasin një pakice kombëtare (84%) apo të anketuarit me aftësi të kufizuar (84%) ishin më pak të prirur të deklaronin se ishin në dijeni se administrata shtetërore ofronte shërbime elektronike nëpërmjet portalit e-Albania.

74.3% e pjesëmarrësve të këtij studimi raportuan se kishin marrë shërbime elektronike nëpërmjet portalit e-Albania në 2020. Në krahasim me studimin e vitit 2019, 53.1% e pjesëmarrësve të këtij studimi raportuan se kishin marrë shërbime elektronike nëpërmjet portalit e-Albania.



**Figura 54: A keni marrë ndonjë shërbim elektronik nëpërmjet portalit e-Albania? 2020**




Baza: N = 2317

Kur bëjmë krahasime sipas karakteristikave demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë dhe vendbanimit. 75% e të anketuarve femra dhe 74% e të intervistuarve meshkuj thanë se kishin marrë shërbime elektronike nëpërmjet portalit e-Albania. Grupmoshat e reja, të anketuarit me arsim universitar apo pasuniversitar (87%), studentët (90%), dhe punonjësit e sektorit publik (88%) ishin më të predispozuar për të raportuar se kishin marrë shërbime elektronike nëpërmjet portalit. Të intervistuarit që raportuan një aftësi të kufizuar (62%) dhe të anketuarit që i përkasin një pakice kombëtare (65%) janë më pak të prirur të deklarojnë se kishin marrë shërbime elektronike nëpërmjet portalit e-Albania.

Shërbimet elektronike u vlerësuan sipas tre kriterëve: funksionaliteti, lehtësia në përdorim, dhe mundësia që qytetarët të bëjnë komente/sugjerime. 88.0% e të anketuarve të këtij studimi thanë se shërbimet elektronike ishin funksionale, 69.5% thanë se janë të thjeshta për t'u përdorur, dhe 48.9% thanë se u japin qytetarëve mundësinë për të dhënë mendimet/sugjerimet e tyre. Këto përqindje janë më të vogla se ato të vitit 2019. Konkretisht, në vitin 2019 këto përqindje ishin 94.6%, 80.1%, dhe 60.0%, përkatësisht.

**Figura 55 Cilësia e vlerësimit të shërbimeve elektronike nëpërmjet portalit e-Albania 2020**



Baza: Funksionale (N=1670); Të thjeshta për t'u përdorur (N=1634); Mundësi për komente/sugjerime (N=1624).

## 4.9 Përfshirja gjinore dhe sociale

Pjesëmarrja e grave në politikë në Shqipëri është rritur ndjeshëm në dhjetë vitet e fundit, kryesisht për shkak të kuotës gjinore të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor.<sup>22</sup> Në krahasim me burrat, gratë në Shqipëri janë më të prirura të ndjekin studimet universitare. Pavarësisht këtyre arritjeve, ato vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar në vendimmarrje dhe pritshmëritë për to janë që ato të mbajnë barrën e kujdesit për fëmijët dhe për punët në shtëpi.<sup>23</sup> Në kreun për përfshirjen gjinore dhe sociale analizohen perceptimet e qytetarëve për dallimet gjinore për sa i përket aksesit të shërbimit publike dhe për aftësinë për të mbajtur poste publike. Të anketuarit u pyetën nëse ata janë trajtuar ndryshe nga institucionet/zyrtarët publikë për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, orientimit seksual, aftësive fizike apo për arsye të tjera. Me pyetjen e fundit të këtij kreu synohet të kuptohen bindjet e qytetarëve në lidhje me rritjen e pjesëmarrjes së grave në këshillat bashkiakë dhe ndikimin e tyre në qeverisjen vendore.

### Perceptimi për barazinë gjinore në shoqërinë shqiptare

*Më pak se 50% e shqiptarëve ishin dakord se në shoqërinë shqiptare ka barazi mes burrave dhe grave, një përqindje më e vogël se në 2019 (45% me 54%). Burrat më shumë se gratë prireshin të ishin dakord se ka barazi mes burrave dhe grave. Të papunët, studentët, dhe njerëzit me arsim deri të mesëm ishin më pak të prirur për të rënë dakord se ka barazi mes burrave dhe grave.*

### “ Pohimi 1: “Në shoqërinë shqiptare ka barazi mes burrave dhe grave”

Pjesëmarrësit e këtij studimi u pyetën për të dhënë mendimin e tyre se sa ishin dakord me tre pohimet për barazinë gjinore në Shqipëri duke përdorur një shkallë prej 4 pikësh – nga 1 (plotësisht dakord) në 4 (aspak dakord). 44.6% e të anketuarve raportuan se ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin “në shoqërinë shqiptare ka barazi mes burrave dhe grave” – një përqindje më e vogël se në vitin 2019 (54.3%). Në krahasim me gratë, burrat


•••••

22 Instituti i Statistikave INSTAT. (2019). Burrat dhe gratë në Shqipëri 2019. fq. 55–57. Marrë nga adresa [http://www.instat.gov.al/media/6413/burra-dhe-gra\\_2019.pdf](http://www.instat.gov.al/media/6413/burra-dhe-gra_2019.pdf)

23 Dauti, M. dhe Zhllima, E. (2016). Perceptimet dhe Qëndrimet Publike ndaj Barazisë Gjinore në Shqipëri. Tiranë: UNDP [https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/STUDIMI\\_PERCEPTIMET\\_SHQIP.pdf](https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/STUDIMI_PERCEPTIMET_SHQIP.pdf)

ishin më shumë të prirur për të rënë dakord me pohimin. Në mënyrë të veçantë, 50.0% e të intervistuarve meshkuj dhe 39.2% e të anketuarve femra raportuan se ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin.

**Figura 56: Barazia mes burrave dhe grave në shoqërinë shqiptare 2020**




Baza: N = 2497

Të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç’ ishin më të predispozuar për të rënë dakord me pohimin “në shoqërinë shqiptare ka barazi mes burrave dhe grave”. 51% e të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç thanë se ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin. Ndërkohë, përqindja e të anketuarve të moshës 18-25 vjeç ishte 43. Një përqindje më e madhe e të anketuarve me arsim universitar apo pasuniversitar ishin dakord me pohimin “në shoqërinë shqiptare ka barazi mes burrave dhe grave”. Në mënyrë të veçantë, 46% e të anketuarve me arsim universitar (ose pasuniversitar), 45% e intervistuarve me arsim të mesëm, dhe 42% e të anketuarve me arsim deri të mesëm raportuan se ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin. Gjithsesi, dallimet nuk ishin të mëdha. Të papunët (36%) dhe studentët (39%) ishin më pak të prirur të ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin. Anëtarët e partive politike (60%), krahasuar me jo-anëtarët (43%), ishin më të predispozuar për të raportuar se ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin.

Nëse krahasojmë rezultatet e këtij viti me ato të sondazhit të 2019, një përqindje më e vogël e të anketuarve meshkuj dhe atyre femra ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin “në shoqërinë shqiptare ka barazi mes burrave dhe grave”. Ndërkohë që në vitin 2020, 50% e të intervistuarve meshkuj ishin dakord me pohimin dhe në vitin 2019 60% kishin këtë mendim. Po ashtu, në vitin 2020, 39% e të anketuarve femra ishin dakord me pohimin krahasuar me 49% në 2019 – një rënie prej 10 p.p. për secilën gjini. Kjo do të thotë se përqindja e të anketuarve femra dhe të intervistuarve meshkuj që janë dakord me pohimin

është e ngjashme me gjetjet e vitit 2016, në sondazhin e të cilit u bë për herë të parë kjo pyetje.

**Figura 57: Barazia mes burrave dhe grave në shoqërinë shqiptare 2016–2020**



Baza: 2016 (N=1636); 2017 (N=1623); 2018 (N=1636); 2019 (N=2487); 2020 (N=2497)

\*Shënim: Që nga viti 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.


### Aksesi te shërbimet publike sipas gjinive

*Rreth 70% e shqiptarëve besonin se burrat dhe gratë kanë të njëjtin akses te shërbimet publike. Gratë ishin më pak të prirura në krahasim me burrat ka akses të barabartë te shërbimet publike. Për më tepër, të papunët, studentët, të punësuarit në sektorin privat, dhe ata me arsim deri në 8/9-vjeçar ishin më pak të prirur për të rënë dakord se burrat dhe gratë kanë të njëjtin akses te shërbimet publike.*

“ Pohimi 2: “Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike”

71.3% e pjesëmarrësve të këtij studimi thanë se ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin “në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike.” 74.5% e të intervistuarve meshkuj dhe 68.2% e të anketuarve femra raportuan se ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin.

**Figura 58: Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike 2020**




Baza: N = 2496

74.1% e pjesëmarrësve të këtij studimi të moshës 26-35 vjeç thanë se ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin “Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike”. Kjo përqindje nuk ishte shumë e ndryshme nga ajo e të anketuarve të moshës mbi 36 vjeç. Për shembull, 72% e pjesëmarrësve të këtij studimi të moshës 56-65 vjeç thanë se ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin. 75% e pjesëmarrësve të këtij studimi me arsim universitar (ose pasuniversitar), 69% me arsim të mesëm, dhe 72% me arsim deri 8/9-vjeçar thanë se ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin. Të papunët (66%) dhe studentët (64%) ishin më pak të prirur të ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin. Të anketuarit e sektorit privat (71%) ishin më pak të prirur se punonjësit e sektorit publik (81%) të ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin.

Edhe pse përqindjet e këtij viti nuk kanë arritur nivelin e vitit 2017 (79% dhe 71%, përkatësisht), ato janë më të larta se në 2019. Përqindja e të intervistuarve meshkuj që ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin është rritur me 4 p.p. dhe përqindja e të anketuarve femra është rritur me 2 p.p. nga 2019 në 2020.

**Figura 59: Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike 2016-2020**



Baza: 2016 (N=1635); 2017 (N=1619); 2018 (N=1624); 2019 (N=2487); 2020 (N=2496)

\*Shënim: Që nga viti 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.


### Ofrimi i shërbimeve publike sipas gjinive

*Shumica e shqiptarëve të anketuar besonin se nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave. Gratë ishin më pak të prirur se burrat për të rënë dakord me pohimin. Të papunët, studentët, dhe të punësuarit në sektorin privat ishin më pak të prirur të deklarorin se gratë dhe burrat trajtohen njësoj nga nëpunësit publikë.*

“ Pohimi 3: “Në Shqipëri, nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave”

67.8% e pjesëmarrësve në studim raportuan se ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin “Në Shqipëri, nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave”. Kjo përqindje është e ngjashme me atë të studimit të vitit 2019 (67.5%). 70.2% e të intervistuarve meshkuj dhe 65.4% e të anketuarve femra thanë se ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin “Në Shqipëri, nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave”.

**Figura 60: Nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave 2020**




Baza: N = 2492

Të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç ishin më të predispozuar për të rënë dakord me pohimin. 74.3% e të anketuarve të moshës mbi 65 vjeç thanë se ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin. Ndërkohë, 62% e të anketuarve të moshës 18-25 vjeç thanë se ishin dakord ose plotësisht dakord. Të anketuarit me arsim universitar apo më shumë (74%) – krahasuar me ata me arsim të mesëm (64%) dhe ata me arsim 8/9-vjeçar (66%) – ishin më të predispozuar për të raportuar se ishin dakord me pohimin. Të papunët (60%) dhe studentët (61%) ishin më pak të prirur të ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin. Të punësuarit e sektorit privat (67%), krahasuar me punonjësit e sektorit publik (79%), ishin më pak të prirur të raportonin se ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin. Anëtarët e partive politike (75%), krahasuar me jo-anëtarët (66%), ishin më të predispozuar për të raportuar se ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin se “nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave”.

Përqindja e të anketuarve femra që ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin “Në Shqipëri, nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave” nuk ka ndryshuar shumë pas vitit 2018. Gjithsesi, krahasuar me 2016, përqindja e të anketuarve që janë dakord me pohimin u rrit me 4 p.p. dhe 10 p.p. përkatësisht.



**Figura 61: Nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave 2016-2020**



Baza: 2016 (N=1635); 2017 (N=1614); 2018 (N=1636); 2019 (N=2487); 2020 (N=2492)

\*Shënim: Që nga viti 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

### Diskriminimi nga institucionet apo nëpunësit publikë

*Ashtu si në vitin 2019, rreth 1 në 8 shqiptarë raportuan se janë trajtuar ndryshe nga një institucion apo nëpunës publik në 2019 për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, orientimit seksual, statusit me aftësi të kufizuar, apo për diçka tjetër. Nga ata që kishin vuajtur diskriminimin në vitin 2020, shumica ishin trajtuar ndryshe për shkak të moshës apo gjinisë së tyre.*

Të anketuarit u pyetën nëse ishin trajtuar për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, orientimit seksual, aftësisë së kufizuar apo për diçka tjetër. 11.7% e pjesëmarrësve të këtij studimi raportuan se janë trajtuar ndryshe për shkak të gjinisë (3.6%), moshës (4.4%), përkatësisë etnike (1.4%), orientimit seksual (0.1%), aftësisë të kufizuar (0.9%), apo për arsye të tjera (1.3%). 88.3% e pjesëmarrësve të këtij studimi raportuan se nuk janë trajtuar ndryshe.

Tabela 27: Diskriminim nga institucioni 2020

<b>Jam trajtuar ndryshe për shkak të:</b>	<b>11.7% (n=292)</b>
Gjinisë	3.6% (n=91)
Moshës	4.4% (n=111)
Përkatësisë etnike	1.4% (n=34)
Orientimit seksual	0.1% (n=2)
Aftësisë së kufizuar	0.9% (n=22)
Tjetër*	1.3% (n=32)
<b>Nuk jam trajtuar ndryshe</b>	<b>88.3% (n=2207)</b>

Baza: N = 2499

\*Tjetër: Për shembull, gjendja ekonomike, varfëria, përkatësia politike, apo paraqitja fizike.

Pati dallime në raportimet sipas grupeve demografike. Për diskriminimin gjinor, gratë (6.2%) raportuan më shumë se burrat (1.1%) se ishin përballur me diskriminim. Për më tepër, të anketuarit në grupmoshën 26-35 vjeç (4.3%), grupmoshën 36-45 vjeç (5.9%), dhe ata të punësuar në sektorin privat (4.1%) deklaruan më shpesh se ishin trajtuar ndryshe nga një institucion apo nëpunës publik për shkak të gjinisë. Për sa i përket diskriminimit për shkak të moshës, të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç (15.1%), ata me arsim deri 8/9-vjeçar (6.9%), dhe të punësuarit në sektorin privat (2.6%) raportuan më shpesh se ishin trajtuar ndryshe nga një institucion apo nëpunës publik për shkak të moshës. Për shkak të numrit të vogël të të anketuarve që raportuan se ishin trajtuar ndryshe për shkak të orientimit seksual (N = 2), aftësisë së kufizuar (N = 22), dhe përkatësisë etnike (N=34), veçanërisht kur i kombinojmë këto gjetje me të anketuarit që vetë-deklarohen se janë me aftësi të kufizuara apo të anketuarit që raportojnë se i përkasin një pakice kombëtare, këto rezultate nuk do t'i raportojmë.


### Gratë në procesin e vendimmarrjes

*80% shqiptarëve të anketuar ishin të mendimit se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik. Gratë, të rinjtë dhe ata me arsim universitar (ose pasuniversitar) ishin më të predispozuar të deklarorin se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik.*

Të anketuarit u pyetën nëse mendonin se “se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik”. 79.6% e të anketuarve zgjodhën përgjigjen “Po”, pra, që mendonin se “se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik”. Ndërkohë, 13.3% zgjodhën përgjigjen “Jo”. Një përqindje më e vogël, 7.1%, thanë se “nuk e di”. Krahasuar me studimin e vitit 2019, një përqindje më e madhe e pjesëmarrësve të këtij

studimi (80% me 77%) ishin të mendimit se “gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik”.

**Figura 62: Gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik 2016-2020**




Baza: 2016 (N=1635); 2017 (N=1628); 2018 (N=1632); 2019 (N=2486); 2020 (N=2498).

\*Shënim: Që nga viti 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

Gratë (85.2%), krahasuar me burrat (73.8%), ishin më të predispozuara të thonin se “se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik.”

**Figura 63: Dallimet gjinore në perceptimin se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik 2020**



Baza: N = 2498

Të anketuarit në grupmoshat 18-25 vjeç (82%), 25-36 vjeç (83%), 36-45 vjeç (80%) dhe 46-55 vjeç (82%), të anketuarit me arsim universitar apo pasuniversitar (86%), dhe të intervistuarit me të ardhura mujore 70 001 lekë apo më shumë (85%) ishin më të predispozuar të mendonin se “se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik.”


### Ndikimi i grave në qeverisjen vendore

*Ashtu si në vitin 2019, gjashtë në 10 shqiptarë mendojnë se rritja e numrit të grave në këshillat bashkiakë do të ketë ndikim pozitiv në qeverisjen vendore. Gratë, në krahasim me burrat, ishin më të gatshme të raportonin se rritja e përfaqësimit të grave në këshillat bashkiakë do të ketë ndikim pozitiv në qeverisjen vendore. Shqiptarët e moshës 26-35 vjeç dhe 56-65 vjeç, ata me arsim deri në 8/9 vjeçar, dhe të punësuarit në sektorin privat ishin më të predispozuar për të qenë dyshues në lidhje me ndikimin e numrit të grave në qeverisjen vendore.*

Të anketuarit u pyetën nëse besonin se rritja e pranisë së grave në këshillat bashkiakë ka ndikim pozitiv në qeverisjen vendore. 62.3% e pjesëmarrësve në studim besonin se rritja e pranisë së grave në këshillat bashkiakë ka ndikim pozitiv në qeverisjen vendore. Një përqindje më e vogël, 21.2% tha se kjo rritje nuk ka ndikim pozitiv dhe 16.5% nuk ishin të sigurt.

Krahasuar me studimin e vitit 2019, një përqindje më e madhe e pjesëmarrësve të këtij studimi ishin paksa më skeptikë për rritjen e pranisë së grave në këshillat bashkiakë. Gjithsesi, dallimet nuk ishin të mëdha.

**Figura 64: Ndikimi pozitiv i rritjes së përfaqësimit të grave në këshillat bashkiakë 2016–2020**



Baza: 2016 (N=1635); 2017 (N=1631); 2018 (N=1633); 2019 (N=2486); 2020 (N=2498).

\*Shënim: Që nga viti 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

Të intervistuarit meshkuj (53%), në krahasim me të anketuarat femra (72%), ishin më pak të prirur të besonin se rritja e pranisë së grave në këshillat bashkiakë ka ndikim pozitiv në qeverisjen vendore – një hendek i konsiderueshëm gjinor prej 19 p.p. Të anketuarit e moshës 26-35 vjeç (59%) dhe ata të grupmoshës 56-65 vjeç (58%) ishin më të prirur të shprehnin skepticizmin e tyre lidhur me pohimin se rritja e pranisë së grave në këshillat bashkiakë ka ndikim pozitiv në qeverisjen vendore. Të intervistuarit me arsim deri 8/9-vjeçar (57%), krahasuar me ata me arsim të mesëm (61%) dhe me arsim universitar apo pasuniversitar (67%), ishin më pak të prirur të besonin se rritja e pranisë së grave në këshillat bashkiakë ka ndikim pozitiv. Të punësuarit e sektorit privat (59%), krahasuar me punonjësit e sektorit publik (70%), prireshin më shumë drejt skepticizmit për këtë pohim.

# SHTOJCA 1:

Karakteristikat e kampionit 2013–2020

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
<b>Gjinia</b>								
Meshkuj	45%	49%	50%	43%	51%	52%	49%	49%
Femra	55%	50%	50%	57%	49%	48%	51%	51%
Tjetër (e re në 2020)								< 0.1
<b>Grupmosha</b>								
18 – 25	14%	23%	22%	18%	19%	16%	19%	17%
26 – 35	14%	22%	25%	23%	23%	23%	26%	27%
36 – 45	14%	18%	16%	19%	19%	19%	20%	20%
46 – 55	19%	18%	17%	18%	19%	20%	16%	17%
56 – 65	20%	10%	11%	13%	11%	13%	12%	12%
mbi 66 vjeç	18%	7%	8%	9%	9%	9%	7%	7%
<b>Vendbanimi</b>								
Urban			81%	51%	50%	50%	70%	73%
Rural			19%	49%	50%	50%	30%	27%
<b>Niveli arsimor</b>								
Pa arsim + Mbaruar shkollën fillore - 4 vjeçare	1%	1%	3%	6%	5%	7%	4%	4%
Mbaruar shkollën 8/9-vjeçare	14%	15%	12%	19%	17%	23%	18%	18%
Me arsim të mesëm	40%	41%	40%	50%	50%	46%	44%	42%
Me arsim universitar	44%	42%	43%	24%	28%	24%	33%	36%
<b>Statusi i punësimit</b>								
I/E punësuar	40%	46%	45%	43%	46%	46%	54%	58%
I/E papunë	20%	25%	28%	35%	34%	32%	25%	24%
Student	8%	10%	9%	8%	7%	6%	7%	7%
Pensionist	26%	9%	11%	12%	12%	12%	11%	1%
Tjetër	3%	5%	7%	2%	1%	4%	3%	<1%
<b>Spektori i punësimit</b>								
Spektori publik				32%	29%	28%	25%	28%
Spektori privat				64%	71%	69%	72%	70%
Tjetër				4%		3%	3%	2%

<b>Të ardhurat të rregullta mujore individuale (Neto)</b>						
Pa të ardhura	34%	33%	37%	32%	29%	28%
Deri në 24,000 lekë	21%	25%	24%	28%	25%	19%
24,001–50,000 lekë	29%	28%	25%	28%	28%	32%
50,001–70,000 lekë	6%	4%	5%	4%	7%	12%
Mbi 70,001 lekë	2%	1%	2%	<1%	2%	2%
<b>A i përkisni ndonjë pakice kombëtare?</b>						
Po			<b>9%</b>	<b>7%</b>	<b>6%</b>	<b>4%</b>
Greke			3.2%	2.7%	1.5%	1.1%
Maqedonase			1.6%	1.1%	0.9%	0.6%
Arumune			<0.1%	0.2%	0.2%	<0.1%
Rome			2.3%	2.4%	1.5%	1.1%
Egjiptiane			0.9%	0.2%	0.9%	0.4%
Malazeze			0%	0%	0.1%	0.1%
Boshnjake			0.2%	<0.1%	0.2%	0.2%
Serbe			0%	0%	<0.1%	<0.1%
Bullgare			<0.1%	0.1%	0.3%	0.1%
Jo			<b>90%</b>	<b>92%</b>	<b>93%</b>	<b>94%</b>
<b>Keni ndonjë aftësi të kufizuar?</b>						
Po			7.3%	5.0%	6.5%	5.2%
Jo			92.2%	94.1%	92.7%	93.9%
Po			<b>40%</b>	<b>36%</b>	<b>35%</b>	<b>34%</b>
<b>A jeni simpatizant i ndonjë partie politike?</b>						
PS			15.5%	16.1%	12.3%	11.9%
PD			8.5%	9.2%	8.1%	8.4%
LSI			3.4%	1.2%	2.1%	2.4%
Tjetër			0.7%	0.4%	0.3%	0.3%
Jo			<b>52%</b>	<b>58%</b>	<b>60%</b>	<b>59%</b>
<b>A jeni anëtar i ndonjë partie politike?</b>						
Po			<b>16%</b>	<b>12%</b>	<b>13%</b>	<b>10%</b>
PS			6.9%	6.6%	4.6%	4.1%
PD			2.6%	3.0%	2.9%	1.9%
LSI			2.2%	0.8%	0.9%	1.1%
Tjetër			0.6%	<0.1%	0.2%	<0.1%
Jo			<b>75%</b>	<b>81%</b>	<b>82%</b>	<b>81%</b>

Shënim: Nuk janë përfshirë refuzimet. Përqindjet mund të mos jenë shumatore e 100%.





